

# Projekti Hidroenergjetik i Devollit

## Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social Risistemimi, Zhvillimi Social dhe Menaxhimi Mjedisor

### **Njoftim**

Ky dokument është përkthyer nga DHP në gjuhën shqipe për të lehtësuar kuptimin dhe shpërndarjen e informacionit të përmbajtur. Janë bërë përpjekje për të dhënë një përkthim sa më të saktë. Në rastet e keqkuptimeve në lidhje me saktësinë e informacionit të dhënë në versionin e përkthyer në shqip, ose në rast mospërputhesh ndërmjet versionit shqip dhe anglisht, mbizotëron versioni anglisht, i cili përmban kuptimin e saktë.

### **Devoll Hydropower Sh.A.**

ABA Business Center, Office No.: 1204, "PAHa Gjon Pali II" Street, Tirana, Albania

Phone: +355 4 4501450, Fax: +355 4 2400734, [info@devollhydropower.al](mailto:info@devollhydropower.al) [www.devollhydropower.al](http://www.devollhydropower.al)

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Plani i menaxhimit mjedisor dhe social (PMMS) përmban të gjitha masat zbutëse të ndikimeve mjedisore e sociale të Projektit Hidroenergjetik të Devollit. PMMS-ja përfshin angazhimet e DHP-së ndaj mjedisit dhe familjeve/personave të prekur nga projekti (FPP dhe PPP) lidhur me zbutjen e ndikimeve të projektit dhe promovimin e mundësive të zhvillimit të projektit në luginën e Devollit. Plani paraqet në mënyrë të përmbledhur ndikimet, përcakton politikën dhe çështje të tjera kryesore, si dhe parashikon një kuadër të përgjithshëm për risistemimin, rehabilitimin e mjeteve të jetesës, zhvillimin rajonal dhe iniciativat mjedisore. Plani jep një përshkrim të përgjithshëm të qëllimit dhe të veprimtarive të programeve të ndryshme që do të monitorohen dhe/ose zbatohen, si dhe llojet e treguesve monitorues do të përdoren për t'u siguruar se procesi po ecën në rrugën e duhur dhe që objektivat po realizohen.

PMMS-ja bazohet në skemën e përfitimeve të DHP-së (të miratuar nga Komiteti Drejtues në vitin 2012) dhe ka si qëllim të jetë në përputhje standardet e performancës të IFC (International Finance Corporation - Korporata Financiare Ndërkombëtare) për qëndrueshmërinë mjedisore e sociale. Theksi është vënë te planifikimi, pasi ka një interesim të madh nga aksionarët e projektit që programet MMS të zbatohen në mënyrë të tillë që të gjitha familjet dhe komunitetet e prekura nga projekti të rikuperojnë standardet e tyre të jetesës ose mundësisht t'i përmirësojnë ato si rezultat i projektit dhe rrjedhimisht të përfitojnë prej tij.

Ndikimet kryesore në mjedis mund të shihen në lidhje me ndryshimet në regjimin hidrologjik të lumit Devoll. Devijimi i rrjedhës ujore në digën e Moglicës do të ulë ndjeshëm rrjedhjen në Devoll midis digës dhe rezervuarit në Kokël. Regjimi hidrologjik do të ndryshojë gjithashtu edhe në rrjedhën e poshtme të digës së Banjës. Kjo do të zbutet me shkarkimet e rrjedhës minimale. Gjithashtu, krijimi i rezervuarëve do t'i kthejë lumenjtë e mëparshëm në liqene dhe kjo do të ketë pasoja në cilësinë e ujit. Është po kështu e rëndësishme të sillen në vëmendje, se disa zona me specie endemike të florës, të cilat ndodhen në seksionin e sipërm të zonës së projektit, do të përmblyten.

Ndikimi kryesor social është humbja e tokës bujqësore dhe hortikulturës, si dhe humbja e të ardhurave që lidhen me to. Gjithashtu, aksesimi në shërbimet sociale dhe humbja e banesave dhe e strukturave të tjera janë po ashtu ndikime që do të trajtohen në mënyrë të posaçme dhe do të kompensohen në bazë familjeje ose komuniteti. Si pjesë e procesit transparent dhe pjesëmarrës të ndërmarrë për trajtimin e këtyre çështjeve, duhet theksuar se instrumenti kryesor në hartimin e planeve të detajuara është përfshirja e grupeve përkatëse të interesit dhe e FPP-ve.

Programi i risistemimit brenda kuadrit të procesit të DHP-së, përfshin blerjen e truallit dhe godinave mbi të, përfshirë bizneset, zhvendosjen fizike, dhe mbështetjen me mjete jetese për FPP-të, për të përmirësuar (ose të paktën për të rikuperuar) të ardhurat dhe standardet e tyre të jetesës. Janë identifikuar rreth 70 familje për të cilat do të merren masa të plota risistemimi dhe një numër maksimal prej rreth 646 FPP-sh (të identifikuar deri më tani) mund të fitojnë të drejtën për kompensim individual ose në nivel fshati, krahas tarifave të shpronësimit të ofruara nga qeveria shqiptare. Kompensimi do të bazohet kryesisht në kompensimin në natyrë, në formën e paketave bujqësore si mjete jetese (ku është e mundur). Qëllimi kryesor është të minimizohen ndikimet mbi popullsinë e prekur, të bëhet kompensimi në mënyrë të drejtë dhe të garantohet që risistemimi të planifikohet duke i dhënë vëmendje të veçantë kulturës dhe çështjeve gjinore. Objektivi është të bëhet i mundur rikthimi i mjeteve të jetesës për të paktën 70% të FPP-ve të prekura ndjeshëm nga projekti (personat që risistemohen dhe ata me humbje të konsiderueshme që marrin pjesë në programet e rikuperimit të mjeteve të jetesës në luginën e Devollit) me të njëjtin nivel ose me nivel më të lartë krahasuar me atë përpara fillimit të projektit, si dhe në 70% të kampionit të monitorimit të atyre që ndodhen brenda zonës së ndikimit (tokat e ndërtimit të projektit dhe hapësirat e rezervuarëve).

Programi i zhvillimit social brenda kuadrit të procesit të DHP-së përfshin programe të zëvendësimit të infrastrukturës rrugore, si dhe programe për shëndetësinë, arsimin dhe mbështetjen sociale. Infrastruktura rrugore plotëson aktivitetet e risistemimit dhe të kompensimit dhe mbështet përmirësimin e shërbimeve në

luginën e Devollit, si dhe do të rehabilitojë aksesin që është dëmtuar për shkak të projektit, me synimin për të minimizuar ndikimin në lëvizjet e banorëve vendas.

Programi i menaxhimit mjedisor përmban masa zbutëse për të minimizuar ndikimet e projektit në mjedisin natyror dhe për të zhvilluar shërbimet e infrastrukturës mjedisore për shmangien e ndikimeve negative si për projektin, ashtu edhe për aktorët kryesorë të tij. Këtu futen programet për monitorimin hidrologjik dhe të cilësisë së ujit, pastrimin e mbetjeve, pyllëzimin dhe pastrimin e rezervuarëve. Do të bëhet monitorim biologjik i sistemeve ujore për të identifikuar ndonjë ndryshim të ri të specieve për shkak të krijimit të rezervuarëve, si dhe në zonat e rrjedhjes së poshtme. Është arritur në përfundimin se modelet migruese nuk ndikohen shumë dhe kështu nuk janë sugjeruar masa zbutëse. Për çështje të tilla si administrimi i mbetjeve, trajtimi i ujërave të bardha e të zeza etj., janë duke u zhvilluar diskutime për të parë realizueshmërinë e këtyre programeve në perspektivën afatgjatë. Në varësi të rezultatit të këtyre diskutimeve do të merret një vendim përfundimtar mbi përfshirjen e DHP-së.

Nevojiten studime të mëtejshme të programeve të pyllëzimit, administrimit të mbetjeve dhe të ujërave të bardha e të zeza, përpara se të rekomandohet një zgjidhje përfundimtare së bashku me kostot përkatëse. Studimet janë duke u kryer dhe planet e pranuar do të bëhen publike përpara se të vihen në zbatim.

Masat për zbutjen e ndikimit mjedisor e social do të zbatohen në periudhën 2013 – 2018, duke filluar me fokusim në zonën e prekur të Banjës dhe në zonën e poshtme të projektit. Ato do të zbatohen brenda ndërlidhjeve kryesore dhe në harmonizim të ngushtë me planin kryesor të ndërtimit.

Tre figurat e mëposhtme paraqesin një përmbledhje të veprimeve të propozuara në kuadër të Programeve MMS në HEC-in e Banjës, në HEC-in Kokël<sup>1</sup> dhe në HEC-in Moglicë.

<sup>1</sup> Është e rëndësishme të vihet në dukje, se ndërtimi i HEC-it Kokël varet nga disa kushte të caktuara që rrjedhin nga marrëveshja e rishikuar e koncesionit. Masat zbutëse do të jenë në përputhje me to.




Figura 1: Masat zbutëse mjedisore e sociale të propozuara për zbatim në HEC-in Banjë




Figura 2. Masat zbutëse mjedisore e sociale të propozuara për zbatim në HEC-in Kokël




Figura 3. Masat zbutëse mjedisore e sociale të propozuara për zbatim në HEC-in Moglicë

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>2</b>
<b>PËRKUFIZIMI I TERMAVE .....</b>	<b>12</b>
<b>1. HYRJE .....</b>	<b>1</b>
1.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I NDIKIMEVE TË PROJEKTIT .....	1
1.2 PARIMET UDHËZUESE DHE SKEMA E PËRFITIMEVE.....	2
1.3 NDËRLIDHJET KRYESORE DHE DORËZIMI .....	2
1.3.1.1 RISISTEMIMI.....	5
1.4 QASJA E KONSULTIMIT .....	5
1.4.1 KONSULTIMET NË NIVEL KOMUNE.....	7
1.4.2 DIALOGU NË NIVEL FAMILJEJE DHE FSHATI.....	7
1.4.3 QASJA NDAJ GRUPEVE VULNERABËL .....	8
1.5 KUADRI ORGANIZATIV.....	9
1.6 TREGUESIT E QËNDRUESHMËRISË DHE REZULTATET E MONITORIMIT.....	10
1.6.1 PROGRAMI I MONITORIMIT PËR DHP-NË.....	13
1.7 GRUPET E INTERESIT TË PROJEKTIT DHE PËRFITUESIT PREJ TIJ .....	15
<b>2. KUADRI LIGJOR.....</b>	<b>16</b>
2.1 HYRJE.....	16
2.2 SHFRYTËZIMI DHE PRONËSIA E TOKËS.....	16
2.3 PRONAT PRIVATE - LIGJI SHQIPTAR PËR SHPRONËSIMET .....	17
2.4 TOKA SHTETËRORE (PUBLIKE) .....	18
2.4.1 GJENDJA AKTUALE.....	18
2.4.2 KUADRI LIGJOR PËR RISISTEMIMIN .....	19
2.4.3 PRONËSIA DHE PËRDORIMI I TOKËS.....	20
2.4.4 MJEDISI DHE ZONIMI I TERRITORIT .....	21
2.4.5 BURIMET FIZIKE TË PASURISË KULTURORE (BFPK).....	22
2.4.6 TË DREJTAT SHOQËRORE, TË DREJTAT E NJERIUT DHE PJESËMARRJA.....	23
2.5 PROCEDURAT E SHPRONËSIMIT .....	23
2.5.1 HYRJE.....	23
2.5.2 NATYRA E VLERËSIMIT DHE PAGESA E KOMPENSIMIT PËR SHPRONËSIMIN .....	23
2.5.3 PËRGJEGJËSITË E ORGANIZIMIT TË SHPRONËSIMIT .....	24
2.5.4 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I PROCESIT LIGJOR PËR FITIMIN E TE DREJTAVE MBI PRONËSISË (LA) .....	24
2.5.5 PËRGATITJA NGA DHP-JA E INFORMACIONIT PËR PËRDORIMIN E TOKËS.....	25
<b>3. MBËSHTETJA PËR RISISTEMIMIN DHE MJETET E JETESËS.....</b>	<b>26</b>
3.1 SITUATA AKTUALE DHE PAMJA E PËRGJITHSHME .....	26
3.2 BAZA.....	26
3.3 PROFILET E PËRGJITHSHME TË FSHATRAVE .....	28
3.3.1 HEC-I BANJË .....	29
3.3.2 HEC-I KOKËL.....	32
3.3.3 HEC-I MOGLICË .....	33
3.4 ARSYETIMI DHE QASJA .....	33
3.5 KUADRI ORGANIZATIV ME GRUPE TË NDRYSHME INTERESI .....	35
3.6 PLANIFIKIMI DHE ZBATIMI .....	35
3.6.1 INFORMACIONI DEMOGRAFIK.....	35
3.6.2 MJETET E JETESËS DHE BURIMET E TË ARDHURAVE .....	38
3.6.3 PËRZGJEDHJA E VENDIT TË RISISTEMIMIT DHE ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS .....	44
3.6.4 VETË-ZHVENDOSJA DHE TË LARGUARIT .....	45
3.6.5 STRUKTURAT DHE PROJEKTET E SHTËPIVE .....	45

3.7	ZHVILLIMI DHE MBËSHTETJA E MJETEVE TË JETESËS (ZHMJ) .....	46
3.7.1	ZHVILLIMI DHE NXITJA E BUJQËSISË .....	47
3.7.1.1	PLANET E PËRDORIMIT TË TOKËS DHE SIGURIA E PRONËSISË MBI TOKËN .....	47
3.7.1.2	DEMONSTRIMET .....	52
3.7.1.3	ZHVILLIMI I VADITJES.....	53
3.7.1.3.1	BAZA.....	53
3.7.1.3.2	QËLLIMI DHE VEPRIMTARITË.....	53
3.7.1.4	MBËSHTETJE PARAPRAKE PËR MJETET E JETESËS DHE NDËRHYRJET PËR ZHVILLIMIN (HEC-I BANJË) 54	
3.7.1.5	MIKROKREDITË DHE ZHVILLIMI I BIZNESIT TË VOGËL .....	57
3.7.1.6	PROGRAMET E TJERA .....	57
3.8	TREGUESIT SPECIFIKË TË PROGRAMIT TË RISISTEMIMIT .....	58
<b>4.</b>	<b>PROGRAMI I ZHVILLIMIT SOCIAL (PZHS).....</b>	<b>59</b>
4.1	PLANI I ZHVILLIMIT INFRASTRUKTUROR .....	60
4.1.1	BAZA E PZHI.....	60
4.1.2	QËLLIMI DHE VEPRIMTARITË .....	60
4.1.3	TREGUESIT SPECIFIKË TË PERFORMACËS SË PROGRAMIT .....	68
4.2	BURIMET E TRASHËGIMISË KULTURORE E FIZIKE .....	69
4.2.1	GJENDJA AKTUALE.....	69
4.2.2	QËLLIMI DHE VEPRIMTARITË .....	69
4.2.3	PROCEDURA E ZBULIMEVE ARKEOLOGJIKE TË RASTËSISHME .....	69
4.2.4	TREGUESIT SPECIFIKË TË PERFORMANCËS SË PROGRAMIT:.....	69
4.3	PLANI PËR SHËNDETËSINË.....	69
4.3.1	BAZA E SHËNDETËSISË.....	69
4.3.2	QËLLIMI DHE VEPRIMTARITË .....	74
4.3.3	TREGUESIT SPECIFIKË TË PERFORMANCËS SË PROGRAMIT:.....	74
4.4	PLANI PËR ARSIMIN .....	74
4.4.1	BAZA E ARSIMIT .....	74
4.4.2	FORMIMI PROFESIONAL: GJENDJA AKTUALE.....	77
4.4.3	QËLLIMI DHE VEPRIMTARITË .....	77
4.4.4	TREGUESIT SPECIFIKË TË PERFORMANCËS SË PROGRAMIT.....	78
4.5	PLANI PËR MENAXHIMIN E FLUKSIT .....	78
4.5.1	SITUATA BAZË .....	78
4.5.2	STRATEGJITË PËR MENAXHIMIN E FLUKSIT .....	80
4.5.2.1	REKRUTIMIN LOKAL DHE MENAXHIMIN E FORCËS PUNËTORE .....	80
4.5.3	QËLLIMI DHE VEPRIMTARITË .....	82
4.5.4	TREGUESIT SPECIFIKË TË PERFORMANCËS SË PROGRAMIT.....	82
<b>5.</b>	<b>PROGRAMET E MENAXHIMIT MJEDISOR .....</b>	<b>84</b>
5.1	SITUATA AKTUALE DHE PAMJA E PËRGJITHSHME .....	84
5.2	BAZA.....	84
5.3	PROFIL I PËRGJITHSHËM MJEDISOR I PROJEKTIT .....	86
5.3.1	HEC-I BANJË .....	87
5.3.2	HEC-I KOKËL .....	87
5.3.3	HEC-I MOGLICË .....	87
5.4	ARSYETIMI DHE QASJA .....	88
5.5	KUADRI ORGANIZATIV ME GRUPE TË NDRYSHME INTERESI .....	88
5.6	MENAXHIMI I REZERVUARËVE, CILËSIA E UJIT DHE EKOLOGJIA UJORE .....	89
5.6.1	HIDROLOGJIA, METEOROLOGJIA DHE SEDIMENTOLOGJIA .....	89
5.6.1.1	BAZA .....	89
5.6.1.2	QËLLIMI DHE VEPRIMTARITË .....	89
5.6.1.3	MBLEDHJA E TË DHËNAVE HIDROLOGJIKE, METEOROLOGJIKE DHE SEDIMENTOLOGJIKE .....	90



5.6.1.4	REZULTATET SPECIFIKE TË PROGRAMIT .....	91
5.7	MENAXHIMI I REZERVUARËVE: CILËSIA E UJIT DHE BIODIVERSITETI .....	91
5.7.1	CILËSIA E UJIT .....	91
5.7.1.1	MONITORIMI I EKOLOGJISË UJORE.....	95
5.7.1.1.1	VËZHGIMI I FLORËS DHE FAUNËS TOKËSORE .....	95
5.7.2	MENAXHIMI I UJËRAVE TË NDOTURA DHE KANALIZIMIT TË UJËRA TË ZEZA .....	96
5.7.2.1	BAZA .....	96
5.7.2.2	QËLLIMI DHE VEPRIMTARITË .....	96
5.7.2.3	TREGUESIT SPECIFIKË TË PERFORMACËS SË PROGRAMIT .....	97
5.8	MENAXHIMI I MBETJEVE .....	98
5.8.1	BAZA.....	98
5.8.2	QËLLIMI DHE VEPRIMTARITË .....	99
5.8.3	TREGUESIT SPECIFIKË TË PERFORMACËS SË PROGRAMIT.....	100
5.9	PROGRAMI I PYLLËZIMIT .....	100
5.9.1	BAZA.....	100
5.9.2	QËLLIMI DHE VEPRIMTARITË .....	100
5.9.3	TREGUESIT SPECIFIKË TË PERFORMACËS SË PROGRAMIT.....	101
5.10	PROGRAMI PËR RRJEDHËN E POSHTME .....	101
5.10.1	BAZA .....	101
5.10.2	SEKSIONI MOGLICË DERI NË KOKËL (RRJEDHA E POSHTME E MOGLICËS):.....	102
5.10.3	SEKSIONI KOKËL DERI NË REZERVUARIN E BANJËS (RRJEDHA E POSHTME E KOKLIT):.....	102
5.10.4	RRJEDHA E POSHTME E BANJËS .....	102
5.10.5	QËLLIMI DHE VEPRIMTARITË .....	103
5.11	KUSHTET MJEDISORE PËR AKTIVITETE TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI.....	103
5.11.1	TREGUESIT SPECIFIKË TË PERFORMANCËS SË PROGRAMIT: .....	104
<b>6.</b>	<b>MEKANIZMI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE.....</b>	<b>105</b>
<b>SHTOJCA 1.....</b>	<b>.....</b>	<b>107</b>
	<i>PARIMET UDHËZUESE DHE SKEMA E PËRFITIMEVE PËR PROJEKTIN HIDROENERGJETIK TË DEVOLLIT (DHP) ..</i>	<i>107</i>
	<i>QËLLIMI.....</i>	<i>107</i>
	<i>REFERENCAT .....</i>	<i>107</i>
	<i>PARIMET UDHËZUESE TË PROJEKTIT HIDROENERGJETIK TË DEVOLLIT .....</i>	<i>107</i>
	<i>SKEMA E PËRFITIMEVE PËR RI-SISTEMIMIN DHE KOMPENSIMIN.....</i>	<i>108</i>

## FIGURAT

<i>Figura 1: Masat zbutëse mjedisore e sociale të propozuara për zbatim në HEC-in Banjë .....</i>	<i>4</i>
<i>Figura 2. Masat zbutëse mjedisore e sociale të propozuara për zbatim në HEC-in Kokël.....</i>	<i>5</i>
<i>Figura 3. Masat zbutëse mjedisore e sociale të propozuara për zbatim në HEC-in Moglicë.....</i>	<i>6</i>
<i>Figura 4: Struktura organizative që tregon stafin e menaxhimit mjedisor dhe social .....</i>	<i>9</i>
<i>Figura 5: Harta e përdorimit të tokës në HEC-in e Banjës.....</i>	<i>48</i>
<i>Figura 6: Harta e fshatit Drizë.....</i>	<i>49</i>
<i>Figura 7: Harta e përdorimit të tokës në zonën e HEC-it Kokël .....</i>	<i>50</i>
<i>Figura 8: Harta e përdorimit të tokës në zonën e HEC-it Moglicë.....</i>	<i>51</i>
<i>Figura 9: Rrugët rurale të propozuara për zëvendësim në Banjë.....</i>	<i>63</i>
<i>Figura 10: Rrugët rurale të propozuara për zëvendësim në Moglicë.....</i>	<i>64</i>
<i>Figura 11: Linjat e shpërndarjes së energjisë në rrjedhën e poshtme të Banjës .....</i>	<i>66</i>
<i>Figura 12: Linjat e shpërndarjes së energjisë në rrjedhën e sipërme të Banjës.....</i>	<i>67</i>
<i>Figura 13: Linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike në Moglicë.....</i>	<i>68</i>
<i>Figura 14: Struktura shëndetësore në Zonën e Projektit Devoll.....</i>	<i>70</i>
<i>Figura 15: Infrastruktura shëndetësore ekzistuese në zonën e HEC-it Banjë .....</i>	<i>71</i>

Figura 16: Infrastruktura shëndetësore ekzistuese në zonën e HEC-it Kokël .....	72
Figura 17: Infrastruktura shëndetësore ekzistuese në zonën e HEC-it Moglicë .....	73
Figura 18: Vendet e marrjes së kampionëve dhe stacionet e matjeve në Banjë.....	93
Figura 19: Vendet e marrjes së kampionëve dhe stacionet e matjeve në Kokël .....	94
Figura 20: Zonat e derdhjes së ujërave të zeza dhe të mbetjeve (Banjë).....	98
Figura 21: Mekanizmi i shqyrtimit të ankesave (MSHA) i projektit DHP.....	105

## TABELAT

Tabela 1: Rezultatet, treguesit e performancës dhe objektivat .....	12
Tabela 2: Ndërlidhjet e grupeve të interesit dhe përfituesve të projektit me programet përkatëse MMS.....	15
Tabela 3: Detajet për inventarët e asetëve të marra për familjet e mundshme që mund të preken nga projekti (FPP). .....	28
Tabela 4: Detajet mbi aktivitetet e konsultimit për risistemimin (fshat dhe familje).....	34
Tabela 5: Detajet për banesat që mund të preken.....	36
Tabela 6: Lista e strukturave dhe ndërtesave të tjera në asetet e tokave të FPP-ve (të vlerësuara deri më sot). .....	37
Tabela 7: Burimet e përgjithshme të mjeteve të jetesës në disa nga fshatrat e përzgjedhur që preken nga projekti ...	42
Tabela 8: Burimet e të ardhurave për zonat e HEC-it Banjë bazuar në informacionet e regjistrimit të asetëve.....	43
Tabela 9: Varësia/burimet e të ardhurave në fshatrat e përzgjedhur të HEC-it Banjë .....	44
Tabela 10: Varësia/burimet e të ardhurave në fshatrat e përzgjedhur të HEC-it Kokël dhe Moglicë .....	44
Tabela 11: Veprimtaritë e propozuara demonstruese për fshatrat që preken nga HEC-i i Banjës.....	53
Tabela 12: ZHMJ-të e mundshme për fshatrat e prekur nga HEC-i Banjë.....	57
Tabela 13: Ndërrhyrjet e propozuara .....	62
Tabela 14: Ndërrhyrjet e propozuara (për ujën).....	66
Tabela 15: Linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike të tensionit të ulët që mund të preken .....	68
Tabela 16: Informacioni bazë për infrastrukturën arsimore në zonën e HEC-it Banjë .....	75
Tabela 17: Masat zbutëse të propozuara për ndikimet në arsim .....	77
Tabela 18: Pamje e përgjithshme e burimeve të të dhënave bazë.....	86
Tabela 19: Testimet laboratorike.....	90
Tabela 20: Pajisjet laboratorike .....	91
Tabela 21: Parametrat e monitorimit .....	92

## SHKURTIMET DHE AKRONIMET

BB	Banka Botërore
BD	Bordi Drejtues i DHP-së
BTKF	Burimet e trashëgimisë kulturore e fizike
DHP	Devoll Hydropower
FPP	Familje e prekur nga projekti
FRA	Formular i regjistrimit/inventarit të aseteve
GIP	Grup institucional i punës
GIS	Sistem i informacionit gjeografik
HEC	Hydrocentral
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare (Banka Botërore)
IHA	Shoqata Ndërkombëtare Hidroenergjetike
KD	Komiteti Drejtues i DHP-së
KM	Këshilli i Ministrave
L&L	Lejet dhe licencat
LT	Linja transmetimi
M&S	Mjedisor dhe social
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Qeveria e Shqipërisë
MK	Marrëveshje koncesioni
MMS	Menaxhimi mjedisor dhe social
MU	Marrëveshje uzufukti
NK	Ndërlidhësi me komunitetin
NJQV	Njësi e qeverisjes vendore
OJQ	Organizatë joqeveritare
PAR	Plani arsimor rajonal
PM	Masterplan (referuar gjithashtu edhe si PMMS)
PMMS	Plani i menaxhimit mjedisor dhe social (referuar gjithashtu edhe si MP)
PMMZ	Plani i menaxhimit dhe i masave zbutëse të mjedisit
PMS	Plani i menaxhimit social
PPP	Person i prekur nga projekti
PSHR	Plani shëndetësor rajonal
PT	Përdorimi i tokës
PVR	Plani i veprimtimit për risistemimin
PVZ	Plani vjetor i zbatimit
PZHI	Plani i zhvillimit infrastrukturor
PZHR	Plani i zhvillimit rajonal
QeSH	Qeveria e Shqipërisë
QSH	Qendër shëndetësore
RoW	Servituti i kalimit
SP	Skema e përfitimeve
SST	Sëmundje seksualisht e transmetueshme
SHRRM	Shkarkimi i rrjedhës në mjedis
VNM	Vlerësimi i ndikimit në mjedis
VNMS	Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social
VNS	Vlerësimi i ndikimit social
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
ZHMJ	Zhvillimi dhe mbështetja e mjeteve të jetesës

## PËRKUFIZIMI I TERMAVE

**Persona të prekur nga projekti (PPP)** - nënkupton çdo person ose persona, ose institucion publik, i cili për shkak të ndryshimeve të shkaktuara nga projekti (i) pëson ndikim negativ në standardin e tij të jetesës; (ii) pëson ndikim negativ të plotë ose të pjesshëm, të përhershëm apo të përkohshëm, nga blerja, fitimi i të drejtave të pronësisë mbi tokën, kufizimi ose nga ndonjë mënyrë tjetër në të drejtën, titullin ose interesin e tij mbi ndonjë shtëpi, tokë (përfshirë truallin e banimit, tokën tregtare, bujqësore, pyjore dhe/ose kullotat), burime ujore ose mbi ndonjë pasuri tjetër të luajshme ose të paluajshme; dhe/ose që (iii) pëson ndikim negativ mbi biznesin, profesionin, vendin e punës, të banimit ose të mjedisit të jetesës, me ose pa zhvendosje.

Në rastin e familjeve (**FPP**), ajo përfshin të gjithë anëtarët që banojnë së bashku dhe funksionojnë si një njësi e vetme ekonomike, të cilët ndikohen negativisht nga projekti ose nga ndonjë pjesë e tij.

FPP dhe FPP përdoren në shumë raste në vend të njëra-tjetrës për t'iu referuar të njëjtit qëllim.

**Kompensimi** - është pagesa monetare ose në natyrë për të zëvendësuar humbjet nga Projekti të tokës, të shtëpisë, të të ardhurave ose asetëve të tjera. I gjithë kompensimi bazohet në parimin e zëvendësimit të kostos, e cila është metoda e vlerësimit të asetëve për t'i zëvendësuar humbjet me vlerën aktuale të tregut, plus çdo kosto transaksioni (d.m.th. tarifave administrative, taksat, kostot e regjistrimit dhe të marrjes së titujve).

**Ankues** – Një individ ose grup, që ka një çështje, shqetësim, problem, ankesë apo pretendim (të perceptuar ose real) që ai, ajo ose ata duan që të trajtohet dhe/ose të zgjidhet.

**Data e fundit** - I referohet datës përpara së cilës zënia ose përdorimi i tokës në zonën e projektit i bën që banorët/përdoruesit e saj të kategorizohen si FPP (referuar edhe si FPP), pavarësisht statusit të pronësisë. Në këtë Projekt, nuk ka pasur datë të fundit të paracaktuar dhe në vend të saj do të jetë data e mbledhjes së informacionit nga studimet bazë dhe procesi i regjistrimit/inventarit të asetëve.

**E drejta e kompensimit** - është tërësia e masave përfshirë kompensimin monetar ose në natyrë, mbështetjen për rikthimin e të ardhurave, ndihmesën në transferim, zëvendësimin e të ardhurave dhe mbështetjen për zhvendosjen, të synuara për personat e ndikuar në varësi nga natyra e humbjeve të tyre, për të rikuperuar gjendjen e tyre ekonomike e sociale.

**Ankesë** - Ankesa është një shqetësim ose ankesë e ngritur nga një individ ose grup individësh brenda komuniteteve të ndikuara nga veprimtaria e DHP-së, ose nga aktorë të tjerë që veprojnë në emër të tyre, sipas rastit. Shqetësimet dhe ankesat mund të shkaktohen nga ndikimi real ose i perceptuar i veprimtarisë aktuale apo të shkruar të DHP-së dhe mund të paraqiten në të njëjtën mënyrë e të trajtohen me të njëjtat procedura.

**Mekanizmi i shqyrtimit të ankesave (MSHA në nivel projekti)** – Një MSHA në nivel projekti për komunitetet e prekura, është procesi i marrjes, transmetimit, vlerësimit dhe i trajtimit në kohën dhe në mënyrën e duhur të çështjeve ose ankesave të ngritura nga komunitetet e prekura në lidhje me projektin. Në varësi të rëndësisë dhe rigozitetit të çështjes, mund të jetë i nevojshëm hetimi, dhe pas të gjitha përpjekjeve për një zgjidhje miqësore nëpërmjet dialogut, mund të nevojitet gjykimi i jashtëm. Parimisht kjo është një metodë e formuar dhe e institucionalizuar që konsiston në role, rregulla dhe procedura të specifikuar për zgjidhjen sistematike të ankesave, mosmarrëveshjeve ose konflikteve. Ajo gjithashtu përfshin ankesat kundër veprimeve të kontraktorëve dhe nënkontraktorëve në lidhje me veprimtarinë e DHP-së.

**Fitimi i të drejtës së pronësisë mbi tokën** - është procesi përmes të cilit një FPP detyrohet nga një agjenci publike (në këtë rast, Qeveria e Shqipërisë) të kalojë të gjithë tokën që ka në pronësi apo zotërim të

saj, apo një pjesë të tij, në pronësinë apo zotërimin e kësaj agjencie për qëllime publike, në këmbim të një kompensimi të barasvlershëm me kostot e zëvendësimit të aseteve të ndikuara ose siç mund të parashikohet ndryshe nga legjislacioni vendas ose marrëveshjet e tjera.

**Kujdesi shëndetësor parësor** - është niveli bazë i kujdesit shëndetësor që përfshin programe që synojnë promovimin e shëndetit, diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve apo paaftësisë, si dhe parandalimin e sëmundjeve. Ky shërbim ofrohet nga doktorë dhe infermiere që punojnë me komunitetin.

**Rehabilitimi** - është ndihma monetare ose në natyrë që i jepet FPP-ve për shkak të humbjes së aseteve prodhuese, të të ardhurave, punësimit ose të burimeve të jetesës, për të plotësuar pagesën e kompensimeve monetare të aseteve të përvetësuara, në mënyrë që të arrihet të paktën rikthimi i plotë i standardeve dhe cilësisë së jetës (bazuar në standardet para projektit).

**Zhvendosja** - është zhvendosja fizike e një familjeje të prekur nga vendi i banimit që ka pasur përpara projektit, në një vend tjetër brenda të njëjtin komunitet.

**Risistemimi** – ka kuptimin që i është dhënë në përmbajtjen e këtij dokumenti.

**Kujdesi shëndetësor dytësor** - është një nivel i ndërmjetëm i kujdesit shëndetësor që përfshin diagnostikimin dhe trajtimin, i kryer në një spital që ka pajisje të specializuara dhe mjete laboratorike.

**Vulnerabël** - janë grupe të veçanta personash, të cilët mund të mos përfitojnë në mënyrë proporcionale ose që rrezikojnë të marginalizohen nga efektet e risistemimit, ku përfshihen në mënyrë specifike: (i) familjet me kryefamiljare gra, të moshuar ose persona me aftësi të kufizuar, (ii) familjet që janë nën nivelin e pranuar gjerësisht të treguesit të varfërisë – që nuk kanë ushqim të mjaftueshëm, dhe (iii) familjet pa tokë.

## 1. HYRJJE

Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) përmban të gjitha masat zbutëse mjedisore e sociale për Projektin Hidroenergjetik të Devollit (DHP). Plani paraqet në mënyrë të përmbledhur ndikimet, përcakton politikën dhe çështje të tjera kryesore, si dhe parashikon një kuadër të përgjithshëm për risistemimin, rehabilitimin e mjeteve të jetesës, dhe iniciativat e zhvillimit rajonal. Përveç kësaj, ka kapituj specifikë që i kushtohen menaxhimit mjedisor dhe monitorimit të tij. Karakteristikat përkatëse mund të përditësohen dhe bëhen publike sipas nevojës.

Me synimin për të qenë në përputhje me parimet dhe udhëzimet e Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) për vlerësimin mjedisor dhe social, zbutjen dhe monitorimin, qëllimi kryesor i këtij dokumenti është ofrimi i një vështrimi të përgjithshëm i të gjitha masave zbutëse që duhen ndërmarrë (për ndikimet e njohura). Gjithashtu, ai konsolidon dhe analizon rezultatet dhe sondazhet e kryera tashmë gjatë fazës parapërgatitore të projektit (Para-ndërtimore), si dhe studimet dhe analizat e shumta të detajuara dhe suplementare nga konsulentët dhe specialistët. Në të njëjtën kohë, kjo strategji do jetë një dokument kuadër për planet e detajuara vjetore të zbatimit (PVZ), të cilët hartohen çdo vit dhe miratohen nga DHP-ja. PVZ-të do të jenë dokumenti kryesor i zbatimit me anë të të cilit do të matet ecuria dhe performanca, si dhe ku do të përfshihet çdo çështje që do të dalë gjatë fazës së zbatimit të projektit.

Dinamika e zhvillimit karakterizohet nga natyra e tij në ndryshim të vazhdueshëm dhe potencialisht të përshtatet dhe të ndryshohet sipas situatës në terren, duke përdorur parimet përshtatëse të menaxhimit brenda kuadrit të politikës dhe standardeve të IFC-së. Kjo bëhet kryesisht për arsyen, sepse zbatimi aktual i planeve të parashtruara është i lidhur ngushtë dhe në varësi të përfshirjes së shumë grupeve kryesore të interesit. Pjesëmarrja, vullneti dhe përkushtimi i grupeve të interesit për të bashkëpunuar janë çështje kyçe që mund të kërkojnë rishikimin e disa prej programeve. Këto ndryshime do të përshkruhen në detaje në planet e ndryshme vjetore të zbatimit (PVZ). Shpenzimet e parashikuara (deri më sot) për masat zbutëse sociale dhe mjedisore parashikohen mbi 5% të kostos totale të projektit dhe janë përfshirë në kuadrin e përgjithshëm të buxhetit të DHP-së. Ky është ndarë sipas seksioneve të poshtëpërmendura dhe përfshin veprimet e propozuara brenda programeve mjedisore dhe sociale në HEC-in Banjë, HEC-in Kokël dhe në HEC-in Moglicë.

Ky raport është përgatitur nga Njësia për Menaxhimin Mjedisor dhe Social dhe autorët kryesorë janë Maria Luisa Duran, Erjon Kalaja, Eteda Kaja, Erjon Zogolli dhe Pål Høberg. I shprehim mirënjohjen tonë z. Stephen J. Sparkes dhe kontribuesve të tjerë në këtë dokument që janë përfshirë në program.

### 1.1 Vështrim i përgjithshëm i ndikimeve të projektit

Përshkrimi i plotë i veçorive teknike për të tria projektet e DHP-së që ndodhen në Banjë, Kokël dhe Moglicë jepet në dokumentet teknike dhe përmbledhja gjendet në VNMS (Norconsult, qershor 2011). Në ndikimet sociale kryesore të projektit përfshihen:

- Humbja e tokës bujqësore për shkak të përmytjeve (tokë private dhe publike)
- Risistemimi i mundshëm i rreth 70 familjeve për shkak të përmytjeve (shtëpi banimi dhe verimi). Numri përfundimtar i familjeve varet nga projektimet e rrugës (aksesi) dhe konsultimet e detajuara.
- Humbja e infrastrukturës (rrugë, ura etj.) për shkak të ndërtimeve dhe përmytjeve, pengesa në akses
- Mundësitë potenciale të punësimit, të rritura nga programet për zhvillimin e aftësive
- Mundësitë e përmirësuar të tregut gjatë ndërtimit (rritja e kërkesës) që mund të vazhdojë si rezultat i përmirësimit të infrastrukturës.

Në ndikimet mjedisore kryesore përfshihen:

- Humbja e rreth 1421 ha tokë pyjore (përfshirë kullotat) për shkak të përmytjeve
- Ndryshimet e konsiderueshme në regjimin hidrologjik të lumit
- Problemet e mundshme me cilësinë e ujit nga krijimi i rezervuarëve
- Problemet e mundshme me menaxhimin e mbetjeve të shtuara si rezultat i rritjes së numrit të popullsisë dhe kampeve (të menaxhuara nga njësia HSE (Shëndeti, Siguria, Mjedisi në aktivitetet e ndërtimit) e DHP-së)
- Problemet e mundshme me ndotjen, sedimentet dhe erozionin që lidhen me aktivitetet e ndërtimit (të menaxhuara nga HSE e DHP-së)
- Vështirësitë në trajtimin e mbetjeve dhe të materialeve të rrezikshme në një mënyrë të pranueshme për mjedisin (menaxhuar nga HSE e DHP-së)
- Ndikimi i mundshëm në speciet endemike të florës
- Shqetësimi i jetës së egër shtazore gjatë periudhës së ndërtimit dhe krijimit të rezervuarëve
- Ndryshimet afatgjata nga një mjedis lumor në një mjedis liqenor përgjatë lumit Devoll – ndikimet në ekologjinë ujore, cilësinë e ujit dhe modelet migratore.

### **1.2 Parimet udhëzuese dhe skema e përfitimeve**

Parimet udhëzuese dhe skema e përfitimeve e DHP-në janë miratuar nga Bordi Drejtues i DHP-së më 8 maj 2012 dhe u përkthyen në shqip menjëherë pas miratimit. Përpara kësaj, detajet u diskutuan fillimisht me zyrtarë kryesorë të qeverisë dhe njoftimi zyrtar për publikun u bë në qershor 2012. Ky dokument është i nevojshëm për të informuar familjet e prekura nga projekti (FPP) për të drejtat e tyre dhe mundësitë për kompensim dhe zbutje, dhe nisi dialogun lidhur me opsionet e mbështetjes me mjete jetese të qëndrueshme që do të ofohen nga DHP-ja.

Këto parime udhëzuese dhe skema e përfitimeve përcaktojnë angazhimet e DHP-së për familjet e prekura nga projekti (FPP) në lidhje me zbutjen e ndikimeve të projektit dhe promovimin e mundësive të zhvillimit nga projekti në luginën e Devollit. Masat e renditura në skemë do të realizohen nga DHP-ja dhe autoritetet përkatëse të qeverisë shqiptare. Teksti i dokumentit është bashkëngjitur në shtojcën 1.

Duhet të jetë e qartë se këto masa kompensuese, të cilat do të zbatohen aty ku është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, do të projektohen dhe do të përgatiten në konsultim me FPP-të dhe grupe të tjera interesi, me synimin për të zhvilluar zgjidhjen më të përshtatshme për rrethanat specifike të komunitetit dhe individëve.

Mungesa e vullnetit e FPP-ve për të pranuar ndihmën shtesë të ofruar nga DHP-ja për mjetet e jetesës, siç tregohen në skemën e përfitimeve (bazuar në një datë të paracaktuar përfundimtare), nënkuptohet si pranim i standardeve të qeverisë shqiptare sipas marrëveshjes së koncesionit, e cila kërkon vetëm pagesat e shpronësimit me qëllim që DHP-ja të sigurojë marrëveshjet e saj të uzufruktit me qeverinë shqiptare. Supozohet se do të ketë një numër të kufizuar të FPP-ve që përfshihen në këtë kategori, por duhet të jetë e qartë se DHP-ja nuk mund të vendosë standarde mjedisore dhe të mbrojtjes sociale përtej asaj që parashikohet në marrëveshjen e koncesionit ose në ligjin shqiptar.

### **1.3 Ndërlidhjet kryesore dhe dorëzimi**

Është thelbësore që këto aktivitete dhe programe sociale dhe mjedisore të shihen në kontekstin e axhendës së ndërtimit dhe të projektit si një i tërë. Lista në vijim është një listë e ndërlidhjeve kryesore që duhen marrë në konsideratë dhe duhen mbajtur parasysh në planifikimin dhe koordinimin e aktiviteteve ndërmjet DHP-së dhe qeverisë shqiptare:

- Shpronësimi për tokat ku do të ndërtohet projekti duhet të ketë përfunduar përpara fillimit të ndërtimit
- Konsultimet individuale me familjet duhet të jenë kryer përpara humbjes së tokës produktive
- Rrugët dhe urat në zonën e përmytur duhet të kenë përfunduar përpara mbushjes së rezervuarit
- Infrastruktura private dhe e komunitetit (furnizimi me ujë, energjia elektrike dhe të tjera) në zonat e prekura/të përmytura duhet të ketë përfunduar dhe të jetë funksionale përpara mbushjes së rezervuarit / zhvendosjes së FPP-ve.
- Zhvendosja e shtëpive dhe e strukturave të tjera duhet të bëhet përpara mbushjes së rezervuarit.
- Zhvendosja e biomasës nga zona e përmytur duhet të bëhet përpara mbushjes së rezervuarit.
- Zhvendosja e mbeturinave dhe e mbetjeve nga zona e përmytur duhet të bëhet përpara mbushjes së rezervuarit.
- Marrëveshjet me qeverinë shqiptare për shkarkimin e ujit nga diga e Banjës për të siguruar ujë të mjaftueshëm për rrjedhën e poshtme të lumit (sistemet e ujitjes në Thanë) duhet të bëhen përpara shfrytëzimit/fillimit të prodhimit.





ID	Task Name	Start	Finish	Timeline											
				3rd Quarter 07   09   11	1st Quarter 01   03   05	2nd Quarter 07   09   11	1st Quarter 01   03   05	2nd Quarter 07   09   11	1st Quarter 01   03   05	2nd Quarter 07   09   11	1st Quarter 01   03   05	2nd Quarter 07   09   11	1st Quarter 01   03   05	2nd Quarter 07   09   11	1st Quarter 01   03   05
126	<b>DHP Programme &amp; Company Management</b>	Tue 03.04.12	Fri 18.09.16	[Timeline bar]											
224	<b>Environmental and Social Management</b>	Mon 02.04.12	Mon 28.01.19	[Timeline bar]											
225	Resettlement and Livelihood Support	Mon 01.04.13	Fri 28.12.18	[Timeline bar]											
226	Resettlement Program - Banja HPP	Mon 01.04.13	Fri 30.09.16	[Timeline bar]											
229	Physical Relocation and Replacement Infrastructure	Mon 02.09.13	Fri 28.08.15	[Timeline bar]											
230	Residences and other structures (replacement of cash compensation)	Tue 01.10.13	Tue 31.03.15	230 [Timeline bar] Residences and other structures (replacement of cash compensation)											
231	Provision of replacement residential/business land (for relocating PAHs) (25 houses)	Mon 02.09.13	Fri 28.08.15	[Timeline bar]											
242	Pumping Station - Goshtine	Mon 09.12.13	Fri 20.06.14	[Timeline bar]											
249	Improvement of Mazrek Road	Mon 02.12.13	Fri 13.03.15	[Timeline bar]											
257	Improvement of Cerrik irrigation system	Mon 02.12.13	Fri 01.05.15	[Timeline bar]											
265	Livelihood Support and Development (LSD)	Mon 01.04.13	Fri 30.09.16	[Timeline bar]											
266	Trials, demonstrations, trainings and field visits	Mon 01.04.13	Wed 30.09.15	266 [Timeline bar] Trials, demonstrations, trainings and field visits											
267	Livelihood packages of cash compensation (structures)	Mon 01.07.13	Fri 30.09.16	267 [Timeline bar] Livelihood packages of cash compensation (structures)											
268	Resettlement Program - Moglice HPP	Mon 13.01.14	Fri 28.12.18	[Timeline bar]											
270	Sign Agreements	Mon 13.01.14	Fri 30.03.18	270 [Timeline bar] Sign Agreements											
271	Physical Relocation and Replacement Infrastructure	Mon 05.01.15	Fri 29.09.17	[Timeline bar]											
277	Livelihood Support and Development (LSD)	Mon 05.01.15	Fri 28.12.18	[Timeline bar]											
282	Social Development Program	Mon 02.04.12	Fri 28.12.18	[Timeline bar]											
283	Banja HPP, Replacement of agreed Infrastructure (if any) w/ GoA	Tue 01.01.13	Fri 25.12.15	[Timeline bar]											
284	Access Roads leading the the New Road Banja Gramsh	Mon 04.11.13	Fri 04.09.15	[Timeline bar]											
321	Health Program	Tue 01.01.13	Fri 26.06.15	[Timeline bar]											
326	Education Program	Tue 01.01.13	Fri 25.12.15	[Timeline bar]											
332	Influx Management / Community Safety and Awareness Plan	Mon 01.07.13	Fri 25.12.15	[Timeline bar]											
337	Relocation cultural items, ceremonies and replacement of any immovable objects	Tue 01.10.13	Fri 26.12.14	[Timeline bar]											
339	Village Infrastructure (access village roads)	Tue 01.01.13	Wed 30.09.15	[Timeline bar]											
343	Moglice HPP	Mon 02.04.12	Fri 28.12.18	[Timeline bar]											
344	Health Program	Tue 01.07.14	Fri 21.12.18	[Timeline bar]											
349	Education Program	Mon 01.07.13	Fri 29.06.18	[Timeline bar]											
355	Influx Management / Community Safety and Awareness Plan	Tue 01.07.14	Fri 28.12.18	[Timeline bar]											
362	Relocation cultural items, ceremonies and replacement of any immovable objects	Mon 29.12.14	Fri 25.12.15	[Timeline bar]											
364	Replacement Infrastructure (water and electrical supply)	Mon 02.04.12	Mon 02.04.12	[Timeline bar]											
365	Village Infrastructure (access village roads)	Tue 01.07.14	Fri 30.03.18	[Timeline bar]											
371	Environmental Management Program	Mon 01.04.13	Mon 28.01.19	[Timeline bar]											
372	Monitoring of Hydrology, Meteorology and Sedimentology	Tue 01.10.13	Mon 28.01.19	[Timeline bar]											
383	Reservoir management, Water quality and Aquatic ecology	Tue 01.10.13	Mon 31.12.18	[Timeline bar]											
384	Water quality and aquatic ecology	Thu 02.01.14	Mon 31.12.18	[Timeline bar]											
385	Sampling and DHP Laboratory test	Thu 02.01.14	Mon 31.03.14	385 [Timeline bar] Sampling and DHP Laboratory test											
386	Aquatic ecology monitoring	Wed 01.10.14	Mon 31.12.18	386 [Timeline bar] Aquatic ecology monitoring											
387	Terrestrial Flora and Fauna observation	Wed 01.10.14	Mon 31.12.18	387 [Timeline bar] Terrestrial Flora and Fauna observation											
388	Sewage and Wastewater Management	Tue 01.10.13	Fri 30.11.18	[Timeline bar]											
389	Carry out a full assessment of the current system within the Devoll catchment area	Tue 01.10.13	Fri 14.03.14	389 [Timeline bar] Carry out a full assessment of the current system within the Devoll catchment area											
402	Waste Management	Tue 01.10.13	Mon 31.12.18	[Timeline bar]											
416	Forestry program	Tue 01.10.13	Thu 27.09.18	[Timeline bar]											
428	Downstream Program	Mon 31.03.14	Fri 28.09.18	[Timeline bar]											
437	Data, Gis, WebGIS and Database	Mon 01.04.13	Mon 31.12.18	[Timeline bar]											
438	Devoll river water quality data aquisition	Mon 01.07.13	Mon 31.12.18	[Timeline bar]											
442	Hydrology, Sedimentology and Meteorology data	Mon 01.07.13	Mon 31.12.18	[Timeline bar]											
447	Forestry data	Tue 01.04.14	Tue 30.09.14	[Timeline bar]											
451	Gis	Mon 01.07.13	Mon 31.12.18	[Timeline bar]											
454	Resettlement and Social Development	Mon 01.04.13	Mon 31.12.18	[Timeline bar]											

Parimet dhe hapat kryesorë të mësipërm tregojnë natyrën kritike të zbatimit të risistemimit brenda programit të menaxhimit mjedisor dhe social si një i tërë. Duhet të bëhet në kohë dhe sipas standardeve të kërkuara për të cilat DHP ka rënë dakord, me qëllim parandalimin e vonesave për projektin. Ndërkohë që marrëveshja e koncesionit (MK) citon se qeveria shqiptare është e vetmja përgjegjëse për risistemimin, në terma më praktikë do të ketë dy palë përgjegjëse në marrëveshjet për risistemimin dhe mbështetjen me mjetet e jetesës (DHP dhe qeveria shqiptare). Nëpërmjet marrëveshjeve të mëparshme për veprime specifike për aktivitetin mbi rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë, mund të parashtrohen disa garanci për realizimin e këtyre detyrimeve dhe natyrën e tyre, sidomos në lidhje me investimet e projektit në infrastrukturë që kërkojnë menaxhim afatgjatë (përtej fazës së zbatimit të projektit).

Përmbytja duhet ndaluar derisa të gjitha familjet e prekura që jetojnë dhe shfrytëzojnë tokën në nivelin e rezervuarit të jenë zhvendosur dhe të jenë realizuar fazat e para të ofrimit të paketave të mjeteve të jetesës. Është e rëndësishme të theksohet se zhvendosja fizike është përgjegjësi e qeverisë shqiptare dhe e agjencive të saj. Nëse DHP-ja zgjedh që të marrë përsipër ndonjë pjesë të kësaj përgjegjësie, kushtet për këtë duhen përcaktuar dhe miratuar në mënyrën e duhur.

Një çështje kyçe që duhet marrë në konsideratë në çdo ndërhyrje është strategjia afatgjatë për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin për programet e DHP-së në secilën zonë të HEC-ve. Përveç bashkëpunimit në vendimmarrje për ndërhyrjet specifike, strategjitë e dorëzimit do të zhvillohen të lidhura me propozimet e këtyre aktiviteteve, sidomos ato që përfshijnë infrastrukturën e shtëpive dhe të komunitetit që më pas do të merren në dorëzim ose nga qeveria shqiptare, ose nga grupet dhe familjet e prekura nga projekti. Për afatet kohore, hapat, angazhimet dhe procesin e dorëzimit nevojitet një marrëveshje me të gjitha grupet e interesit përpara zbatimit.

#### **1.3.1.1 Risistemimi**

Ka vetëm një seksion të marrëveshjes së koncesionit që trajton risistemimin e personave të prekur nga projekti për shkak të marrjes së tokës. Klauzola 3.4.6 (d) e marrëveshjes së koncesionit parashikon që *“Autoriteti Kontraktues do të jetë plotësisht përgjegjës për shpërnguljen e çdo personi dhe zhvendosjen e pronës nga çdo tokë e shpronësuar në përputhje me këtë Nen 3.4.6”* Duhet të ketë një fokus specifik në identifikimin e vendeve të mundshme të risistemimit për FPP-të që preken nga HEC-i i Moglicës. Si rrjedhim, nevojitet një planifikim i detajuar me qeverinë shqiptare për të përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë reale të secilës palë në drejtim të adresimit të detyrimeve përkatëse për këtë çështje. .

#### **1.4 Qasja e konsultimit**

Këshilli i Ministrave i Shqipërisë ka nxjerrë rregullore për konsultimet në lidhje me projektet e mëdha të zhvillimit, ku jepen përshkrime të detajuara të asaj se çfarë kërkohet në faza të ndryshme të përgatitjes së projektit dhe të procesin e vlerësimit. Politika për qëndrueshmërinë mjedisore dhe sociale e parashtuar përmes udhëzimeve të IFC-së kërkon përkushtim për angazhimin e komunitetit që garanton *“konsultim falas, paraprak dhe informues të komuniteteve që preken, duke çuar në mbështetje të gjerë nga komuniteti për projektin.”* Përhapja e informacionit, konsultimi dhe pjesëmarrja me një gamë të gjerë grupesh interesi janë procese jetike për planifikimin dhe zbatimin e programeve sociale dhe mjedisore. Në terma të përgjithshëm, grupet e interesit përfshijnë çdo individ ose grup që preken ose supozohet se preket nga Projekti i Devollit; dhe çdo individ ose grup që luan një rol të rëndësishëm në formësimin ose ndikimin e projektit, qoftë pozitivisht ose negativisht, duke përfshirë komunitetin pritës (IFC 2002).

Konsultimet e hershme dhe shkëmbimi i informacionit kanë ndihmuar në menaxhimin e pritshmërive publike në lidhje me ndikimet mbi komunitet dhe tek individët. Konsultimet ofruan një mundësi për projektin dhe përfaqësuesit e FPP-ve për të diskutuar një mori çështjesh duke përfshirë, por pa u kufizuar me, arsimin, shëndetësinë, ujin dhe higjienën, infrastrukturën, paketat e kompensimit dhe kërkesat e pranueshmërisë, ndihmën për risistemimin, asistencën me mjetet e jetesës – që vinin si rezultat i skemës së përfitimeve të DHP-së –, si dhe planifikimin e detajuar dhe përcaktimin e afateve

për këto risistemime dhe për nismat e zhvillimit social. DHP-ja ka organizuar dhe moderuar një sërë aktiviteteve informuese dhe konsultimesh pjesëmarrëse me grupet e interesit të projektit gjatë të gjithë planifikimit të aktiviteteve të tij të ndryshme dhe do të bëjë këtë edhe gjatë të gjithë fazës së zbatimit. Qëllimi i këtyre konsultimeve dhe i atyre të ardhshme përmbledhet më poshtë:

- Mbledhja e informacionit bazë mbi situatën aktuale social-ekonomike të familjeve të prekura nga projekti dhe të komuniteteve
- Mbledhja e informacionit për infrastrukturën dhe asetet e komunitetit, që përfshin
  - Aksesin: Urat, rrugët dhe aksesin në zona të ndryshme
  - Infrastrukturën sociale: duke përfshirë shkollat, spitalet etj.
  - Burimet fizike të pasurisë kulturore (BFPK): duke përfshirë vendet fetare/të kultit, lapidarët, varrezat, sajtet arkeologjike dhe të tjera.
  - Pronën e përbashkët: duke përfshirë zonat e mbledhjes së produkteve pyjore jo prej druri (PPJD) dhe produkteve pyjore prej druri, pyjet dhe përdorimin e burimeve të tjera natyrore.
- Informimi i grupeve të interesit për projektin, ndikimet e tij dhe masat për zbutjen e këtyre ndikimeve
- Ofrimi i mundësive për FPP-të dhe komunitetet që të përcjellin shqetësimet e tyre dhe të propozojnë alternativa
- Identifikimi i problemeve përkatëse për zhvillimin e rajonit që prekin grupe të ndryshme interesi
- Diskutimi i paketave të kompensimit dhe i kriterëve të përshtatshmërisë për kompensimet
- Rënia dakord për iniciativat e zhvillimit të komunitetit
- Mbështetja individuale me mjetet e jetesës dhe paketat për zhvillim
- Zhvillimi i mekanizmave për marrjen e komenteve për monitorimin dhe vlerësimin

DHP-ja është e angazhuar të krijojë një sistem për dialogun dhe për marrjen e reagimeve përmes konsultimeve me grupe të ndryshme të interesit të projektit. Përfshirja ekziston në nivele të ndryshme. Këtu përfshihen:

1. Autoritetet në nivel kombëtar në Tiranë, ku homologët kryesorë përfshijnë Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE), Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, etj.
2. Autoritetet në nivel komune në zonën e projektit
3. Familjet e prekura (FPP) dhe komunitetet që humbasin tokë ose që kërkojnë risistemim dhe familjet që do të marrin pjesë në rikuperimin e mjeteve të jetesës në luginën e Devollit
4. Organizatat joqeveritare (OJQ), donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat e tjera që nuk preken direkt nga projekti, por që mund të marrin pjesë në zhvillimin dhe të kontribuojnë në të mirë të luginës së Devollit.

Dëgjesat Publike rreth VNMS u mbajtën më 12 dhe 13 shtator 2011 në Pallatin e Kulturës "Thoma Priti" në Gramsh dhe më 15 shtator në Moglicë. Prezantimi i draft-raportit të VNMS-së për Projektin Hidroenergjetik të Devollit përfshinte tre projektet hidroenergjetike të planifikuara (HEC-et Banjë, Kokël dhe Moglicë) në lumin Devoll. Dëgjesat Publike në Gramsh u fokusuan në projektet e hidrocentralit të Banjës dhe Koklës, ndërsa Dëgjesa Publike në Moglicë u fokusua në HEC-in e Moglicës. Prezantimet fokusoheshin te VNMS-ja, ndikimet e mundshme dhe opsionet e rekomanduara për zbutjen e ndikimeve. Dëgjesat Publikekërkuan opinionet e grupeve të interesit dhe u dha përgjigje pyetjeve të tyre.

Opinionet dhe reagimet e grupeve të interesit janë përfshirë të detajuara në versionin final të raportit të VNMS-së.

#### **1.4.1 Konsultimet në nivel komune**

Disa prej programeve dhe planeve mjedisore dhe sociale që do të zbatohen kanë interesa të përbashkëta me bashkitë/komunat. Komunat janë përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e infrastrukturës që do të preket nga projekti.

Konsultimi dhe përfshirja janë shumë të rëndësishme me qëllim sigurimin e informacionit të mjaftueshëm dhe të pjesëmarrjes kur është e nevojshme. Probabiliteti për të pasur rezultate më të mira nga një program zhvillimi do të rritet nëse ka angazhim nga niveli lokal.

Qëllimi i këtyre konsultimeve dhe i atyre të ardhshme përmbledhet më poshtë:

- Mbledhja e informacionit bazë për të garantuar një zgjidhje optimale për zhvillimin.
- Njoftimi i përfundimit të periudhës së regjistrimit dhe inventarizimit të aseteve (data përfundimtare për mbledhjen e informacionit bazë)
- Informimi i komunave rreth projektit, ndikimit të tij dhe masave të propozuara për t'i zbutur ato.
- Ofrimi i mundësive për komunitetet që të përcjellin shqetësimet e tyre dhe të propozojnë alternativa.
- Identifikimi i programeve përkatëse mjedisore dhe të zhvillimit social që prekin grupe të ndryshme interesi.
- Diskutimi i programeve të zhvillimit dhe i kriterëve të përshtatshmërisë për kompensimet.
- Identifikimi i programeve alternative për zhvillimin në vende specifike dhe koha e këtyre programeve.
- Rënia dakord për iniciativat që do të zbatohen për zhvillimin e komunitetit.
- Rënia dakord për qëndrueshmërinë dhe strukturën e pronësisë, si dhe përgjegjësinë e shfrytëzimit.

Janë planifikuar një sërë konsultimesh për pjesën e mbetur të fazës së zbatimit të projektit dhe më pas formati i konsultimit do të përcaktohet më tepër nga zgjedhjet e zhvillimit të programit së bashku me FPP-të.

Konsultimet e ardhshme do të përfshijnë diskutime për aspektet e mëposhtme:

1. Trajtimi i ujërave të ndotura dhe të zeza për komunat përkatëse
2. Aktivitetet për shëndetësinë dhe arsimin
3. Identifikimi i vendeve të risistemimit për të prekurit nga HEC Moglicë
4. Planet për ndërgjegjësimin e komunitetit si, siguria rrugore, mjedisi, higjiena etj.
5. Mbledhja e mbeturinave dhe menaxhimi i landfilleve
6. Pyllëzimi dhe pastrimi i rezervuarit aty ku preket pylli i komunës
7. Zëvendësime të tjera të infrastrukturës që është përgjegjësi e qeverisë shqiptare

#### **1.4.2 Dialogu në nivel familjeje dhe fshati**

Pjesa më sfiduese dhe më e gjerë e procesit të konsultimit është me familjet dhe fshatrat që preken në luginën e Devollit. Kjo kërkon takime dhe diskutime të përsëritura me kryepleqtë e fshatrave dhe krerët e familjeve që preken, si dhe koordinim me drejtuesit e komunave për fshatrat në zonat e tyre.

Konsultimet në këtë nivel synojnë të krijojnë një "qark të mbyllur reagimesh" ose dialogu ndërmjet familjeve të prekura nga projekti (FPP) dhe DHP-së. Është thelbësore që FPP-të të projektojnë, të zbatojnë dhe të monitorojnë masat zbutëse të projektit me qëllim që ndërhyrjet të jenë të suksesshme, sidomos programet e zhvillimit dhe mbështetjes me mjete jetese (ZHMJ). Takimet e rregullta për planifikimin kanë filluar dhe do të vazhdojnë gjatë zbatimit duke bërë raportimin e rezultateve.

- Shpjegimet në lidhje me ndikimet e mundshme dhe masat zbutëse si pjesë e vlerësimit të ndikimit social të kryer nga konsulentët në 2010-2011
- Takimet zyrtare për publikimin e studimeve të VNM-së dhe VNS-së në shtator 2011
- Pjesëmarrja në sondazhe shtesë për mjetet e jetesës dhe përdorimin e tokës të kryer nga konsulentët dhe stafi i projektit DHP në vitin 2012
- Diskutime dhe takime të vazhdueshme informale me stafin e projektit, qeverinë dhe palë të tjera të interesuara në lidhje me një sërë çështjesh
- Aksesit në Qendrën e Informimit të Publikut të DHP-së në Gramsh që prej mesit të vitit 2010

Janë planifikuar një sërë konsultimesh për pjesën e mbetur të fazës së zbatimit të projektit dhe më pas formati i konsultimit do të përcaktohet më tepër nga zgjedhjet e zhvillimit të mjeteve të jetesës dhe në mënyrën sesi grupet do të monitorojnë punën e tyre dhe si do t'i raportojnë DHP-së.

Konsultimet në të ardhmen me qëllim finalizimin e mjeteve të jetesës përbëhen nga tre faza:

1. Shpërndarja e skemës së përfitimeve dhe prezantimi i ndikimeve për një diskutim të detajuar të opsioneve në lidhje me të drejtat dhe procedurat, si dhe përgjigjet për shqetësimet e ngritura në diskutimet e mëparshme
2. Diskutimet e detajuara me krerët e familjeve që preken dhe me kryepleqtë e fshatrave për alternativat e zbutjes së ndikimeve në fshat, si dhe për opsionet e risistemimit dhe të mjeteve të jetesës
3. Marrëveshjet për kontributet e DHP-së për zbutjen, identifikimin e kushteve dhe vendeve të risistemimit dhe marrëveshja për opsionet e mjeteve të jetesës për familjet.

#### **1.4.3 Qasja ndaj grupeve vulnerabël**

Grupe vulnerabël përkufizohen personat që për shkak të gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar mendore ose fizike, disavantazhit ekonomik ose gjendjes civile mund të ndikohen më shumë negativisht nga risistemimi sesa të tjerët dhe që mund të jenë të kufizuar në aftësinë e tyre për të pretenduar ose për të përfituar nga ndihma për risistemim dhe përfitimet e lidhura me zhvillimin. Aty ku individët ose grupet janë identifikuar si të disavantazhuar ose vulnerabël, projekti do të përdorë përpjekjet e tij më të mira për të propozuar dhe zbatuar masa specifike (sipas nevojës) për të minimizuar dhe zbutur ndikimet negative sociale dhe ekonomike. Disa karakteristika të grupeve vulnerabël përfshijnë:

1. Mungesën e punës për të rriturit për t'u përfshirë në bujqësi ose aktivitete të tjera që gjenerojnë të ardhura: d.m.th. familje me kryefamiljar të moshuar, gra të veja ose gra (e reja) me fëmijë të vegjël për t'u kujdesur.
2. Aftësitë e kufizuara ose sëmundjet ndërmjet anëtarëve të familjes që e bëjnë të vështirë kryerjen e aktiviteteve për sigurimin e mjeteve të jetesës prej tyre, qoftë për shkak të aftësisë së kufizuar ose sëmundjes, qoftë për shkak se kujdesen për të tjerë.
3. Familjet që kanë mbetur pa tokë për shkak të ndikimeve nga projekti dhe që nuk kanë asnjë mjet tjetër jetese.

Identifikimi i FPP-ve vulnerabël do të bëhet nëpërmjet metodave të ndryshme dhe përpara çdo veprimi duhet rënë dakord për kriteret. Këto janë:

1. Përzgjedhja e mbështetur në kriteret e vendosura. Mund të vendosen kriteret objektive dhe të verifikueshme për përfitimin e mbështetjes, si p.sh. moshë e kryefamiljarit mbi 60 vjeç, aftësia e kufizuar etj.
2. Përzgjedhja nga komunitetet. Në disa kontekste është parë se komunitetet mund të bëjnë një punë shumë të mirë me identifikimin e personave vulnerabël. Ata shpesh kanë pasur informacione më të mira për familjet se çdokush tjetër dhe ndoshta janë vërtet të interesuar në mirëqenien e komunitetit të tyre. Përfshirja e komunitetit gjithashtu mund të krijojë angazhim dhe një ndjenjë përgjegjësie, dhe të parandalojë dëmtimin e strukturave tradicionale.

Ekziston mundësia që ky grup i vogël familjesh mund të mos i përmbushë i vetëm objektivat e mjeteve të jetesës për arsye që shkojnë përtej kontrollit të projektit. Do të bëhen përpjekje të veçanta për t'u konsultuar me këto familje dhe për t'i përshtatur opsionet e zhvillimit të mjeteve të jetesës me nevojat dhe kërkesat e tyre sipas skemës së përfitimeve. Këto përpjekje kanë gjasa të konsistojnë kryesisht në zhvillimin e një rrjeti lokal të sigurisë sociale nëpërmjet ofrimit të zgjidhjeve të përbashkëta me organizatat lokale, fqinjët dhe/ose të afërmit që mund të marrin përsipër disa prej përgjegjësiave afatgjata të përkujdesjes për këto familje vulnerabël ose hartimin e opsioneve të kompensimit që kërkojnë pak ose aspak punë. Këto marrëveshje informale/personale kanë ekzistuar tradicionalisht si burimi kryesor i zbutjes së vulnerabilitetit në mungesë të mbështetjes publike dhe është e rëndësishme që prezantimi i marrëveshjeve të veçanta të mos ketë asnjë ndikim negativ në organizimet tradicionale.

### 1.5 Kuadri organizativ

Organizimi i përgjithshëm i shoqërisë DHP dhe përmbledhja e përgjegjësiave kryesore për secilin pozicion në organizimin për temat e trajtuara në këtë dokument. Këtu përfshihet shpërndarja e autoritetit dhe të drejtat e nënshkrimit, të cilat janë në përputhje me dokumentet dhe politikat drejtuese të DHP-së.




Figura 4: Struktura organizative që tregon stafin e menaxhimit mjedisor dhe social

Njësitë e ndryshme kanë përgjegjësitë e mëposhtme:

- Menaxhimi mjedisor dhe social (MMS) kryen planifikimin strategjik të të gjitha planeve dhe programeve të MMS-së. MMS-ja është përgjegjëse për të gjitha aspektet e parashtruara në PMMS, por gjatë ciklit të projektit, detyrat që përfshijnë kompetenca ku DHP ka njësi të tjera të krijuara, (si infrastruktura, projektimi, tenderimi, ndërtimi dhe mbikëqyrja) duhet të menaxhohen nga departamenti përkatës i DHP-së. Ajo identifikon aktivitetet, parashtron objektivat e qarta

brenda programeve dhe monitoron ecurinë dhe arritjen e objektivave sipas axhendave të programit për aktivitetet e ndërtimit dhe garanton bashkërendimin e ndërlidhjeve.

- Ndërlidhësi me komunitetin (NK) do të komunikojë me familjet e prekura nga projekti, fshatrat, komunitetet dhe qeverinë (me këtë të fundit kur të jetë e nevojshme dhe pasi të bihet dakord me drejtorinë e përgjithshme). Ndërlidhësi me komunitetin do të jetë një lojtar kyç në të gjitha konsultimet për MMS-të dhe pika e kontaktit për mekanizmin e shqyrtimit të ankesave. Ndërlidhësi me komunitetin do të përmirësojë gjithashtu njohuritë e komunitetit/fshatit rreth DHP/MMS dhe për proceset/aktivitetet në vazhdim.
- Risistemimi do të ketë përgjegjësinë e planifikimit dhe atë operative në zhvillimin, zbatimin dhe menaxhimin e programeve të zhvillimit dhe mbështetjes me mjetet e jetesës, zgjidhjeve të kompensimit, konsultimeve dhe negociatave, si dhe të risistemimit fizik të familjeve dhe të vendndodhjeve të bizneseve private të prekura. Risistemimi gjithashtu do të jetë përgjegjës për të gjithë monitorimin dhe të gjitha aktivitetet e lidhura me rikuperimin e mjeteve të jetesës.
- Zhvillimi social do të ketë përgjegjësinë operative për zhvillimin, menaxhimin, zbatimin (sipas rastit) dhe monitorimin e planit të zhvillimit të infrastrukturës së MMS-së (në bashkëpunim me qeverinë shqiptare), programin rajonal të shëndetit, arsimin rajonal dhe menaxhimin social (duke përfshirë programet e sigurisë së komunitetit).
- Menaxhimi mjedisor do të ketë përgjegjësinë operacionale të zhvillojë, zbatojë, menaxhojë dhe monitorojë planet dhe programet e përcaktuara sipas programit të menaxhimit mjedisor.

Planet dhe programet janë:

- Plani i menaxhimit të mbetjeve
- Plani i menaxhimit të ujërave zeza dhe ujërave të përdorura
- Pastrimi i rezervuarit
- Plani i pyllëzimit
- Programi i monitorimit të hidrologjisë, sedimentologjisë, meteorologjisë dhe cilësisë së ujit
- Përdorimi i WEB-GIS
- Plani i zhvillimit të vaditjes (në rrjedhën e poshtme)
- Programi për rrjedhën e poshtme

Përgjegjësia përfshin gjithashtu monitorimin e aktiviteteve për të treguar se masat zbutëse të vendosura kanë rezultatet e dëshirueshme.

### **1.6 Treguesit e qëndrueshmërisë dhe rezultatet e monitorimit**

Në përputhje me standardet e IFC-së për qëndrueshmërinë, është e nevojshme që DHP-ja të ketë mundësinë të tregojë se masat e ndryshme zbutëse të përcaktuara kanë një rezultat të dëshirueshëm për sa i përket rikuperimit dhe përmirësimit të preferuar të kushteve dhe standardeve të jetesës së FPP-ve. Janë mbledhur një sërë rezultatesh të dëshiruara, bazuar në informacionin e mbledhur nga sondazhet, konsultimet dhe ndërhyrjet të planifikuara në kolonën e majtë të tabelës së mëposhtme. Në kolonën e djathtë renditet mënyra sesi do të matet performanca. Disa prej këtyre treguesve lidhen me përfitimet e matshme të FPP-ve, si p.sh. objektivat e të ardhurave, ndërkohë që të tjerat lidhen me angazhimet për të realizuar programet, si ofrimi i trajnimit dhe i pajisjeve për shkollat.

Pasi të jenë identifikuar treguesit, të dhënat bazë të situatës aktuale duhet të konfirmohen si pikënisje për monitorimin afatgjatë dhe si një mënyrë për të matur përmirësimet ose rikuperimet me kalimin e kohës.

Rezultatet e dëshirueshme të DHP-së	Treguesit e rezultateve të përdorura për të matur performancën	Baza	Objektivi
<b>FPP-të kanë përmirësuar standardin e jetesës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Informacionet për të ardhurat e familjeve nga aktivitetet e biznesit dhe bujqësore vetëm në luginën e Devollit</li> </ul>	Të ardhurat mesatare nga bujqësia 226 003 Lekë	Të paktën 10% përmirësim në vlerën mesatare bazë, plus inflacionin vjetor ose proporcioni relativ për rritje në prodhimin total
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Burime të tjera të ardhurash që mund të ndikojnë nivelin e përfshirjes në aktivitetet në luginën e Devollit, por që lejojnë ruajtjen ose përmirësimin e standardeve të jetesës.</li> </ul>	Të ardhurat familjare mesatare nga aktivitetet e tjera dhe burimet natyrore (përveç dërgesave nga emigrantët) 260 315 Lekë	5% rritje
<b>FPP-të kanë përmirësuar aksesin në tregje dhe shërbime</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i fshatrave me akses në rrugët e fshatit në të gjitha kushtet e motit ose kushte të përmirësuara të rrugëve</li> </ul>	27 fshatra	30% me akses të përmirësuar në rrugë
<b>FPP-të kanë kushte shëndetësore të përmirësuara</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Akresi në kujdesin shëndetësor (godina shëndetësore funksionale ose vizitat e rregullta nga mjekët specialistë)</li> </ul>	14 qendra shëndetësore / 1 spital	Rritja e aksesit në qendrën shëndetësore të fshatit ose në spitalin e Gramshit për 80% të fshatrave të projektit.
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetja për pjesëmarrje në programet e trajnimit për personelin e qendrave shëndetësore dhe ndjekja e këtyre programeve</li> </ul>	14 qendra shëndetësore	20 pjesëmarrës
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përmirësimi i godinave shëndetësore me pajisjet e kërkuara</li> </ul>	14 qendra shëndetësore	Ofrimi i pajisjeve bazë për secilën nga qendrat shëndetësore.
<b>FPP-të kanë akses më të mirë tek uji</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i familjeve që kanë furnizim me ujë për përdorim shtëpiak direkt në shtëpitë e tyre.</li> </ul>	Nuk disponohet	Ndërtimi 100% i shtëpive të risistemimit / zhvendosjes.
<b>FPP-të kanë higjienë të përmirësuar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i familjeve me tualet funksional brenda në shtëpi</li> </ul>	Nuk disponohet	Ndërtimi 100% i shtëpive të risistemimit / zhvendosjes.
<b>FPP-të kanë arsim të përmirësuar</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i fëmijëve që ndjekin shkollën nëntëvjeçare në zonën e projektit.</li> </ul>	Nuk disponohet	Monitorimi i tendencave të niveleve të regjistrimit/ ndjekjes së shkollës
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i programeve të trajnimit për mësuesit dhe ndjekja e këtyre programeve</li> </ul>	Nuk disponohet	20 pjesëmarrës
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njësitë e pajisjeve që i janë ofruar shkollave 9-vjeçare dhe fillore</li> </ul>	Nuk disponohet	100% e shkollave në zonën e projektit kanë



Rezultatet e dëshirueshme të DHP-së	Treguesit e rezultateve të përdorura për të matur performancën	Baza	Objektivi
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i studentëve/ nxënësve të prekur nga projekti që përfitojnë nga programet e mbështetjes së arsimit (përfshirë trajnimin)</li> </ul>	Nuk disponohet	<p>marrë paketë pajisjesh sipas vendimit nga DHP</p> <p>30 (nga 2013 -2019)</p>
<b>Punësimi gjatë periudhës së zbatimit të projektit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i vendasve të punësuar nga DHP, kontraktorët dhe palët e tjera gjatë ndërtimit</li> </ul>	0	DHP nuk është përgjegjëse për punësimin direkt nga ndërtimi i HEC-eve të ndryshme, por ky punësim, nëse ka, do të matet për të ndihmuar në vlerësimin e kontributit të përgjithshëm të projektit në ekonominë lokale.
<b>Intensifikimi dhe përmirësimi i mjeteve të jetesës për FPP-të</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i hektarëve të rinj që përdoren për prodhim nga FPP-të (zonat me vaditje dhe pa vaditje)</li> </ul>	0	30 hektarë
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i serave të ndërtuara</li> </ul>	8	24 sera ose struktura të tjera bujqësore për intensifikimin e prodhimit të ofruara nga zhvillimi dhe mbështetja me mjetet e jetesës
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i aktiviteteve të mbështetura të biznesit të vogël (në natyrë)</li> </ul>	Nuk disponohet	20 biznese të filluara/ ndihmuara gjatë një periudhe 5 vjeçare.
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sasia e të ardhurave/konsumit si rezultat i iniciativave për mjetet e jetesës (bujqësore) të mbështetura nga DHP.</li> </ul>	Të ardhurat mesatare nga bujqësia 226 003 Lekë	10% rritje
<b>Kushte mjedisore të përmirësuara në luginën e Devollit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i familjeve që përdorin landfillin e përcaktuar të zonës</li> </ul>	0	10 fshatra
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i familjeve të lidhura me rrjetin e ujërave të zeza</li> </ul>	50% e të gjitha familjeve	70% e të gjitha familjeve
	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri dhe lloji i pemëve të mbjella brenda zonës së kërkuar të pyllëzimit (1421 ha).</li> </ul>	Nuk disponohet	Për t'u përcaktuar sipas kërkesave të qeverisë shqiptare

Tabela 1: Rezultatet, treguesit e performancës dhe objektivat

Të ardhurat janë një aspekt më kompleks për t'u matur duke qenë se janë disa faktorë për t'u marrë në konsideratë, si edhe vullneti i FPP-ve për të deklaruar realitetet e tyre. Për qëllime monitorimi nga DHP-ja, objektivi është vendosur në 10% mbi nivelet ekzistuese të të ardhurave si total, plus pagesën për

normën vjetore të inflacionit. Duke qenë se humbja e tokës mund të çojë në humbjen e përhershme të të ardhurave dhe produkteve bujqësore, duhet të monitorohen të ardhurat totale. Kjo konsiston në të ardhurat nga prodhimet e kulturave bujqësore, blegtoria, bizneset e vogla, pagat dhe remitancat. Ka të ngjarë që këto komponentë të ndryshëm të ndryshojnë gjatë ndërtimit dhe gjatë shfrytëzimit për shkak të mundësive për biznes dhe punësim dhe aksesit të përmirësuar në treg.

Objektivat e tjera infrastrukturore përfshijnë aksesin e përmirësuar në shëndetësi, rrugë dhe në tokat e reja që japin prodhim, ujitje, furnizim me ujë dhe tualete të brendshme. Ndjekja e përmirësuar e shkollës për shkollat nëntëvjeçare gjithashtu do të tregonte një situatë të përmirësuar arsimimi për luginën. Objektivat e tjera ofrojnë trajnim dhe aktivitete të tjera për FPP-të dhe nuk kanë referencë bazë, por mund të maten vetëm kundrejt një objekti.

### 1.6.1 Programi i monitorimit për DHP-në

Sondazhi për përdorimin e tokës dhe mjetet e jetesës që u zhvillua ndërmjet vitit 2011 dhe 2012 ofroi një bazë të detajuar për monitorim (sidomos për Banjën). Rekomandohet që monitorimi duhet të ndërmerret çdo dy vjet për katër aktivitete rresht të mbledhjes së të dhënave, d.m.th. në vitin 2014, 2016, 2018 dhe 2020. Kjo do të përfshijë përdorimin e të njëjtit pyetësor ose të një pyetësori paksa të modifikuar për të kapur të gjitha të dhënat e kërkuara mbështetur në situatën që mbizotëron gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave.

Synimet e monitorimit social-ekonomik dhe programit të vlerësimit përfshijnë:

1. Në periudhën afatshkurtër deri në afatmesme, analiza do të fokusohet në burimet kryesore të të ardhurave dhe mjetet e jetesës së familjeve të risistemuara sipas projektit dhe në ndryshimet në të ardhurat/konsumin/profilet e prodhimit të FPP-ve. Në të njëjtën kohë, qëllimi është të identifikohen problemet që lindin në komunitetet e FPP-ve që mund të ndikojnë në kushtet e tyre social-ekonomike në periudha afatgjata.

Parashikohet që puna monitoruese të identifikojë ndryshimet në kushtet sociale dhe ekonomike të FPP-ve, bazuar në tregues të tillë, si niveli i të ardhurave, burimi i të ardhurave, sigurimi i ushqimit, shëndeti parësor dhe kushtet e arsimit, dhe statusi i individëve vulnerabël. Kjo gjithashtu do të ndihmojë në përcaktimin e tendencave. Kjo analizë do të përdoret për të dhënë informacion dhe për të mbështetur projektimin dhe/ose forcimin e mjeteve të jetesës dhe ndërhyrjet në zhvillimin rajonal për të ndihmuar në përmirësimin e mundësive për të ardhura të familjeve të risistemuara dhe të prekura nga projekti.

2. Në periudhën afatgjatë, analiza do të fokusohet në analizimin/krahasimin e grupit të indikatorëve dhe rezultateve të dëshirueshme të identifikuara më lart, për të përcaktuar nëse projekti i ka përmbushur në realitet objektivat e tij të paracaktuara.

Për momentin, mbledhja e të dhënave parashikohet t'i jepet me nënkontraktim një organizate profesionale për kryerjen e sondazheve, e cila do të jetë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave dhe hedhjen e të dhënave, ku personeli i risistemimit i DHP-së do të jetë përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe monitorimin e aktiviteteve të sondazhit. Kjo do t'i jepte një formë legjitimiteti të dhënave të mbledhura.

Për sa i përket madhësisë së kampionit, rekomandohet që të merren në konsideratë rreth 30% të familjeve (FPP) të prekura nga rezervuari dhe tokat për ndërtimin e projektit (të zbutura nëpërmjet risistemimit dhe/ose zhvillimit dhe mbështetjes me mjete jetese). Përzgjedhja do të bazohet në ato

me ndikimet më të mëdha për çdo fshat duke garantuar përfshirjen atyre që preken ndjeshm. Mbështetur në informacionin e disponueshëm deri më sot, kjo shkon deri në rreth 210 familje, por ky numër mund të ndryshojë në varësi të programit përfundimtar të monitorimit që do të zhvillohet. Në parim, të larguarit (FPP-të që zgjedhin të largohen nga zona e projektit) nuk do të monitorohen.

Në sondazh mund të përfshihen një sërë individësh si kampion kontrolli për të verifikuar tendencat, si dhe tregues të tjerë mjedisorë dhe zhvillimorë të rajonit. Rekomandohet që ky kampion kontrolli të jetë i përbërë nga (1) lugina e Devollit (2) ata që nuk preken direkt nga projekti. Numri për fshat do të jetë në proporcion direkt me numrin e FPP-ve në atë fshat. Kjo është e rëndësishme duke qenë se do të jetë e nevojshme të identifikohen zhvillimet dhe ndryshimet që shkojnë përtej objektit të projektit. Për shembull, nëse remitancat bien me 50% për shkak të mungesës së punës në Itali ose Greqi, atëherë objektivat e të ardhurave mund të kenë nevojë të rregullohen për të marrë parasysh këtë gjë ose programet e mjeteve të jetesës duhet të rregullohen për t'i ndihmuar fshatarët të përshtaten me këtë sfidë të re ekonomike.

### 1.7 Grupet e interesit të projektit dhe përfituesit prej tij

Programet e ndryshme varen nga bashkëpunimi dhe kanë ndërveprime të ndryshme me një sërë grupesh interesi. Këto marrëdhënie janë të renditura më poshtë.

	Programet										
	Përvetësimi i tokës (Tokat private)	Zhvillimi i Infrastrukturrës Shëndetësi Rajonal	Arsimi Rajonal	Programi i Menaxhimit Social	Burimet Kulturore Fizike	Hidrologjia, Cilësia e Ujit, Monitorimi	Ujrat dhe kanalizimet	Zhvillim i Vadtjes	Menaxhimi i Mbetjeve	Pastrimi i Biomassës dhe Heqja e mbetjeve	Ripyllëzimi
Agjencia Rajonale e Mjedisit						X					
Bashkia Gramsh				X							
Bordi Rajonal i Drenazhimit							X				
CEZ Shpërndarje		X									
Departamenti i Pyjeve										X	X
DHP (Operim & Mirëmbajtje)						X					
Drejtoria Arsimore Rajonale			X	X							
Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve		X									
Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës - Kanalizime		X									
Drejtoria e Shëndetit Publik			X								
Drejtoria e Shërbimit Spitalor			X								
Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore					X						
Drejtoria Rajonale e Bujqësisë							X				
Drejtoria Rajonale e Rrugëve		X									
Drejtoria Rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve		X									
Institucione të tjera shqiptare / ndërkombëtare						X	X	X			
Instituti i Monumenteve te Kulturës					X						
Komiteti Kombëtar I Digave të Mëdha						X					
Komunitetet jo të prekura							X		X	X	
Kontraktorët e DHP-së				X							
Kryqi i Kuq			X								
Ministria e Arsimit dhe Shkencës			X			X					
Ministria e Brendshme	X					X					
Ministria e Bujqësisë						X	X				
Ministria e Drejtësisë	X										
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE)	X	X									
Ministria e Mjedisit	X					X	X	X	X	X	X
Ministria e Punëve Publike dhe Transportit		X					X	X	X		
Ministria e Shëndetësisë			X	X			X	X			
Ministria e Turizmit		X				X					
Ndërmarrja e Rrugëve Rurale		X									
Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST)		X									
Organizatat Jo Qeveritare				X		X	X				
Policia				X							
PPP / FPP	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X
Shtabi i Emergjencave Civile Gramsh			X								
Universiteti Politeknik, Instituti i Gjeo-Shkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit						X					
Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme (ZRPP)	X										
Zyrat Rajonale te Kadastrës	X										
Zyrat Rajonale të Punës				X							
Zyrat Rajonale te Pyjeve											

Tabela 2: Ndërlidhjet e grupeve të interesit dhe përfituesve të projektit me programet përkatëse MMS

## 2. KUADRI LIGJOR

### 2.1 Hyrje

DHP-ja është përpjekur që në zbatimin e aktiviteteve të saj të përfshijë jo vetëm standardet shqiptare, por edhe standardet më të rëndësishme ndërkombëtare. Në këtë seksion përshkruhen me hollësi rregulloret e zbatueshme të qeverisë shqiptare, të cilat mbulojnë aktivitetet e DHP-së për ndërtimin dhe shfrytëzimin e të 3 hidrocentraleve.

Ndryshimi nga ish-regjimi komunist solli, ndër të tjera, ndryshime në kërkesat procedurale dhe dokumentacion për pronësinë e tokës, si edhe për rregullore të tjera të zbatuara dhe të nevojshme për ndërtimin e një hidrocentrali në Shqipëri. Për sa me siper, nevojitet të sigurohen të drejta për aksesin në tokë bazuar në ligjet e mëposhtme që janë aktualisht në fuqi:

- Pronat private - Ligji nr. 8651, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar.
- Pronat e shtetit – Ligji për pronat e paluajtshme të shtetit (Nr. 8743, i vitit 2001) (i ndryshuar)
- Ligji për tokën (Nr. 7501, datë 17.07.1991, i ndryshuar me ligjin nr.7715, date 2.6.1993, ligji nr.7855, datë 29.7.1994; ligji nr.8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", ligji nr.9244, datë 17.6.2004 ka rregulluar shpërndarjen e tokës në pronësi të shtetit punonjësve të fermave shtetërore dhe pjesëtarëve të kooperativave bujqësore shtetërore.
- Ligji për privatizimin e banesave shtetërore (nr. 7652) u ka dhënë familjeve në qytete pronësi mbi apartamentet dhe shtëpitë private ku ato banonin.
- Ligji i vitit 1993 për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve (nr. 7698), (i rishikuar në vitin 2004, me nr. 9235), u jep të drejtën pronarëve të tokave të shpronësuar përpara vitit 1945 që të kërkojnë kthimin e tokës jo bujqësore dhe bujqësore deri në 100 hektarë.

### 2.2 Shfrytëzimi dhe pronësia e tokës

Ekzistojnë një sërë ligjesh dhe dekretesh për shfrytëzimin e tokës, të drejtat e pronësisë dhe shpronësimin në Shqipëri. Këto tregohen në tabelën e mëposhtme dhe shpjegohen me hollësi në seksionet vijuese.

Legjislacioni	Përshkrimi
Ligji nr. 8651, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar	Ky ligj rregullon të drejtat e tokës pronë private për interes publik
Ligji për administrimin e pronave të paluajtshme të shtetit (Nr. 8743, i vitit 2001, i ndryshuar)	Ky ligj rregullon administrimin dhe menaxhimin e pronave të shtetit në Shqipëri
Ligji për tokën (nr. 7501, datë 17.07.1991), i ndryshuar	Ky ligj rregullon çështjen e tokës bujqësore në Shqipëri;
Ligji për privatizimin e banesave shtetërore (nr. 7652), i ndryshuar.	Ky ligj rregullon çështjet e banesave/strukturës
Ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve (nr. 7698), (i rishikuar në vitin 2004, me nr. 9235), i ndryshuar.	Ky ligj rregullon kthimin e pronave ish-pronarëve të përpara sistemit komunist, qofshin këto tokë bujqësore, pyje, kullota, tokë ndërtimi apo çdo lloj pasurie tjetër.
Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar	Ky ligj rregullon heqjen e sipërfaqeve pyjore nga inventari i tyre si pasoje e zbatimit të projektit

Legjislacioni	Përshkrimi
Ligji nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar	Ky ligj rregullon heqjen e sipërfaqeve të kullotave ga inventari i tyre si pasoje e zbatimit te projektit
Ligji nr. 9244, datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar	Ky ligj rregullon rregulloret për tokën bujqësore.
Kodi Civil shqiptar	Ky kod rregullon çështjet e titujve të pronësisë për pronarët e strukturave dhe tokës

### 2.3 Pronat private - ligji shqiptar për shpronësimet

Legjislacioni që rregullon procesin e shpronësimit për pronat private përshkruhet më poshtë:

- Ligji nr. 8651, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar dhe;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 126, datë 23.3.2000 "Për përbërjen dhe procedurat e komisionit të posaçëm për shpronësimet" dhe
- VKM nr. 127, datë 23.3.2000 "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe;
- VKM nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik (i ndryshuar)" dhe
- Udhëzimi nr. 1, datë 5.10.2000 "Kriteret teknike të përlogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes".

Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" parashikon të drejtën e shtetit për të shpronësuar ose për të përvetësuar pronën private për marrje në përdorim të përkohshëm për qëllime të "interesit publik", të cilat nuk mund të realizohen ose të mbrohen në mënyra të tjera. Shteti duhet të kompensojë në vlerë tokën e shpronësuar dhe çdo zvogëlim të vlerës së pronës shkaktuar pronave pranë pronës së shpronësuar<sup>2</sup>.

Sipas ligjit për shpronësimin, vlera e shpronësimit (kompensimi) llogaritet nga një komision i posaçëm bazuar në vlerësimin e pronave që shpronësohen (duke marrë në konsideratë vlerën e tyre fillestare, zhvlerësimin, destinacionin, vendndodhjen, treguesit e ndryshimeve të çmimit të tregut dhe valutën). Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.03.2000 shpjegon metodologjinë e vlerësimit të tokës që është objekt i shpronësimit dhe procedurat përcaktohen (në Lekë/m<sup>2</sup>) nga vendimet e Këshillit të Ministrave, të cilat aprovojnë çmimin referencë sipas ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave".

Në rastet ku për zona të caktuara nuk është vendosur një çmim, sipas vendimit nr. 138, vlera e tokës llogaritet bazuar në vlerën mesatare të çmimit të shitjes së tokës në zonën përkatëse (brenda 3 muajve të fundit), siç tregohet në regjistrin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kjo zyrë duhet të lëshojë një deklaratë të posaçme të nënshkruar nga drejtori lokal i ZRPP-së në lidhje me kontratat më të fundit të shitjeve të dorëzuara dhe çmimet e përdorura.

<sup>2</sup> Ligji për shpronësimin mbështetet nga katër vendimet e mëposhtme në lidhje me vënien në zbatim të shpronësimit: Vendimi 126, datë 23.03.2000, Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet; Vendimi 127, datë 23.03.2000, Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik; Vendimi 138, datë 23.03.2000, Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik; Vendimi 147, datë 23.03.2000, Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet.

Për sa i përket zonave që nuk kanë mbajtur një indeks të tregtisë/blerjeve, llogaritja e vlerës bëhet në bazë të një krahasimi direkt të çmimeve mesatare të shitjes së tokës në zona të tjera.

Për llogaritja e vlerës bazohet në llojin e tokës që do të shpronësohet (tokë bujqësore, pyll, livadh etj.); karakteristika për përllogaritjen ndryshojnë (d.m.th. në rastin e tokës bujqësore: kategoria e tokës; largësia nga zona urbane; gjendja nën apo mbi nivelin e ujit etj.).

Sipas ligjit për shpronësimin (nenet 27 dhe 28), shpronësimi për marrje në përdorim të përkohshëm mund të ndodhë për një periudhë jo më shumë se dy vjet nga data e marrjes së tokës në përdorim të përkohshëm (neni 33 i ligjit për shpronësimin). Pronarët e pronave të marra në përdorim të përkohshëm kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e tyre në gjendjen e mëparshme ose kundër-vleftën për dëmet që i janë shkaktuar pronës.

Shteti duhet të kompensojë edhe për zhvlerësimin e pronës pranë pronës që do të shpronësohet. Pasuria e paluajtshme mund të merret vetëm për: (i) përmbushjen e detyrimeve të shtetit, të cilat lindin nga traktatet dhe konventat shumëpalëshe ndërkombëtare; (ii) zhvillimin e programeve, projekteve dhe investimeve në territoret shqiptare dhe jashtë saj, të parashikuar në marrëveshjet ndërkombëtare që zbatohen nga Shqipëria; (iii) zhvillimin e projekteve të transportit, energjetikës, telekomunikacioneve, veprave ujore dhe infrastrukturës së kanalizimeve; (iv) zbatimin e projekteve dhe investimeve me qëllim mbrojtjen e mjedisit, shëndetit, kulturës dhe edukimin e publikut; (v) zbatimin e programeve dhe investimeve të fokusuar në mbrojtjen kombëtare. (vi) mbrojtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore, përfshirë ndërtesat dhe vendet historike, monumentet, objektet e lashta etj., të cilat konsiderohen me vlerë për t'u ruajtur për të ardhmen. Këtu përfshihen objekte të rëndësishme për arkeologjinë, arkitekturën, shkencën ose teknologjinë e një kulture të caktuar.

Shpronësimi mund të bëhet në favor të personave juridikë publikë ose privatë. Nëse janë persona juridikë privatë ata mund të përfitojnë vetëm për qëllime të zhvillimit të projekteve të transportit, telekomunikacioneve, veprave ujore dhe infrastrukturës së kanalizimeve ose projekteve dhe investimeve që kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit, shëndetit, kulturës dhe edukimin e publikut.

Kodi Civil parashikon detyrimin për të shpërblyer dëmin pasuror, i cili përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar (neni 640).

## **2.4 Toka shtetërore (publike)**

### **2.4.1 Gjendja aktuale**

Më shumë se 80% e tokës së nevojshme për zbatimin e projektit të DHP-së kategorizohet si tokë publike. Kjo tokë ndahet më tej në kategoritë e mëposhtme:

1. Pyll (administruar nga Ministria e Mjedisit ose autoritetet vendore)
2. Kullotë (administruar nga Ministria e Mjedisit ose autoritetet vendore)
3. Rrugë ose infrastrukturë tjetër (administruar nga Ministria e Transportit ose autoritetet lokale)
4. Skemat për administrimin e ujërave (administruar nga METE ose autoritetet lokale)
5. Bujqësore (administruar nga Ministria e Bujqësisë)
6. Sheshe arkeologjike (administruar nga Ministria e Turizmit)
7. Vende të tjera (drejtues të ndryshëm të qeverisë shqiptare)

Për të gjithë tokën e administruar nga autoritetet vendore ose qendrore DHP-ja është në proces identifikimi, përmes një inventari të plotë të zonave të prekura dhe të përcaktuar brenda një procesi të drejtuar nga grupi institucional i punës (GIP), rezultati përfundimtar i të cilit është kryerja e procesit të mëposhtëm:

1. Heqja e tokës së nevojshme nga inventarët përkatës sipas parashikimeve përkatëse të MK.
2. Miratimi nga ana e qeverisë shqiptare përmes një Vendimi të Këshillit të Ministrave (VKM) për secilën prej sipërfaqeve të tokës që do të administrohen nga METE
3. Miratimi i zonave pyjore nga Këshilli i Ministrave dhe nga Kuvendi
4. Regjistrimi i të gjithë tokës në emër të METE-s
5. Nënshkrimi i marrëveshjeve të uzufuktit me METE-n për secilën nga zonat e lartpërmendura
6. Regjistrimi i marrëveshjeve të uzufuktit në ZRPP me shënimin se kjo tokë është e bllokuar dhe e rezervuar për DHP-në për 35 vjet, sipas marrëveshjes së uzufuktit
7. Dhënia e informacionit dhe aksesit në tokën e nevojshme për risistemim, zhvillim rajonal dhe proceset mjedisore sipas kërkesës dhe dhënia e ndihmës në përpunimin e licencave dhe lejeve të ndryshme ose gjatë ndërtimit të strukturave të ndryshme.

#### 2.4.2 Kuadri ligjor për risistemimin

Legjislacioni shqiptar nuk parashikon përcaktime të qarta dhe shtjellime të mëtejshme në lidhje me ndihmën për risistemim ndaj pronarëve të ligjshëm që janë zhvendosur për shkak të projektit.

Termi risistemim përmendet vetëm në nenin 3.4.6 (d) të marrëveshjes së koncesionit, i cili parashikon që: Autoriteti Kontraktues është përgjegjësi i vetëm për risistemimin e personave dhe zhvendosjen e pasurisë nga çdo tokë e shpronësuar, në përputhje me Seksionin 3.4.6.

Procesi i shpronësimit në Shqipëri rregullohet nga Kodi ynë Civil dhe ligji për shpronësimin (duke përfshirë edhe legjislacionin e zbatueshëm dytësor)<sup>3</sup>.

Sipas ligjit për shpronësimin (neni 27 dhe 28) shpronësimi për marrjen në përdorim të përkohshëm të tokës bëhet për nevoja të punimeve në funksion të interesit publik. Marrja në përdorim të përkohshëm të tokës bëhet në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin për shpronësimin dhe kundrejt kompensimit. Marrja në përdorim të përkohshëm të tokës bëhet për sa kohë sa vazhdon shkak i ligjshëm, por në çdo rast jo më shumë se 2 (dy) vjet nga data e marrjes së tokës për përdorim të përkohshëm (neni 33 i ligjit për shpronësimin). Marrja e tokës në dorëzim dhe kthimi i pasurisë bëhet me akt të veçantë, ku pasqyrohet si më poshtë: baza ligjore, karakteristikat e objektit dhe gjendja faktike e tij, dhe ky dokument nënshkruhet nga pronari. Në mungesë të pronari, këto veprime kryhen në prani të dy dëshmitarëve. Pronari, në çastin e kthimit të pasurive të marra në përdorim të përkohshëm, ka të drejtë të kërkojë kthimin e tyre në gjendje e mëparshme ose kundër-vleftën për dëmet e shkaktuara. Kur pronari refuzon pranimin e kthimit, pasuria pronë private e marrë në përdorim të përkohshëm, mbahet në ruajtje për llogari të pronarit dhe shpenzimet mbeten në ngarkim të tij

Gjithashtu, shteti duhet të kompensojë edhe për zhvlerësimin e pronës pranë pronës që do të shpronësohet. Nga ana tjetër, asnjë interes nuk mund të konsiderohet publik nëse ekzistojnë mundësi të tjera për të arritur një qëllim të tillë.

Pasuria e paluajtshme mund të merret vetëm për qëllimet e mëposhtme: (i) përmbushjen e detyrimeve të shtetit, të cilat lindin nga traktatet dhe konventat shumëpalëshe ndërkombëtare; (ii) zhvillimin e

<sup>3</sup> (i) Ligji nr. 8651, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar dhe; (ii) Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 126, datë 23.3.2000 "Për përbërjen dhe procedurat e punësimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet" dhe; (iii) VKM nr. 127, datë 23.3.2000 "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe; (iv) VKM nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik (i ndryshuar)" dhe; (v) Kodi Civil shqiptar dhe; (vi) Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar dhe; (vii) VKM nr.147, datë 23.03.2000, "Për rregullat dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të posaçëm për shpronësimet" dhe; (viii) Udhëzimi nr. 1, datë 5.10.2000 "Kriteret teknike të përlogaritjes së vlerës së bimëve drufrutore që shpronësohen për interes publik, në rastet kur mungojnë treguesit e deklaruar të shitblerjes".



programeve, projekteve dhe investimeve në territoret shqiptare dhe jashtë saj, të parashikuar në marrëveshjet ndërkombëtare që zbatohen nga Shqipëria; (iii) zhvillimin e projekteve të transportit, energjetikës, telekomunikacioneve, veprave ujore dhe infrastrukturës së kanalizimeve; (iv) zbatimin e projekteve dhe investimeve me qëllim mbrojtjen e mjedisit, shëndetit, kulturës dhe edukimin e publikut; (v) zbatimin e programeve dhe investimeve të fokusuar në mbrojtjen kombëtare. (vi) mbrojtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore, përfshirë ndërtesat dhe vendet historike, monumentet, objektet e lashta etj., të cilat konsiderohen me vlerë për t'u ruajtur për të ardhmen. Këtu përfshihen objekte të rëndësishme për arkeologjinë, arkitekturën, shkencën ose teknologjinë e një kulture të caktuar. Shpronësimi mund të bëhet në favor të personave juridikë publikë ose privatë. Nëse janë persona juridikë privatë ata mund të përfitojnë vetëm për qëllime të zhvillimit të projekteve të transportit, telekomunikacioneve, veprave ujore dhe infrastrukturës së kanalizimeve ose projekteve dhe investimeve që kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit, shëndetit, kulturës dhe edukimin e publikut.

#### 2.4.3 Pronësia dhe përdorimi i tokës

Baza ligjore për këtë është një kuadër kompleks, i cili është i vështirë për t'u zbatuar dhe ka ende zona të errëta. Marrëveshja e koncesionit midis METE-s dhe DHP-së është baza ligjore që vesh me përgjegjësi qeverinë për risistemimin dhe sigurimin e pasurisë.

Ligji i vitit 1993 për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve (nr. 7698), (i rishikuar në vitin 2004, me nr. 9235), u jep të drejtën pronarëve të tokave të shpronësuar përpara vitit 1945 që të kërkojnë kthimin e tokës jo bujqësore dhe bujqësore deri në 100 hektarë. Megjithatë, shumica e kësaj toke i është dhënë tashmë punëtorëve të fermave kolektive sipas ligjeve të vitit 1991 dhe 1992. Kompensimi në vend të kthimit mund të bëhet në një ose disa prej formave të mëposhtme: tokë shtetërore me të njëjtën vlerë; tokë në zonën e zhvillimit të turizmit; aksione në kompani me kapital shtetëror; vlerë të objekteve, si pajisje bujqësore, subjekt privatizimi; dhe të ardhura pa taksa ose tatime. Ligji i rishikuar (2004) krijoi një Komision Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave.

Kodi Civil Shqiptar i vitit 1994, i ndryshuar, përbën legjislacionin kryesor që rregullon pronësinë e tokës, dhënien me qira dhe të drejtat e zotërimit dhe përdorimit. Sistemi i pronësisë së pronës varet nëse ajo është tokë private, shtetërore ose publike, ku secila kategori toke ka regjimin e saj për të drejtat e pronësisë, zotërimit dhe të drejtat e tjera. Servitutet përmenden në Kodin Civil duke përcaktuar të drejtat e përkohshme dhe të përhershme të aksesit të të dyja palëve në një marrëveshje servituti duke përfshirë kushtet e përfundimit të marrëveshjes.

Ligji i vitit 1995 "Për kullotat" (Nr. 7917), i ndryshuar, parashikon transferimin e të drejtave të qeverisja vendore për të administruar dhe për të përdorur kullotat shtetërore. Komunitat mund të lidhin me përdoruesit e kullotave kontrata dhjetëvjeçare për dhënien me qira.

Ligji për transferimin e pronësisë të tokave bujqësore pa kompensim (Nr. 8053, viti 1995) (i ndryshuar) rregullon transferimin e tokës bujqësore tek familjet bujqësore ose individët që përdorin tokën.

Kushtetuta e Shqipërisë e vitit 1998 garanton të drejtën e pronës private dhe parashikon se të drejtat e pronësisë nuk mund të shkelen pa procesin e duhur. Ligji për Parimet Kushtetuese i vitit 1991 (Nr. 7491) angazhonte shtetin për të zhvilluar marrëdhëniet ekonomike në bazë të parimeve të tregut dhe të pronësisë të tokës private. Kushtetua parashikon se shpronësimet ose kufizimet në ushtrimin e së drejtës së pronësisë mund të bëhen vetëm për interesa publike dhe lejohen vetëm kundrejt praktikave të kompensimit të drejtë, ndaj të cilit mund të paraqitet ankesa në gjykatë vetëm në lidhje me masën e kompensimit.

Ligji për tokat bujqësore të pandara (Nr. 8312, viti 1998) rregullon regjimin e tokës bujqësore të pandarë ose tokën që është refuzuar nga punëtorët e ish-fermave shtetërore dhe anëtarët e kooperativave bujqësore shtetërore.

Ligji për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave (Nr. 8337, viti 1998) rregullon transferimin e titullit të pronësisë të tokës bujqësore, pyjeve, kullotave dhe livadheve tek individët shqiptarë ose personat juridik. Ligji për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore (Nr. 8318, viti 1998), (i ndryshuar) rregullon dhënien me qira të pronës shtetërore individëve ose personave juridikë.

Ligji për pronat e paluajtshme të shtetit (Nr. 8743, viti 2001) (i ndryshuar) rregullon regjimin dhe administrimin e pronave të paluajtshme të shtetit. Ligji për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore (Nr. 8744, viti 2001) (i ndryshuar) rregullon transferimin e pronësisë të pronave të paluajtshme shtetërore nga qeveria qendrore tek njësitë e qeverisjes vendore.

Ligji i 2004-es për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale (Nr. 9304, viti 2004) u hartua për të trajtuar problemin e përhapur të zaptimit të paligjshëm të tokës urbane nëpërmjet formalizimit të drejtave. Ligji krijoi një sistem të aplikimeve të vetëdeklarimit, nëpërmjet të cilave banorët që kanë zaptuar tokë mund të aplikojnë për të paguar çmimin e tregut për të fituar pronësinë e tokës së tyre nga shteti. Ligji parashikon çmime fikse për shitjen e pronës mbi të cilën është ndërtuar në mënyrë informale brenda vijës së verdhë (neni 20) dhe jashtë vijës së verdhë (neni 19).

Ligji për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara (Nr. 10 263, viti 2010) parashikon rregullat dhe procedurat për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara, për të garantuar funksionin ekonomik të pronës në kuadrin e zhvillimit të qëndrueshëm bujqësor dhe rural.

E drejta kalimit në tokën e një të treti, uzufukti, dhe qiraja/nënqiraja mund të realizohen në bazë të kontratave që lidhen midis palëve. Të gjitha kontratat, përveç kontratave të qirasë/nënqirasë të cilat lidhen për një periudhë më të shkurtër se 9 vjet, janë objekt i regjistrimit pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP).

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) lëshon Certifikatën e Pronësisë të shoqëruar me Hartën e Pronës dhe Kartelën e Pronës, duke pasqyruar të gjithë informacionin për pronën, pronarët e pronave që janë përfshirë në sistemin e ri të regjistrimit, ndërsa për pronat që nuk janë përfshirë ende në këtë sistem, ZRPP-ja lëshon një dokument që vërteton titullin e pronësisë, të quajtur "Vërtetim Pronësie", të shoqëruar me hartën e pronës.

#### 2.4.4 Mjedisi dhe zonimi i territorit

Ligjet kryesore që rregullojnë zonimin, mjedisin dhe çështjet që lidhen me përdorimin dhe zënien e tokës, përfshijnë ligjin e datës 17 dhjetor 2009 për planifikimin urban (i ndryshuar), i cili parashikon rregullat për ndërtimin dhe arkitekturën e ndërtesave në territorin e Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 10 119, datë 23.04.2009 për planifikimin e territorit (i ndryshuar, në fuqi nga vitit 2011) që zëvendësoi ligjin për urbanistikën (Nr. 8405, viti 1998). Ligji i ri parashikon parimet bazë, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për planifikimin e territorit. Instrumentet e veçanta të kontrollit të zhvillimit (Seksioni II, neni 62 - 69 i ligjit për planifikimin e territorit, 2011), kur të zhvillohen do të parashikojnë kushtet për rezervimin e tokës për interes publik nëpërmjet një pezullimi zhvillimi për një periudhë deri në 18 muaj pa qenë i nevojshëm kompensimi, por që do të përgatitet gjatë gjashtë muajve të fundit të periudhës.

Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit (i ndryshuar) parashikon zbatimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit në përputhje me rregulloret për ndarjen e territorit dhe mjedisin. Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 për inspektimin e ndërtimit (i ndryshuar) ka për qëllim të sigurojë respektimin e normave, standardeve dhe legjislacionit në fushën e ndërtimit, urbanistikës dhe rezervave ujore.

Ligji nr. 8093 (1996) për rezervat ujore (i ndryshuar deri në 2001) përcakton zonat e sigurisë rreth rezervuarëve (neni 55 dhe neni 2) midis 5 dhe 20 metrave nga vija e nivelit maksimal 25 vjeçar të ujit,

në varësi nga kërkesat e sigurisë për njerëzit dhe pronat, dhe thekson se kjo zonë mund të vendoset vetëm për shërbim publik. Zona mund të zgjerohet deri në 200 m nëse është nevojshme dhe duhet të vendoset nga autoritetet e ujit.

Ligji nr. 8934, datë 05.09.2002 për mbrojtjen e mjedisit (i ndryshuar) rregullon marrëdhënien me mjedisin dhe përcakton rregullat për ruajtjen e një mjedisi të pastër.

Ligji nr. 8990, datë 23.01.2003 për vlerësimin e ndikimit në mjedis (i ndryshuar) përcakton rregullat dhe procedurat për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Zbatimi i rregulloreve për mjedisin kontrollohet nga agjencitë rajonale të mjedisit. Ministri i Mjedisit është autoriteti përgjegjës për miratimin e lejes mjedisore në rastet kur aktiviteti për cilin kërkohet leja ushtrohet në nivel kombëtar.

Ligji nr. 8897, datë 16.05.2002 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (i ndryshuar) parashikon përcaktimin e masave për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Ligji nr. 9010, datë 13.2.2003 për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta (i ndryshuar) synon mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre.

Ligji nr. 8906, datë 06.06.2001 për zonat e mbrojtura (i ndryshuar) rregullon mbrojtjen dhe administrimin e zonave të mbrojtura dhe burimeve të tyre natyrore dhe biologjike.

Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 për mbrojtjen e biodiversitetit ka për qëllim të nxisë ruajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit.

#### **2.4.5 Burimet fizike të pasurisë kulturore (BFPK)**

Neni 48 i ligjit për trashëgiminë kulturore (ligji nr. 9048, prill 2003) thekson se nëse kanë filluar punimet e ndërtimit dhe rastësisht zbulohen gjurmë ose objekte me vlera arkeologjike-etnologjike, punimet duhen ndërprerë menjëherë dhe drejtuesit dhe investitorët e punimeve duhet të informojnë brenda tri ditëve organet e qeverisjes vendore dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës. Në vijim të studimit nga Instituti, mund të jepet autorizim për vazhdimin ose jo të punimeve, sipas rastit. Të gjitha shpenzimet mbulohen nga investitori.

Zhvendosja e vlerave të trashëgimisë kulturore, për ruajtjen e vlerave të tyre në mjedise të përshtatshme nga pikëpamja e sigurisë mund të bëhet me autorizimin nga Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Instituti i Kulturës Popullore ose Drejtoria e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit (neni 10) pas propozimit dhe regjistrimit të zhvendosjes në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore. Shteti mund ta shpronësojë pronën me vlera kulturore kombëtare nga pronarët e saj nëse është në interes të mbrojtjes së saj (neni 12).

Neni 118, i Kodit Penal të Shqipërisë, parashikon se dhunimi i varrit /varrezave dhe çdo lloj veprimi tjetër që ul respektin ndaj një të vdekuri, dënohet me gjobë ose burgim deri në 5 vjet. Neni 10, pika 3 (dh) e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, identifikon komunat dhe bashkitë si përgjegjëse për administrimin e varrezave dhe garantimin e shërbimeve të varrimit.

Ligji nr. 9220, datë 15.04.2004, rregullon shërbimin publik të varrimit në përgjithësi. Varrimet duhet të bëhen në varreza të cilat ndodhen përtej zonës së rezervuar së qendrave të banimit. Në qendrat e banuara me popullsi mbi 10 000 banorë, zona e rezervuar duhet të jetë më e madhe se 100 m nga vija kufizuese e qendrës së banuar dhe për ato me popullsi më të vogël se 10 000 banorë, duhet të jetë më e madhe se 50 m. Nëse është e nevojshme për interes publik, varrezat mund të prishen në bazë të një vendimi nga një komision i posaçëm i ngritur nga këshilli bashkiak ose komunal, pasi është marrë mendimi i Inspektoratit Sanitar Shtetëror. Zhvarrimi bëhet me lejen ose autorizimin e kryetarit të bashkisë ose komunës dhe varrezat e reja duhet të vendosen dhe projektohen nga departamentet përkatëse të këtyre institucioneve drejtuese.

#### **2.4.6 Të drejtat shoqërore, të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrja**

Kodi i familjes (ligji nr. 9062, miratuar më 8 maj 2003) identifikon si të zbatueshëm regjimin e pasurisë së përbashkët nëse bashkëshortët nuk kanë nënshkruar një kontratë, e cila përcakton një regjim tjetër pronësie. Në bazë të këtij regjimi, pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur një bashkëshort provon karakterin e saj vetjak ose kur ndryshon regjimin në bazë të kontratës. Nëse një prej bashkëshortëve tejkalon të drejtat e tyre në lidhje me pasurinë e përbashkët, bashkëshorti tjetër mund të kërkojë anulimin e aktit nëse ata nuk kanë dhënë pëlqimin për këtë akt. Ndarja e pasurisë nuk mund të bëhet gjatë vazhdimit të regjimit të pasurisë së përbashkët, madje edhe në rastin e një marrëveshje midis bashkëshortëve. Me fillimin e procedurave për ndarjen e pasurisë martesore, bashkëshortët ose trashëgimtarët e tyre kanë të drejtë të marrin pronën personale të luajtshme që kanë pasur në pronësi përpara martesës ose të cilën e kanë fituar gjatë martesës në formën e trashëgimisë. Në mungesë të provave kundërshtuese, prona e luajtshme prezumohet si pjesë e pasurisë martesore.

Ligji nr. 9198, datë 26.2.2004 për një shoqëri gjinore të barabartë parashikon masat për nxitjen e mundësive të barabarta midis burrit dhe gruas që kanë për qëllim eliminimin e diskriminimit direkt dhe indirekt mbi bazë gjinore. Ligji nr. 8086, datë 13 mars 1996 që ratifikon aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) nr. 105 "Për zhdukjen e punës së detyruar", dhe Konventa e ILO-s nr. 138 "Për moshën minimale për t'u pranuar në punë", dhe ligji nr. 8774, datë 23 prill 2001 për ratifikimin e konventës nr.182 të vitit 1999 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, "Format më të këqija të punës së fëmijëve".

### **2.5 Procedurat e shpronësimit**

#### **2.5.1 Hyrje**

Toka që i duhet DHP-së për projektin hidroenergjetik do të shpronësohet sipas kërkesave ligjore të qeverisë shqiptare për shpronësimin siç parashikohet në marrëveshjen e koncesionit midis DHP-së dhe qeverisë shqiptare.

Ky seksion përshkruan procesin e shpronësimit për tokën që do të merret. Ai gjithashtu përshkruan proceset për ankesat (të qeverisë shqiptare) që do të zbatohen gjatë fazave të ndryshme të planifikimit dhe zbatimit të projektit, procesin që do të zbatohet dhe procesin e administrimit të shqyrtimit për dhe përgjigjeve ndaj ankesave.

#### **2.5.2 Natyra e vlerësimit dhe pagesa e kompensimit për shpronësimin**

Ky seksion trajton procesin e shpronësimit në bazë të legjislacionit shqiptar, i cili do të plotësohet më pas nga procesi i risistemimit. Ndërtimi i Projektit Hidroenergjetik të Devollit (DHP) do të zbatohet standardet dhe kompensimin e synuar sipas kërkesave të IFC-së, të cilat ndryshojnë nga ato që zbatohen zakonisht në bazë të legjislacionit shqiptar.

Megjithëse Republika e Shqipërisë dhe DHP shpeshherë kanë role dhe përgjegjësi të ndryshme në procesin e kompensimit, hapat kryesorë dhe ndërveprimet e të dyja subjekteve me individët që do të kompensohen mund të ndodhin ose jo në të njëjtën kohë.

Shpronësimi kryhet vetëm për interes publik, i cili nuk mund të realizohet ose të mbrohet në një mënyrë tjetër. (p.sh. në këtë rast për realizimin e projekteve dhe investimeve që kanë interes dhe shtrirje territoriale lokale ose kombëtare në fushën e energjisë, kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

1. DHP paraqet kërkesën pranë ministrisë përgjegjëse për aktivitetin përkatës, me bashkëlidhjet, dokumentet të cilat janë parashikuar në nenin 10 të ligjit për shpronësimin.

2. Brenda 10 ditëve nga ky njoftim, parashikohet nënshkrimi i marrëveshjes midis ministrisë dhe personit që ka paraqitur kërkesën.
3. Brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, ministria fillon procedura në lidhje me pronarët e pronave të prekura.
4. Ndërkohë, një njoftim publik publikohet në fletoret zyrtare dhe në gazetatat kombëtare dhe lokale të njohura. Këto njoftime publikohen për një javë.
5. 1 muaj pas datës më të fundit të publikimit, ministria i paraqet propozimin për shpronësim qeverisë që të marrë vendimin përfundimtar.
6. Subjekti për të cilin bëhet shpronësimi paraqet aplikimin për shpronësim pranë ministrisë që është kompetente sipas ligjit.

### 2.5.3 Përgjegjësitë e organizimit të shpronësimit

Në ministrinë përgjegjëse të linjës ngrihet një Komitet i Posaçëm për shpronësimin. Nëse ministria, nëpërmjet Komitetit të Posaçëm, bindet se dokumentet janë përgatitur në bazë të ligjit dhe të vendimeve të qeverisë, ajo vendos të pranojë kërkesën për shpronësim dhe njofton personin që ka paraqitur kërkesën. Brenda 10 ditëve nga ky njoftim, parashikohet nënshkrimi i marrëveshjes midis ministrisë dhe personit që ka paraqitur kërkesën.

Për qëllimet e shpronësimit, brenda ministrisë do të duhet ngritja e një grupi specialist për studimin e tokës. Brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, ministria fillon procedura në lidhje me pronarët e pronave të prekura. Ndërkohë, një njoftim publik publikohet në fletoret zyrtare dhe në gazetatat kombëtare dhe lokale të njohura. Këto njoftime publikohen për një javë.

1 muaj pas datës më të fundit të publikimit, ministria i paraqet propozimin për shpronësim qeverisë që të marrë vendimin përfundimtar.

### 2.5.4 Vështrim i përgjithshëm i procesit ligjor për fitimin e te drejtave mbi pronësisë (LA)

Në bazë të dispozitave të marrëveshjes së koncesionit, ishte e rëndësishme që DHP-ja të merrte të gjitha të drejtat për aksesin e tokës për të gjitha zonat që mbulon projekti përpara fillimit të ndonjë aktiviteti ndërtimi. Kjo për arsyen se procesi lidhet ngushtë me ligjet shqiptare për licencat dhe lejet, si dhe të drejtat e ndërtimit.

Në bazë të studimeve më të hershme, u arrit në konkluzionin se toka e prekur nga zona e projektit të DHP-së ndodhet në dy qarqe të Shqipërisë, në Elbasan dhe Korçë, duke përfshirë tre rrethe: Elbasanin, Gramshin si pjesë e qarkut të Elbasanit dhe qarkun e Korçës. Në procesin e aksesit të tokës përfshihen përfshirë në mënyrë direkte 14 komuna dhe 2 bashki.

Objektivi përfundimtar i procesit të aksesit të tokës është të marrë të drejtat e uzufuktit dhe/ose të drejta të tjera pronësie për të gjithë tokën e kërkuar siç parashikohet në marrëveshjen e koncesionit të nënshkruar midis qeverisë shqiptare dhe aksionarëve të DHP-së, dhe të miratuar nga parlamenti shqiptar.

Toka e nevojshme për zonat e ndërtimit të DHP-së klasifikohet në dy grupe kryesore:

1. Tokë publike, e cila është tokë shtetërore dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes qendrore ose vendore;
2. Tokë private.

Për të dyja këto kategori toke, DHP-se ju kërkuar të sigurojë marrëveshjen e uzufuktit ose ndonjë marrëveshje për sheshet me qeverinë shqiptare (në mënyrë më specifike me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës).

### 2.5.5 Përgatitja nga DHP-ja e informacionit për përdorimin e tokës

DHP-ja përgatit të dhënat për pronat që preket nga marrja e tokës për projektin sipas legjislacionit shqiptar në zonën e propozuar për Projektin në bazë të të dhënave të regjistrit ekzistues zyrtar të kadastrës dhe vlerësimit të vlerave të pronave të luajtshme dhe të paluajtshme që kryhet nga një ekspert vlerësues.

Pas përgatitjes dhe verifikimit përfundimtar të inventarit të pronave me titull ligjor që preken nga projekti, ai dërgohet në METE, në përputhje me marrëveshjen e koncesionit në formën e Dokumentacionit të Kërkesës për Sheshin, ku pronat private janë objekt i ligjit për shpronësimin dhe pronat shtetërore janë objekt i ligjeve të tjera për dhënien e pronave për interes publik.

DHP-ja paraqet aplikimin për Dokumentacionin e Kërkesës për Tokën, duke përfshirë pronat private dhe shtetërore në përputhje me marrëveshjen e koncesionit.

- Për sa i përket pronave private, zbatohet ligji për shpronësimin dhe DHP-ja ka paraqitur tashmë aplikimin pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për listën e pronave që duhen shpronësuar, të shoqëruar nga kërkesat në bazë të nenit 10 të ligjit.
- Për sa i përket pronave shtetërore, është paraqitur një kërkesë në METE dhe pranë autoriteteve të tjera përmes së cilës kërkohet dhënia e tokës për interes publik. Procedura ndiqet nga ministria përkatëse dhe më pas i dërgohet Këshillit të Ministrave për miratim.

### 3. MBËSHTETJA PËR RISISTEMIMIN DHE MJETET E JETESËS

#### 3.1 Situata aktuale dhe pamja e përgjithshme

Në terma të përgjithshëm risistemimi kuptohet si "tërësia e humbjeve të drejtpërdrejta ekonomike dhe sociale që rezultojnë nga marrja e tokës dhe kufizimi i aksesit, së bashku me masat kompensuese dhe korrigjuese që pasojnë." Në këtë kontekst, termi nuk kufizohet në kuptimin e tij të zakonshëm—zhvendosje fizike. Risistemimi brenda kuadrit të procesit të DHP-së përfshin (a) fitimin e të drejtave mbi tokën dhe godinave mbi të, përfshirë bizneset; (b) zhvendosjen fizike; dhe (c) rehabilitimin ekonomik të personave të zhvendosur, për të përmirësuar (ose të paktën për të rikuperuar) të ardhurat dhe standardet e jetesës. Ky program mbulon ndikimet në sipërfaqet e tokës së ndërtimit të projektit të përdorura për punët civile kryesore (centralet për prodhimin e energjisë, kanali i shkarkimit, gropat e formuara nga marrja e materialeve inerte dhe zonat për hedhjen e mbeturinave inerte, guroret etj.), kampet e kontraktorëve, stacionet dhe nënstacionet e reja të transmetimit, si dhe të gjithë zonën e rezervuarit.

Masat mbrojtëse sociale, mjedisore dhe ekonomike të projektit do të sigurojnë minimizimin e ndikimeve të ndërtimit dhe operimit mbi shoqërinë dhe mjedisin dhe do të sigurojnë (ndër të tjera) ofrimin e kompensimit të duhur për Familjet e Prekura nga Projekti (FPP). Blerja dhe përdorimi i përkohshëm ose i përhershëm i tokës për ndërtimin dhe operimin do të rezultojnë në ndikime që përfshijnë prishjen dhe humbjen e përkohshme ose të përhershme të tokës dhe aseteve, të cilat që të gjitha kërkojnë kompensim të atyre familjeve që mund të jenë pronare dhe/ose përdoruese të tokës dhe aseteve të prekura. Kompensimi për këto ndikime do të përfshinte përdorimin e një grupi metodash të diversifikuara, si p.sh.: blerja e aseteve ose kompensimi me para në dorë (shpronësimi nga qeveria shqiptare) dhe/ose zëvendësimi i drejtpërdrejtë i tokës ose i aseteve në një vend tjetër, dhe/ose masat afatshkurtra dhe afatgjata për të rikuperuar mjetet e jetesës ose të ardhurat e prekura, në bazë të skemës së përfitimeve të miratuar nga DHP-ja. Këto masa risistemimi, përveçse duhet të jenë teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshme, duhet që të pranohen edhe nga FPP-të që të konsiderohen të suksesshme.

#### 3.2 Baza

Të dhënat bazë të mbledhura (dhe që do të mblidhen) përbëhen nga 4 pjesë. Këto bëhen në faza të ndryshme të zbatimit bazuar në shtrirjen kohore të ndërtimit dhe vendosjes së përparësisë së zonës së Banjës gjatë mbledhjes së të dhënave. Thënë kjo, ekziston një VNMS gjithëpërfshirëse që mund të gjendet në shtojcën e dokumentit, e cila jep informacione treguese të zonave të përgjithshme të ndikuara për të 3 hidrocentralet.

1. Studimi social-ekonomik i fshatrave dhe i personave të prekur (përfshirë moshën, të kaluarën, të ardhurat dhe çështjet shëndetësore) formojnë bazën për zhvillimin e synimit ekonomik dhe të planit për rikuperimin e mjeteve të jetesës për çdo të zhvendosur. Kjo gjithashtu shërben për:
  - a. Të identifikuar banorët e zonave të prekura me qëllim përcaktimin e një baze për hartimin e programit të risistemimit dhe për të përjashtuar fluksin e ardhshëm të personave të shtyrë nga e drejta për kompensim dhe ndihma në risistemim.
  - b. Karakteristikat standarde të familjeve të zhvendosura, përfshirë një përshkrim të sistemeve të prodhimit, organizimit të punës dhe familjes; dhe informacione bazë mbi mjetet e jetesës (përfshirë, sipas rastit, nivelet e prodhimit dhe të ardhurat që vijnë nga veprimtaritë ekonomike formale dhe informale) dhe standardet e jetesës (përfshirë gjendjen shëndetësore).
  - c. Regjistrimin e plotë të humbjeve nga përmbytjet në zonë, përfshirë sipërfaqen e tokës, popullsinë, banesat, pemët frutore, të mbjellat, gjënë e gjallë, burimet nga prona e përbashkët, burimet kulturore fizike, rrugët lokale dhe struktura të tjera etj., të cilat

- përbëjnë bazën për llogaritjen e të drejtave të kompensimit individual për FPP-të dhe/ose të zgjidhjeve për gjithë fshatin. Kjo përfshin identifikimin e çështjeve të ngritura nga sisteme të ndryshme shfrytëzimi në zonën e projektit;
- d. Informacionet për grupet ose personat vulnerabël që mund të kenë nevojë për kushte të veçanta. World Bank (Banka Botërore) ka identifikuar një tendencë të përgjithshme kombëtare për përfshirjen e ngadaltë të grave në tregun e punës dhe në role vendimmarrëse. Rolet e përcaktuara në përgjithësi e kanë shtyrë femrën që të mbajë barrën e mirëqenies së familjes si shtëpiake, por diskriminimi gjinor nuk është theksuar si një shqetësim serioz në zonën e projektit.
  2. Burime nga prona e përbashkët: Një inventar i burimeve natyrore nga të cilët njerëzit sigurojnë mjetet dhe jetesën e tyre, sisteme të uzufruktit pa tituj pronësie (përfshirë peshkimin, kullotjen e bagëtive ose përdorimin e zonave pyjore) të drejtura nga mekanizma të shpërndarjes së tokës të njohura lokalisht/kulturalisht/tradicionalisht. Ishte e vështirë që mbi baza individuale FPP-të të identifikonin kontributet e pronës së përbashkët në mjetet e tyre të jetesës, por janë treguar disa vlerësime të përafërta.
  3. Infrastruktura publike dhe shërbimet sociale që do të preken (të trajtuara nga programi për zhvillimin rajonal);
  4. Vlerësimi i kapacitetit prodhues i zonave të mbetura (për sa i përket rezervave tokësore dhe ujore) dhe identifikimi vijues i opsioneve të përdorimit të tokës.

Që nga faza fillestare e projektit fshatrat që do të prekeshin janë vizituar disa herë për të marrë të dhëna që lidhen me mjetet e jetesës në fshat dhe për t'i informuar fshatarët për ndikimet e projektit. Konsultimet do të vazhdojnë gjatë gjithë procesit të risistemimit për të ndihmuar në identifikimin e nevojave dhe zgjidhjeve për të zbutur problemet e mundshme. Bazuar në informacionin që kemi, numri i FPP-ve të mundshme është siç tregohet në tabelën më poshtë:



Nr.	Komuna	Fshati	~ FPP	Nr.	Komuna	Fshati	Nr. i Familjeve të identifikuara
1	Gostimë	Shtepanj	13	1	Kodovjat	Kokël	0
	Gostimë	Shushicë e Vogel	54	2	Kodovjat	Bratilë	18
3	Qyteti Gramsh		22	3	Skënderbegas	Kullollas	1
4	Klos	Qafe (Banjë e Vjetër)	39	<b>Total Kokël</b>			<b>19</b>
5	Pishaj	Çekin	24				
		Cërujë	42	1	Moglicë	Dobërçan	26
		Drizë	80	2		Gurshqipe (Popçisht)	21
		Gjergjovinë	25	3		Maliq Opar	1
		Pishaj	17	4		Lumaj	57
		Qerret	18	5		Moglicë	6
		Cingar	40	6		Nikollarë	31
		Trashovicë	18	7		Osojë	13
6	Sult	Dushk (Silare)	23	8		Peshtan	3
		Zgjuhë Kodër	15	9		Gjinikas	4
		Mazrek	18	10		Kodras	14
		Zgjuhë Fushë	13	11	Lekas	Poponive	5
7	Tregan	Blerimas	7	<b>Total Moglicë</b>			<b>181</b>
		Kaçivel	11				
		Shinavlash	34	<b>Total Zona e Projektit</b>			<b>646</b>
<b>TOTAL Banjë</b>			<b>446</b>				

**Tabela 3: Detajet për inventarët e asetëve të marra për familjet e mundshme që mund të preken nga projekti (FPP).**

*SHËNIM: Zërat me të KUQE janë vlerësime për të cilat nuk janë kryer inventarë të plotë (deri më sot).*

Për shkak të natyrës së regjistrimit të popullsisë dhe ardhjes/ikjes sezonale të punëtorëve është e vështirë që të përcaktohet përqindja aktuale (reale) e popullsisë totale që preket në secilin prej fshatrave. Vlerësimet mund të bëhen në raporte të mëvonshme, sipas nevojës.

### 3.3 Profilet e përgjithshme të fshatrave

Fshatrat ndahen sipas ndikimeve gjeografike bazuar në hidrocentrale (Banjë, Kokël dhe Moglicë). Një përshkrim i shkurtër i secilit prej fshatrave tregon shkallën e ndërhyrjes që kërkohet nëpërmjet programit të risistemimit të DHP-së. Në disa raste, në përshkrime përfshihen rekomandime të përgjithshme të ZHMJ-së. Është e rëndësishme të vihet në dukje se nivelet e ndikimeve bazohen në informacionet aktuale dhe mund të rregullohen sipas rastit gjatë fazës së zbatimit.

### 3.3.1 HEC-i Banjë

Meqë HEC-i i Banjës është ndikimi fillestar i projektit, mbledhja e të dhënave është shumë më përpara për zonat që mund të ndikohen nga ky projekt. Është e rëndësishme të vihet në dukje se nivelet e ndikimit bazohen në humbjen e deklaruar të tokës bujqësore dhe nuk bazohen në humbjen e mundshme për familje bazuar në të ardhurat nga burimet bujqësore apo toka totale në dispozicion (që do të tregonte opsionet që mbeten për tokën për çdo fshat). Nivelet e ndikimit - të cilat do të modifikohen pas nismave të mëtejshme për mbledhjen e të dhënave - dhe aktivitetet e ndërmarra për të trajtuar këtë çështje, përcaktohen më tej në seksionet në vijim.

- **Shtëpanj**

Fshati Shtëpanj ndodhet 2 km poshtë digës së Banjës. Ndikimi mbi territorin e këtij fshati kufizohet me kërkesat për tokën për ndërtimin e projektit për hidrocentralin e Banjës. 100% e tokës që do të ndikohet është formalisht pronë e qeverisë shqiptare dhe FPP-të këtu janë munduar të rehabilitojnë sheshet e mëparshme të ndërtimit në ngastra bujqësore, por pa shumë sukses, dhe produktet kryesore që kultivohen në zonat që preken janë pemët frutore.

- **Shushicë e Vogël**

Shushica e Vogël ndodhet në rrjedhën poshtë digës së Banjës, por banorët e saj përdorin tokën bujqësore përgjatë rrjedhës së sipërme mbi digë dhe do të ndikohen nga punimet e ndërtimit në Banjë dhe nga përmbytja. Fshati në fillim ndodhej mbi digën e Banjës, por u zhvendos në vitin 1988 për shkak të projektit të mëparshëm të Banjës. Familjet u shpronësuan dhe iu dha shtëpi dhe tokë në Cërrik (që ndodhet rreth 10-15 km larg rrjedhës së poshtme), por shumë prej tyre ende përdorin tokën në rrjedhën e sipërme. Sipërfaqja totale e tokës që preket është 42 hektarë, e cila është e gjitha tokë shtetërore. Duke pasur parasysh situatën në këtë fshat dhe pretendimet konfliktuale ndërmjet ish-pronarëve të tokës dhe përdoruesve aktualë të saj, ndërhyrja më e përshtatshme për këtë fshat është ajo komunitare.

- **Qyteti i Gramshit**

Në total, në qytetin e Gramshit identifikohen 2,1 hektarë tokë që mund të preket. Toka që përdoret ndodhet në shtratin e lumit dhe vështirësitë lindin në procesin e identifikimit, sepse varësia nga bujqësia në këtë zonë është më e ulët krahasuar me fshatrat përreth. Ndryshe nga familjet që preken në fshatra, ku gjenden shumë ngjashmëri, pothuajse çdo familje e prekur në qytetin e Gramshit është një rast që ka nevojë të shqyrtohet me një zgjidhje specifike kompensimi.

- **Qafë (Banja e Vjetër)**

Bashkë me fshatin Shushicë e Vogël, Qafa (Banja e Vjetër) do të jetë një nga fshatrat e parë që do të preket nga hidrocentrali i Banjës duke humbur tokën bujqësore për shkak të ndërtimeve. Humbja e kësaj toke nënkupton se familjet e prekura humbasin mesatarisht 33% të tokës së tyre bujqësore në përdorim dhe tokën e kullotave, që përkon me 14% të totalit të mjeteve të tyre të jetesës. Familjet i përdorin prodhimet nga toka e tyre kryesisht për konsum familjar, ndërsa disa të tjerë i shesin prodhimet në tregjet lokale.

- **Çekin**

Në total ~6,7 hektarë tokë do të preken në fshatin Çekin. Toka bujqësore që preket ndodhet në shtratin e lumit dhe një pjesë e vogël në rrjedhën e përroit ndërmjet fshatit Çekin dhe Qerret. Toka që ndodhet në rrjedhën e përroit në veri të fshatit është në pronësi, ndërsa toka që humbet në shtratin e lumit të Devollit është tokë në përdorim. Bimët që rriten kryesisht në tokën e humbur janë foragjeret dhe perimet, të kombinuara me pemët frutore në disa parcela.

- **Cërujë**

Në total 4,1 hektarë tokë do të humbasin në fshatin Cërujë, shumica e përdorur për foragjere, misër dhe perime. Humbja e tokës nënkupton se shumica e familjeve të prekura në Cërujë humbasin më pak se 30% të mjeteve të tyre të jetesës. Shqetësimet kryesore janë të ngjashme me fshatrat e tjerë që preken, duke vënë në dukje mungesën e vaditjes për bujqësinë, mungesën e sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe çmimet e larta të inputeve bujqësore.

- **Drizë**

Fshati Drizë është një fshat që preket nga rezervuar i hidrocentralit të Banjës me më shumë se 55 hektarë dhe disa banesa të projektuara si të humbura. Inventari në Drizë nuk është realizuar plotësisht për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga përfaqësuesit e fshatit, pavarësisht përpjekjeve të shumta që janë bërë për të arritur një marrëveshje. Në kohën e përpilimit të këtij dokumenti, rreth 10% e fshatit i ka dorëzuar DHP-së inventarë të detajuar të aseteve. Thënë kjo, me nivelin e lartë të pronësisë së aseteve të tokës (VNMS f. 684), ka besim në nivelin e informacionit për një total prej 87 FPP (nga procesi i shpronësimit). Disa familje individuale kanë pranuar që t'i dorëzojnë ekipeve të DHP-së një inventar pasurish dhe ai do të përdoret në vlerësimin e humbjeve të tyre dhe të opsioneve të mëpasshme për mbështetjen që ofrohet me mjetet e jetesës.

- **Gjergjovinë**

Në total ~4 hektarë tokë humbasin në fshatin Gjergjovinë, dhe humbja e kësaj toke nënkupton se humbja mesatare është 17% e mjeteve të tyre të jetesës. Toka e prekur është kryesisht e mbjellë me foragjere, perime dhe pemë frutore. Ky komunitet paraqet shqetësime të ngjashme për sistemin e vaditjes, të kanalizimit të ujërave të zeza dhe kostove të inputeve bujqësore, plus disa përmendin mungesën aktuale të zonave për foragjere dhe kullota.

- **Pishaj**

Meqë shumica e tokës që humbet në Pishaj nuk ka pronarë zyrtarë, zgjidhja për kompensimin duhet të përqendrohet në nivel komuniteti, si p.sh. mbështetje për sistemet e vaditjes dhe mbështetja bujqësore. Në nivel familjeje, fidanët janë një mënyrë e drejtpërdrejtë për të kompensuar pemët e humbura. Një pjesë e madhe e tokës që humbet përdoret për bahçe perimesh.

- **Qerret**

Fshati Qerret preket kryesisht nga projekti nga humbja e ndërtesave dhe shtëpive të banimit në zonën e përmbytur përgjatë skajit të zonës së përmbytur/sigurisë. Si pasojë e projektit në Qerret do të humbasë shumë pak tokë bujqësore. Në total, 1,3 hektarë tokë (shumica tokë e përdorur për strukturat), 6 banesa dhe 36 struktura të tjera do të humbasin në fshatin Qerret. Sipas të dhënave nga inventari, kufizimet kryesore për banorët janë vaditja, çmimet e larta të inputeve bujqësore, mungesa e tokës dhe puna për prodhimet bujqësore, si dhe papunësia.

- **Cingar**

Në total 28 hektarë tokë do të humbasin në Cingar, shumica e përdorur për foragjere, misër, perime dhe pemë frutore. Përveç kësaj, 4 banesa në Cingar ndodhen shumë pranë zonës së sigurisë / ujit në nivelin më të lartë. Ndikimet (nëse ka) në këto familje varen nga disa faktorë. Ndikime të tjera janë humbja e aksesit në tokat bujqësore dhe në zonat pyjore.

- **Trashovicë**

Fshati Trashovicë do të preket shumë pak nga projekti në tokë bujqësore. Nga të gjitha familjet në fshat, 18 preken në mënyrë të drejtpërdrejtë duke humbur tokën bujqësore në shtratin e lumit. Të gjitha këto familje janë përdorues pa tituj pronësie për tokën që humbet dhe disa nga familjet nuk e kanë përdorur tokën 2 vitet e fundit. Në total do të preken ~7,5 hektarë tokë. Toka që do të humbasë përdoret kryesisht për prodhimin e foragjereve, si p.sh. tërshëra, jonxha dhe misri. I shtrirë në bregun e majtë të lumit Devoll, çështje të tilla si transportimi (aksesi për në Gramsh), vaditja, toka e kullotave, kostoja e lartë e inputeve bujqësore, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza dhe papunësia janë shqetësimet kryesore të banorëve të fshatit.

- **Dushk**

Rezervuari do të përmbytë ~36,5 hektarë tokë në total, nga të cilët 10 hektarë janë kullota dhe pjesa e mbetur është tokë bujqësore. Vetëm ~ 2 hektarë është tokë në pronësi, ndërkohë që pjesa tjetër është tokë në përdorim. Arsyeja për përqindjen e madhe të tokës në përdorim pa dokumente pronësie është se fshati përdor një sipërfaqe të madhe toke në Dushkun e Vjetër. Pronarët e vjetër të këtyre tokave janë shpronësuar gjatë projektit të Banjës në vitet 1980, por ende e përdorin këtë tokë edhe pse ajo është zyrtarisht e regjistruar si tokë shtetërore. Sipas ish-pronarëve që tani janë përdorues, kjo është tokë me cilësi të lartë dhe përmbytja do të ketë një ndikim të madh në mjetet e tyre të jetesës.

- **Zgjupë-Kodër**

Në total, 3 hektarë tokë bujqësore do të humbasin në Zgjupë-Kodër, shumica e mbjellë me misër, grurë dhe tërshërë. Çështjet aktuale që përmenden gjatë inventarit janë shpatet e pjerrëta të tokës bujqësore, mungesa e rrugëve hyrëse dhe mungesa e sistemit të vaditjes, gjë që i pengon banorët që të shfrytëzojnë tokën e tyre bujqësore dhe të rrisin prodhimin bujqësor. Gjatë inventarit, familjet e prekura gjithashtu shprehën shqetësime të mëdha që rezervuari (dhe luhatjet e tij) mund të rrisin paqëndrueshmërinë e tokës në zonë. Zgjupë-Kodër tashmë është përballur me disa rrëshqitje dheu që kanë shkaktuar dëme në banesa dhe në toka bujqësore.

- **Mazrek**

Në total 49,7 hektarë tokë që përdoret nga banorët e Mazrekut do të humbasë. Kjo tokë kryesisht përdoret për prodhime foragjere, si tërshëra dhe elbi, meqë mjete kryesor i të ardhurave për komunitetin është rritja e gjësë së gjallë. Me qëllim sigurimin e foragjereve të mjaftueshme për bagëtitë, familjet në Mazrek përdorin tokën që më parë ishte nën pronësi të fshatit të zhvendosur të Darzezës. Meqë këto janë tokat më produktive, rritja e gjësë së gjallë në komunitet do të ndikohet shumë nga projekti për shkak të humbjes së foragjereve. Sipërfaqet e mbetura të tokës, nëse nuk shfrytëzohen me efektivitet nuk do të mund të prodhojnë foragjere të mjaftueshme për gjënë e gjallë; në këtë mënyrë familjet nuk do të jenë në gjendje të rrisin bagëti, gjë e cila do të ndikojë shumë në jetesën e tyre.

- **Zgjupë-Fushë**

Njësoj si fshati fqinj, Zgjupë-Kodër, ky fshat preket pak, ku 2,6 hektarë tokë bujqësore do të humbasin në Zgjupë-Fushë bashkë me 119 pemë frutore. Megjithatë, sipërfaqja e tokës bujqësore që humbet është edhe më e vogël meqë shumica e kësaj toke të pretenduar si e humbur është tokë ugar dhe nuk është përdorur për shumë vite. Toka që humbet dhe që përdoret aktualisht është kryesisht e mbjellë me misër, grurë dhe perime.

- **Blerimas**

Blerimasi shtrihet përgjatë lumit Zalli i Kaçivelit. Projekti nuk prek asnjë ndërtesë ose pemë në këtë fshat. Sipërfaqja totale e tokës që humbet është 2,2 hektarë, shumica e përdorur për foragjere. Njësoj si Kaçiveli, familjet në Blerimas pretendojnë se përdorin sipërfaqe të mëdha toke (rreth 3 hektarë për familje), gjë që nënkupton se edhe pse humbjet janë të mëdha për sa i përket metrave katrorë për familje, mbetet tokë e mjaftueshme për shfrytëzim nga familjet, gjë e cila do të ndihmonte në rikuperimin e mjeteve të jetesës për këto FPP.

- **Kaçivel**

Kaçiveli shtrihet përgjatë lumit Zalli i Kaçivelit dhe ndikohet nga humbja e tokës bujqësore në shtratin e lumit Holta për shkak të rritjes së nivelit të ujërave. Projekti do të ketë ndikim të ulët në Kaçivel, ku vetëm pak familje do të preken në mënyrë të drejtpërdrejtë. Megjithatë, sipërfaqja e tokës që humbet është e madhe në raport me tokën totale që përdoret nga familjet; mesatarisht familjet do të humbin 55% të tokës së tyre bujqësore. Në total, projekti do të prekë 13,5 hektarë tokë të përdorur kryesisht për foragjere dhe grurë. Në përgjithësi, standardi i jetesës në Kaçivel është dukshëm më i ulët se në fshatrat e tjerë të prekur nga hidrocentrali i Banjës. Problemet e përbashkëta të zhvillimit të komunitetit që janë përmendur janë mungesa e sistemit vaditës, mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm, kushtet e këqija të rrugëve të brendshme të fshatit, dhe mungesa e një shkolle dhe e shërbimeve shëndetësore.

- **Shinavlash**

Shinavlashi shtrihet përgjatë lumit Zalli i Kaçivelit dhe preket nga projekti nga humbja e tokës bujqësore në përdorim në shtratin e lumit. Ndikimet e projektit te banorët e Shinavlashit janë të vështira për t'u vlerësuar, sepse procesi i inventarizimit u karakterizua nga të dhëna kontradiktore dhe një përqindje e lartë e ish-banorëve që kanë emigruar që pretendonin tokë, të cilën nuk e kanë më në pronësi apo në përdorim. Në total, projekti do të përmbytë 13,6 hektarë tokë bujqësore, shumica e së cilës përdoret për grurë dhe foragjere.

### 3.3.2 HEC-i Kokël

- **Kullollas**

Me nivelet e larta të migrimit nga ky fshat (me njerëz që kthehen me sezone për të mbledhur të korrat), ndikimet e projektit në banorët e përhershëm janë të ulëta, me vetëm 1 FPP të identifikuar deri më tani.

- **Bratilë**

Informacionet tregojnë se në këtë fshat ndodhen 10 banesa të banuara dhe 34 të tjera bosh dhe 19 struktura të braktisura. Në këtë fshat janë identifikuar 18 familje që mund të preken nga projekti, por niveli i ndikimit të tyre (bujqësor dhe strukturor) do të përcaktohet më vonë.

- **Kokël**

Me rreth 65 banorë dhe 15 struktura të banuara, deri më tani nuk është identifikuar asnjë familje që mund të preket nga projekti.

### 3.3.3 HEC-i Moglicë

- **Peshtan**

Me afërsisht 37 banorë të mbetur, fshati është përballur me një shpopullim të lartë gjatë 20 viteve të fundit për shkak të aksesit të ulët në shërbimet sociale dhe rënies së përgjithshme ekonomike.

- **Kodras**

VNMS-ja i ka përshkruar këta 54 banorë si grup i marginalizuar dhe vulnerabël. Ata që kanë pasur mundësi ekonomike për t'u shpërngulur në zona më urbane, e kanë bërë këtë gjë në fund të periudhës së komunizmit, duke lënë në fshat vetëm segmentin më të varfër të popullsisë.

- **Osojë**

Me 25 banorë, shumica e popullsisë së këtij fshati ka emigruar në Tiranë, Korçë, Durrës në fund të periudhës së komunizmit.

- **Lumaj**

Lumaj ka rreth 60 banorë me 12 banesa të banuara. Bazuar në vlerësimet fillestare, ky fshat do të duhet të zhvendoset për shkak të rritjes së nivelit të rezervuarit të hidrocentralit të Moglicës. Diskutimet paraprake me fshatarët kanë treguar dëshirën e tyre për t'u shpërngulur në Korçë, ku ata kanë të afërm dhe lidhje më të ngushta familjare.

- **Gjinikas**

Me rreth 6 banorë të përhershëm, shumica e popullsisë ka emigruar në Greqi, Korçë, Tiranë dhe Vlorë. Gjatë muajve të verës kthehen banorë sezonalë për të mbledhur të korrat.

- **Nikollarë**

Ky fshat ka 21 banorë të përhershëm. Bazuar në studimet fillestare, ky është një fshat i identifikuar për t'u zhvendosur dhe banorët kanë treguar dëshirën për t'u kthyer në pjesën e sipërme (Nikollarë e Sipërme).

- **Gurshqipe (Popçisht)**

Ky fshat ka afërsisht 30 banesa me 70 familje. Studimet kanë treguar se banorët kanë akses në energji elektrike, televizion satelitor dhe sisteme vaditjeje që funksionojnë.

- **Maliq-Opar**

Niveli i ulët i popullsisë në këtë fshat (17 banorë) është për shkak të mungesës së aksesit në shërbimet sociale dhe shumica është zhvendosur në zona më të mëdha urbane.

- **Moglicë**

Numri më i lartë i popullsisë që do të ndikohet nga hidrocentrali i Moglicës gjendet në fshatin Moglicë, i cili ka 450 banorë. Ndërkohë që shumica ka emigruar, në popullsinë që mbetet janë ata që nuk mund të përballonin shpërnguljen, banorët më pak të kualifikuar dhe përgjithësisht vulnerabël.

### 3.4 Arsyetimi dhe qasja

Është e rëndësishme që të bëhet dallimi ndërmjet aktiviteteve të ndryshme që do të kryhen në zbatim

të programit të DHP-së për risistemimin, përfshirë zhvendosjen fizike të shtëpive dhe strukturave të tjera (në një zonë tjetër), kompensimin për humbjen e materialeve, punës dhe prodhimit, dhe rehabilitimit të mjeteve të jetesës në mënyrë që njerëzit që preken ndjeshëm të përfitojnë prej tij. "Ndjeshëm" përkufizohet si FPP-të që humbin shtëpitë e tyre dhe/ose një pjesë të konsiderueshme të mjeteve të jetesës dhe që duhet të transferohen në një vend tjetër për shkak të ndikimeve nga projekti.

Përparësi do t'i jepet strategjive të bazuara te toka për ato FPP mjetet e jetesës së të cilave bazohen te toka. Këto strategji mund të përfshijnë përdorimin e tokës publike ose tokës private të marrë ose të blerë nga projekti. Sa herë që ofrohet tokë zëvendësuese, FPP-ve u ofrohet tokë për të cilën kombinimi i kapacitetit prodhues me avantazhet e vendndodhjes dhe faktorët e tjerë do të jetë të paktën i barasvlerëshëm me avantazhet e tokës që u është marrë. Nëse toka nuk është zgjidhja e preferuar për FPP-në, ose nuk disponohet tokë e mjaftueshme me çmim të arsyeshëm, do të ofrohen zgjidhje që nuk bazohen te toka për mundësitë për punësim ose vetëpunësim.

Për të trajtuar ndikimet e mbuluara, kuadri i politikës së risistemimit përfshin masat për të siguruar që FPP-të (i) të informohen për opsionet dhe të drejtat e tyre; (ii) të konsultohen, t'u ofrohen mundësi zgjedhjeje dhe t'u ofrohen alternativa teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshme; dhe që (iii) t'u ofrohet mbështetje e menjëhershme dhe efektive për zëvendësimin e plotë të vlerës së humbjeve të aseteve që i atribuohen drejtpërdrejt projektit.

Fshati	Inventar i Aseteve	~ FPP	Aktivitete Konsultimi të Risistemimit					Kohëzgjatja e Inventarit				
			Prezantim i përgjithshëm i inventarit dhe Programit të Risistemimit të DHP-së	Rezultatet e Inventarit dhe Skema e Përfitimeve	Konsultim në nivel fshati për Programin e Risistemimit	Konsultime Individuale me Familjet (KIF)	FPP me KIF deri më tani	% e totalit të FPP-ve	Fillimi	Përfundimi	Dite pune neto	
Shtepanj	13	13	-	-	01/08/2013	Vazhdon	12	92%	14/06/2012	13/11/2012	109	
Shushicë e Vogël	54	47	22/05/2012	-	02/05/2013	Vazhdon	45	96%	22/05/2012	16/08/2012	63	
Qyteti Gramsh	22	14	-	12/10/2012				0%	31/03/2012	25/09/2012	127	
Qafe (Banjë Vjetër)	39	32	-	-	23/08/2013	Vazhdon	27	84%	19/07/2012	06/12/2012	101	
Cekin	24	17	09/01/2012	08/08/2012				0%	11/01/2012	01/02/2012	16	
Ceruja	42	32	23/02/2012	14/08/2012				0%	27/02/2012	16/08/2012	124	
Drize	13	80	-	-				0%	24/10/2012	12/11/2012	14	
Gjergjovinë	25	13	09/03/2012	15/08/2012				0%	12/03/2012	02/04/2012	16	
Pishaj	17	7	25/01/2012	26/07/2012				0%	08/02/2012	29/02/2012	16	
Qerret	18	14	26/03/2012	09/08/2012				0%	03/04/2012	15/08/2012	97	
Cingar	40	25	19/03/2012	16/08/2012				0%	17/03/2012	24/10/2012	158	
Trashovicë	18	18	24/01/2012	02/08/2012				0%	26/01/2012	27/02/2012	23	
Dushk (Silare)	23	17	11/04/2012	24/08/2012				0%	12/04/2012	19/04/2012	6	
Zgjuhë Kodër	15	9	20/04/2012	23/08/2012				0%	23/04/2012	10/05/2012	14	
Mazrek	18	18	06/04/2012	21/08/2012	03/06/2013	Vazhdon	18	100%	10.04.2012	12.04.2012	2	
Zgjuhë Fushe	13	6	17/04/2012	22/08/2012				0%	18/04/2012	20/04/2012	3	
Blerimas	7	2	24/04/2012	29/08/2012	02/10/2013			0%	27/04/2012	30/04/2012	2	
Kaçivel	11	8	24/04/2012	11/09/2012	02/10/2013			0%	25/04/2012	02/05/2012	6	
Shinavlash	34	17	26/04/2012	26/09/2012	01/10/2013	Vazhdon	7	41%	30/04/2012	08/05/2012	7	
	<b>446</b>	<b>389</b>					<b>109</b>	<b>22%</b>				

Tabela 4: Detajet mbi aktivitetet e konsultimit për risistemimin (fshat dhe familje)

Gjatë procesit të risistemimit do të përfshihen edhe disa qasje të caktuara, të cilat nxisin pjesëmarrjen aktive të grave në aktivitete që variojnë nga konsultimi te monitorimi, përfaqësimi i grave në takime dhe komitete (kur është e përshtatshme), dhe ngritjen e kapaciteteve dhe programet e trajnimit që përfshijnë gratë. Ndërkohë që çështjet gjinore nuk janë identifikuar në mënyrë specifike si fushë që kërkon fokus të veçantë, do të kryhet monitorim për pjesëmarrjen me bazë gjinore.

### **3.5 Kuadri organizativ me grupe të ndryshme interesi**

Procesi i risistemimit i mbështetjes me mjetet e jetesës nuk është proces që mund të funksionojë i izoluar, dhe as nuk mund të funksionojë pa një sistem përgjegjësish të përcaktuara dhe linja të qarta koordinimi, dhe si i tillë kërkon identifikimin e partnerëve kyçë përpara punëve të mëtejshme në terren. Diçka e rëndësishme që duhet konsideruar janë grupet e interesit të përfshira në proces. Duhet të përcaktohet një kuadër i qartë organizativ, mundësisht nëpërmjet grupit institucional të punës (GIP), i cili është ngritur tashmë me anëtarë nga sektorë të ndryshëm të qeverisjes dhe të DHP-së. Këtu është me rëndësi të identifikohen përgjegjësitë për zbatimin e masave mbështetëse për risistemimin dhe mjetet e jetesës, si dhe për ofrimin e shërbimeve për FPP-të. Ky është një forum ideal për të koordinuar agjencitë e përfshira në zbatim, si dhe për të identifikuar mangësitë gjatë zbatimit. Përveç kësaj, përdorimi i GIP-së dhe përfshirja e njësisve të qeverisjes vendore siguron që ekziston një kompetencë e përcaktuar e qeverisë nëse kërkohet transferimi tek autoritetet vendore ose te vetë të zhvendosurit - në rastet kur kërkohen përgjegjësitë për menaxhimin e objekteve dhe shërbimeve - për të siguruar qëndrueshmëri.

### **3.6 Planifikimi dhe zbatimi**

#### **3.6.1 Informacioni demografik**

Risistemimi duhet të minimizohet sa më shumë të jetë e mundur. Do të bëhen përpjekje për të ndihmuar FPP-të që të zhvendosen në toka të disponueshme në të njëjtin fshat, ose kur kjo nuk është e mundur, te një komunitet pritës, i cili është i gatshëm/ka vullnetin të pranojë të zhvendosurin(t). Në disa zona, gjetja e opsioneve të disponueshme për zhvendosje brenda kufijve të të njëjtit fshat është zgjidhja e preferuar për FPP-të dhe për projektin.

Bazuar në informacionet që kemi, ekziston një vlerësim fillestar i shtëpive të mundshme dhe i pronave të paluajtshme që DHP-ja ka parashikuar si të caktuara për zhvendosjen e treguar në tabelat e mëposhtme:



Nr.	Komuna	Fshati	TOTAL FPP	Humbje e banesës	Humbje e struktura ve të tjera	Nr.	Komuna	Fshati	Nr. i familjeve të identifikuar	Humbje e banesës	Humbje e strukturave të tjera
1	Gostimë	Shtepanj	15		5	1	Kodovjat	Kokel			
2		Shushicë e Vogel	52		1	2		Bratila	18		
3	Qyteti Gramsh		13	1	19	3	Skenderbegas	Kullollas	1		
4	Klos	Qafe (Banjë e Vjetër)	32	3	3	<b>Total Kokel</b>					
5	Pishaj	Çekin	22		3						
6		Cërujë	41	1	2	1	Moglicë	Dobërçan	26		
7		Drizë	85	12	43	2		Gurshqipe	21		
8		Gjergjovinë	24			3		Maliq Opar	1		
9		Pishaj	22		1	4		Lumaj	57	12	100
10		Qerret	16	6	36	5		Moglicë	6		
11		Cingar	38	2	7	6		Nikollarë	31	6	50
12		Trashovice	18			7		Osojë	13		
13	Sult	Dushk (Silare)	23	1	7	8		Peshtan	3		
14		Zgjurë Koder	14			9		Gjinikas	4		
15		Mazrek	18		2	10		Kodras	14	13	40
16		Zgjurë Fushë	13			11	Lekas	Poponive	5		
17	Tregan	Blerimas	7			<b>Total Moglicë</b>			181	31	190
18		Kaçivel	11			<b>Total Zona e Projektit</b>			698	208	312
19		Shinavlash	34								
<b>TOTAL Banjë</b>			<b>498</b>	<b>26</b>	<b>129</b>						

Tabela 5: Detajet për banesat që mund të preken

SHËNIM: Zërat me të KUQE janë parashikime

Duke parë inventarin e aseteve që është kryer për ndikimet nga hidrocentrali i Banjës, ekzistojnë më tepër detaje për strukturat që kërkohen të zëvendësohen në këtë zonë. Detajet tregohen në tabelën e mëposhtme.

Fshati	Kasolle Kafshësh	Bar/Restaurant	Zdruktëtarë / Punishite / Oficinë	Kasolle / Kotec	Gardh	Garazh	Hambar	Varr	Serrë	Kuzhine e Jashtme	Çezmë e jashtme	Tualet i jashtëm / Tualet	Kasolle	Pleviçe, Stalle / Depo	Depo / Magazine	Strukturë e ujit të pishëm	Tubacione të ujit të pishëm	Pompë e ujit të pishëm	Pus	Ndërtesë tjetër	Total
<b>Banja Reservoir Area</b>																					
Shtepanj					1								1	2					1		5
Shushicë e Vogel					1																1
Gramsh Town	3	1	5			1		3			2		2			1	1				19
Qafe (Banjë e Vjeter)														1						2	3
Çekin	1													2							3
Cërujë		1														1					2
Drizë																					43
Pishaj									1												1
Qerret	5			12		1			4	1	1	5	1	3		1			1	1	36
Cingar	1		1									1		4							7
Dushk (Silare)	1				2			1				1		2							7
Mazrek				1										1							2
<b>Total Banja</b>	<b>11</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>18</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>8</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>9</b>	<b>2</b>	<b>15</b>	<b>2</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>129</b>
<b>Moglicë Reservoir Area</b>																					
Lumaj																					100
Nikollarë																					50
Kodras																					40
<b>Total Moglicë</b>																					<b>190</b>
<b>Total</b>		<b>1</b>	<b>2</b>	<b>18</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>8</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>9</b>	<b>2</b>	<b>15</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>193</b>	<b>319</b>

Tabela 6: Lista e strukturve dhe ndërtesave të tjera në asetet e tokave të FPP-ve (të vlerësuara deri më sot).

SHËNIM: Zërat për fshatin Drizë (hidrocentrali i Banjës) për të gjitha zonat e hidrocentralit Moglicë janë parashikime

Për ndikimet e hidrocentralit të Banjës, numri i kufizuar i rasteve ndihmon në kërkesat për zhvendosje, meqë këto të fundit janë të kufizuara vetëm me 1 ose 2 për fshat (me përjashtim të fshatit Qerret, i cili ka 6 kërkesa dhe Drizë, për të cilin nuk është bërë një inventar deri më sot dhe kemi vetëm parashikime). Idealja do të ishte të gjenden vende brenda territorit aktual të fshatit për të minimizuar çështjet e tjera sociale gjatë risistemimit, si p.sh. pranimit të komuniteteve të reja/pritëse.

Rastet e fshatrave në zonën e Moglicës janë shumë më të ndërlikuara, sepse aty do të nevojiten hapësira më të mëdha risistemimi. Këtu, hapi i pari në identifikimin e zonave të mundshme të risistemimit është përkufizimi i kriterëve të caktuara që mundësojnë zhvillimin e opsioneve të mjeteve të jetesës për FPP-të duke u vënë në dispozicion toka të përshtatshme.

### 3.6.2 Mjetet e jetesës dhe burimet e të ardhurave

Burimet kryesore të të ardhurave mund të ndahen në 3 kategori kryesore, dërgesat nga emigrantët me 20% të të ardhurave totale, bujqësia me 33% dhe burime të tjera, si bizneset dhe punësimi me 47%.

Rrethi i Gramshit ka një popullsi rreth 40 000 banorë, nga të cilët rreth 14 000 jetojnë në qytet dhe pjesa tjetër e popullsisë jeton në fshatrat përreth. Ekonomia është e bazuar te bujqësia, blegtoaria, tregtia dhe shërbimet. Niveli i punësimit është i ulët dhe një numër i madh familjesh jetojnë me të ardhurat që u dërgojnë të afërmit që kanë jashtë vendit. Përveç një punishteje për përpunimin e drurit, aktualisht në rajon ka pak industri operative.

Bujqësia ka qenë tradicionalisht shtylla e ekonomisë lokale duke kontribuar me një të tretat e të ardhurave në Familjet e Prekura nga Projekti. Ndërsa pjesa dërrmuese e popullsisë është e angazhuar në veprimtari bujqësore duke mbjellë drithëra, duhan, pemë frutore dhe perime, përgjithësisht këto kufizohem me veprimtari të vogla familjare dhe bujqësi që siguron jetesën për konsum familjar. Bazuar në diskutimet me FPP-të, kjo vjen si shkak i mungesës së sistemeve funksionale të vaditjes, kostove të larta të prodhimit, mungesës së teknologjive të reja (pajisjet dhe makineritë bujqësore, praktikat bujqësore etj.), të drejtat jo të qarta të pronësisë dhe kapacitetet e ulëta të prodhimit të tokës në zonën e projektit, duke u shtuar këtyre aksesin e kufizuar në tregjet e jashtme dhe fabrikat e prodhimit.

Në të njëjtën kohë, dërgesat nga emigrantët kanë kontribuar gjithashtu në mbrojtjen e ekonomisë lokale (në përgjithësi) nga rënia globale e ekonomisë për shkak të numrit të madh të emigrantëve në Greqi dhe Itali. Bazuar në informacionet e mbledhura gjatë fazës së inventarizimit dhe të regjistrimit, rreth një e treta e të ardhurave të familjeve i atribuohen këtij burimi. Ndërkohë që kjo ka një ndikim pozitiv në standardet e jetesës duke ofruar mbështetje për nevojat e konsumit ditor, ajo ka kontribuar gjithashtu në dekurajimin e individëve për të marrë pjesë në tregjet e punës, duke shkaktuar një varësi nga ky burim të ardhurash. Me uljen e tendencës aktuale në punësimin e disponueshëm jashtë, kjo priret mund të ndryshojë me kthimin e emigrantëve nga jashtë vendit për shkak të rënies drastike të kushteve ekonomike në Greqi dhe Itali, të cilat janë destinacioni parësor i punëtorëve shqiptarë jashtë vendit.

Pjesa që mbetet nga tërësia e të ardhurave është e përzier dhe një kombinim i veprimtarive të tjera që gjenerojnë të ardhura, si punësimi dhe bizneset e vogla. Shumica e të punësuarve në Gramsh punojnë në sektorin shtetëror si mësues, punonjës shëndetësie dhe në administratat vendore. Megjithatë, së fundmi, disa nga institucionet administrative vendore, si zyra kryesore e taksave, gjykatat dhe zyrat e arkivave të zonës, janë shpërngulur në Elbasan. Duke qenë se rrogat në sektorin publik janë minimale dhe jo të sigurta, punëtorët e sektorit publik bëjnë punë të ndryshme dhe të ardhurat nga bizneset familjare, si parukeritë, pastrimi kimik ose rrobaqepësitë mbështesin të ardhurat familjare (VNMS 2011).

Bazuar në informacionet e marra nga studimet bazë, tabela e mëposhtme na tregon burimet kyçe të mjeteve të jetesës

Nr.	Fshati	Burimet kyçe të mjeteve të jetesës				
		Bujqësia (Hortikultura dhe blegtoria)	Punësimi / aftësitë	Përdorimi i burimeve natyrore	Bizneset	
<b>HEC-i Banjë</b>						
1	Shushicë e Vogël	Vreshta, ullishte, pemë frutore, grurë	Po (përfshirë bletët)	Shoferë, elektrikistë, saldatorë, hidraulikë. Shumica e banorëve janë të papunë dhe nuk zotërojnë prona për shkak të çështjeve të trashëgimisë		Dyqan, Bar dhe internet kafe
2	Qafë (Banjë e Vjetër)	Pemë frutore, grurë, korra e foragjereve	Po			
3	Cërujë	Vreshta, misër, pemë frutore, sera për perime (domate etj.) prodhimi i rakisë dhe verës	Bletë Tokë kullosore afër lumit	Punëtorë të kualifikuar në fshat janë shoferët, ndërtuesit dhe saldatorët	Peshkimi në lumin e Devollit dhe Holtës, dru zjarri, prerje-transportim trupash, kullotja Gjuetia Mbledhja e barnave mjekësore	Dyqan, Bar, restorant dhe internet kafe
4	Drizë	Vreshta, misër, pemë frutore, serra për perime	Qumësht Kullotja e kafshëve në bregun në të majtë të lumit Devoll Bletë	Rreth 5-20% e banorëve të përhershëm meshkuj të fshatit Drizë janë të kualifikuar për ndërtim	Produkte pyjore, mbledhja e barnave mjekësore, gjuetia (lepujt)	Dyqan, Bar
5	Qerret	Vreshta, pemë frutore, fiq, ullishte	Po	Punëtorë të kualifikuar në fshat janë saldatorët, shoferët, punëtorët e përgjithshëm dhe ndërtuesit e kualifikuar	Peshkimi në lumin Devoll, mbledhja e druve të zjarrit, gjuetia (lepujt)	Bar

Nr.	Fshati	Burimet kyçe të mjeteve të jetesës				
		Bujqësia (Hortikultura dhe blegtoria)	Punësimi / aftësitë	Përdorimi i burimeve natyrore	Bizneset	
6	Cingar i Poshtëm	Vreshta Bimë nga bahçja (speca, domate etj.)	Dele, lopë dhe dhi Bletë	Punëtorët e kualifikuar në fshat janë shoferët, drejtuesit e makinerive të rënda, punëtorët e ndërtimit	Mbledhja e barnave mjekësore, gjuetia (lepujt)	
7	Dushk (Silare)	Ullishte, vreshta, misër, pemë frutore, bimë nga bahçja (speca, domate etj.)	Po. Kullotja e bagëtive bëhet zakonisht në pjerrina.	Disa fshatarë nga Dushku punojnë në Gramsh	Peshkimi në lumin Devoll	
8	Zgjupë Fushë	Ullishte, vreshta, misër, pemë frutore, bimë nga bahçja (speca, domate etj.)	Po.	Punësimi në Gramsh	Peshkim (lumi Devoll), mbledhja e barnave mjekësore, gjuetia (lepuj dhe rosa)	
<b>HEC-i Kokël</b>						
1	Kokël	Pemë frutore bimë nga bahçja (perime)	Dele, dhi dhe lopë Bletë Foragjere (tërshërë, misër dhe grurë)	Kualifikime të përgjithshme për punë		Rritje shpendësh
2	Bratilë	Vreshta dhe pemë frutore, bimë nga bahçja (perime)	Dhi Bletë Foragjere (tërshërë)			Dyqan, Bar

Nr.	Fshati	Burimet kyçe të mjeteve të jetesës			
		Bujqësia (Hortikultura dhe blegtoria)	Punësimi / aftësitë	Përdorimi i burimeve natyrore	Bizneset
3	Kullollas	Pemë frutore bimë nga bahçja	Dele dhe lopë (qumësht) Bletë Foragjere (tërshërë, misër dhe grurë)		
<b>HEC-i Moglicë</b>					
1	Gurshqipe (Popçisht)	Foragjere, misër, grurë, perime, vreshta dhe pemë frutore	Dele, dhi dhe lopë Bletë Foragjere (fushat me tërfil, jonxhë dhe pemë lisi)	Shoferë dhe elektrikistë	Mbledhja e druve të zjarrit, mbledhja e barnave mjekësore, gjuetia (lepuij dhe zogj)
2	Maliq-Opar	Mollë, kumbulla dhe panxhar sheqeri	Dele, dhi dhe lopë Bletë Foragjere	Aftësi ndërtimi	Mbledhja e druve të zjarrit, mbledhja e barnave mjekësore
3	Lumaj	Bujqësi familjare, misër	Dele, dhi dhe lopë Bletë Foragjere		Mbledhja e druve të zjarrit, mbledhja e barnave mjekësore, gjuetia (lepuij, zogj dhe derra të egër)
4	Moglicë	Misër, pemë frutore, drithëra	Dele, dhi dhe lopë Bletë Foragjere	Shoferë	

Nr.	Fshati	Burimet kyçe të mjeteve të jetesës			
		Bujqësia (Hortikultura dhe blegtoia)	Punësimi / aftësitë	Përdorimi i burimeve natyrore	Bizneset
5	Nikollarë	Pemë fiku, kumbulle, ftoi, arre dhe pjeshke vreshta rrushi Bimë nga bahçja (perime)	Dhi dhe lopë Bletë	Shoferë, druvarë dhe punëtorë të përgjithshëm	Mbledhja e druve të zjarrit, mbledhja e barnave mjekësore
6	Osojë	Foragjere, misër, fasule, perime, rrush	Lopë, bletë	Shoferë, punonjësit e komunës Moglicë	Mbledhja e druve të zjarrit, mbledhja e barnave mjekësore, gjuetia (lepuj, zogj, drerë dhe derra të egër)
7	Peshtan	Vreshta, foragjere, pemë frutore, bimë nga bahçja (perime), raki kumbulle, verë dhe musht kumbulle	Bletë	Elektricitë, veterinerë, punëtorë të përgjithshëm	Mbledhja e druve të zjarrit, mbledhja e barnave mjekësore, gjuetia (lepuj, zogj dhe drerë)
8	Gjinikas	Foragjere, misër, fasule, bimë nga bahçja (perime)	Lopë, dele dhe dhi Bletë	Asnjë kualifikim i veçantë në fshat	Mbledhja e druve të zjarrit, mbledhja e barnave mjekësore, gjuetia (lepuj dhe zogj)
9	Kodras	Bujqësi familjare	Lopë, dele dhe dhi Bletë		Mbledhja e barnave mjekësore

Tabela 7: Burimet e përgjithshme të mjeteve të jetesës në disa nga fshatrat e përzgjedhur që preken nga projekti

Më poshtë jepet një tabelë që tregon ndarjen mesatare dhe burimet e të ardhurave për shumicën e fshatrave që preken nga HEC-i Banjë bazuar në informacionet në dispozicion deri më tani.

Nr.	Fshati	Bujqësia	% e të ardhurave	Burimet natyrore	% e të ardhurave	Burime të tjera	% e të ardhurave	Remitanca	% e të ardhurave	Te ardhura totale	% e humbjes se tokes se regjistruar per fshat
1	Shtepanje										
2	Shushice e Vogel										
3	Gramsh Town	117.846	17%	4.308	0%	566.431	81%	7.692	1%	696.277	41%
4	Qafe										
5	Cekin	173.118	29%	1.364	0%	215.682	36%	206.455	35%	596.618	34%
6	Ceruje	183.832	31%	7.757	1%	353.784	59%	49.568	8%	594.941	31%
7	Drize										
8	Gjergovine	88.801	20%	4.479	1%	288.675	67%	51.771	12%	433.726	15%
9	Pishaj	45.782	8%	2.818	0%	437.305	83%	56.225	9%	522.252	40%
10	Qerret	369.431	23%	10.538	1%	230.646	14%	986.692	62%	1.597.308	8%
11	Cingar	158.004	34%	9.706	2%	159.365	35%	133.279	29%	460.354	45%
12	Trashovice	141.511	32%	-	0%	256.533	57%	50.000	11%	448.044	27%
13	Dushk (Silare)	182.496	30%	7.167	1%	214.500	35%	212.917	35%	617.079	43%
14	Zgjupe Koder	226.875	48%	4.000	1%	201.383	43%	39.167	8%	470.592	22%
15	Mazrek	368.441	59%	1.471	0%	154.871	25%	100.000	16%	624.782	58%
16	Zgjupe Fushe	35.190	14%	-	0%	186.720	72%	42.500	16%	258.910	20%
17	Blerimas	652.680	50%	-	0%	141.360	22%	500.000	39%	1.294.040	15%
18	Kacivel	555.400	78%	52.300	7%	96.760	14%	5.000	1%	709.460	55%
19	Shinavlash	90.638	19%	265	0%	294.541	61%	100.000	21%	485.444	22%
<b>Average Banja</b>		<b>226.003</b>	<b>33%</b>	<b>7.078</b>	<b>1%</b>	<b>253.237</b>	<b>47%</b>	<b>169.418</b>	<b>20%</b>	<b>653.988</b>	<b>32%</b>

Tabela 8: Burimet e të ardhurave për zonat e HEC-it Banjë bazuar në informacionet e regjistrimit të asetëve

Tendencat indikative të ofruara nga VNMS për fshatrat që do të ndikohen nga projekti, të ndara sipas sektorëve.

Sektori	Cingar	Drizë	Cërujë	Qerret	Dushk (Silare)	Kodovjat	Bratilë	Kokël
Bujqësia	5%	22%	42%	12%	0%	45%	46%	100%
Puna me pagë në bujqësi	16%		7%	28%	12%	6%	8%	
Qiraja			2%			2%		
Mbarëshkrimi i kafshëve		11%	7%	4%	15%	10%	7%	
Pyllëzimin		3%	9%			6%		



Punonjës civil / pensionet e pleqërisë nga	53%	28%	2%	36%	35%	17%	13%	
Dërgesat emigrantët	21%	33%	31%	20%	38%	14%	6%	
Të tjera	5%	3%					20%	
<b>Totali</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

**Tabela 9: Varësia/burimet e të ardhurave në fshatrat e përzgjedhur të HEC-it Banjë**

Ndarje të ngjashme të të dhënave mund të gjenden edhe për fshatrat që preken nga HEC-i Kokël dhe Moglicë, detajet jepet më poshtë.

Fshati	Bujqësia	Qiraja	Mbarëshiti mi i kafshëve	Tregti / artizan	Punonjës civil / pensionet e pleqërisë	Dërgesat nga emigrantët	Të tjera
Moglicë	65%	4%			3%		
Nikollarë		4%			2%	6%	32%
Lumaj	5%	4%	100%	100%	21%		
<b>Totali</b>	<b>70%</b>	<b>12%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>26%</b>	<b>6%</b>	<b>32%</b>

**Tabela 10: Varësia/burimet e të ardhurave në fshatrat e përzgjedhur të HEC-it Kokël dhe Moglicë**

### 3.6.3 Përzgjedhja e vendit të risistemimit dhe zhvillimi i infrastrukturës

Në ato raste risistemimi që do të bëhen në zona të ndryshme, vendndodhjet e reja duhet të përmbushin kriteret minimale të mëposhtme:

- Toka përreth duhet të jetë e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë (dheu, topografia, disponueshmëria e ujit etj.). Ky kusht duhet të marrë në konsideratë disponueshmërinë e mëparshme të tokës bujqësore në vendndodhjen fillestare të personave të risistemuar, me qëllim ofrimin e kushteve të njëjta ose më të mira.
- Zona duhet të ketë akses në rrugë gjatë gjithë vitit
- Të ketë furnizim me ujë të pijshëm gjatë gjithë vitit
- Të ketë akses në shërbime.

I njëjti parim do të ndiqet për zhvendosjen e pronave të bizneseve private që preken. Kjo do të bëhet duke ndjekur konceptin e zëvendësimit të plotë përveç një ndihme shtesë të dhënë nga DHP-ja gjatë tranzicionit nga një vendndodhje e biznesit në një tjetër. Për momentin janë identifikuar 2 struktura të kësaj natyre, një bar/restorant në Cërujë dhe një zdrukthëtari në qytetin e Gramshit.

Deri më tani janë 14 banesa (të parashikuara deri në 26) dhe 86 (maksimumi ~130) struktura që janë regjistruar në inventarët e asetëve të bëra për ndikimin e HEC-it Banjë dhe deri në ~220 për HEC-et Kokël dhe Moglicë. Ndërkohë që nuk ka ndryshime në përlogaritjen e kostove të zëvendësimit për secilën nga strukturat e identifikuar, duhet bërë një dallim i nevojshëm për mënyrën sesi do të zbatohen këto.

Një faktor tjetër që duhet marrë në konsideratë gjatë zhvendosjes së FPP-ve është toka e mbetur bujqësore nga e cila mund të merret prodhim bujqësor. Në disa raste, zhvendosja për shkak të niveleve të larta të humbjes së tokës bujqësore mund të konsiderohet kur nuk ka tokë tjetër të disponueshme brenda territorit të fshatit.

Strategjia e përgjithshme ka qenë kërkimi i ndihmës nga qeveria shqiptare për identifikimin e zonave të mundshme për risistemim, të cilat (pasi të verifikohen kriteret e përcaktuara më lart) mund t'i propozohen e më pas të diskutohen në detaje me ata që do të risistemohen. Në kohën e hartimit të këtij dokumenti, janë kryer vetëm diskutime paraprake nëpërmjet grupit institucional të punës (GIP), por bashkëpunimi ka qenë pozitiv. Individët kanë propozuar vetëm informacione treguese, të cilat ende duhet të konfirmohen më tej. Është e rëndësishme që përveç kërkesave individuale, si qeveria shqiptare, ashtu edhe komuniteti në tërësi të jenë pjesëmarrës në proceset e vendimmarrjes. Mekanizmat për të siguruar këtë po ngrihen ende.

#### **Zhvendosja nga toka në pronësi (me dokumentacion të rregullt):**

Qëllimi është zhvillimi i një mekanizmi të pavarur dhe bashkërisht të pranueshëm për t'i vlerësuar këto struktura, për të krahasuar shumën për shpronësim dhe për të dhënë me para në dorë vlerën e mbetur për pronarin e regjistruar ose, sipas rastit, për të ofruar materialet ose infrastrukturën zëvendësuese. Siç përshkruhet më lart, vlerësimi do të bëhet mbi bazën e kostove aktuale të zëvendësimit, pa amortizim. Në rast se një FPP kërkon një infrastrukturë zëvendësuese (që të ndërtohet nga DHP-ja), FPP-ja duhet të japë shumën e plotë që i është dhënë për shpronësim, si kontribut për infrastrukturën zëvendësuese ose të sigurojë tokën mbi të cilën do të ndërtohet banesa zëvendësuese. Për detajet e sakta do të bihet dakord me secilën nga FPP-të.

**Zhvendosja nga toka në prodhim (pa dokumente):** Vlerësimi i strukturave dhe asetëve të tjera do të kryhet siç përmendet më lart. Megjithatë, kjo do të verifikohet dhe miratohet nga inxhinieri përkatës i miratuar nga DHP-ja. Ai do t'i përcillet qeverisjes vendore / inxhinierit të autorizuar / profesionistit të certifikuar për miratim.

#### **3.6.4 Vetë-zhvendosja dhe të larguarit**

Individëve ose grupeve mund t'u jepet edhe mundësia që të vendosin vetë si ta menaxhojnë zhvendosjen e tyre pa ndihmën e DHP-së për të ndërtuar banesat e tyre zëvendësuese. Ndërkohë që kjo nuk është një zgjidhje e preferuar, është sigurisht diçka që mund të merret në konsideratë me kusht që FPP-të të përmbushin disa kriteret të caktuara paraprakisht, të cilat, edhe pse nuk janë përfunduar, mund të sigurojnë një nivel më të lartë suksesi për zhvendosjen fizike të disa FPP-ve. Një kërkesë bazë do të ishte që ata të kenë qenë ish-pronarë të ligjshëm dhe FPP-ja të ketë mandat ligjor mbi zonën e propozuar për zhvendosje. DHP është e përkushtuar që të japë ndihmesën e saj sipas specifikimeve të skemës së përfitimeve.

Në rast se FPP-të preferojnë të largohen përgjithmonë nga zona e projektit, do t'u ofrohet një paketë për të larguarit, e cila do t'u jepej FPP-ve me kushtin që (1) pagesa për tokën (nëpërmjet shpronësimit) kërkon që të ketë pronësi të ligjshme (2) një zonë e treguar zhvendosjeje jashtë zonës së projektit (pra, një banesë në një qytet tjetër, etj.).

#### **3.6.5 Strukturat dhe projektet e shtëpive**

Projekti i strukturave zëvendësuese të banimit do të zhvillohet dhe do t'u paraqitet FPP-ve përfituese. Është propozuar që të përgatiten 3-4 projekte dhe sipërfaqet e ofruara do të jenë, në të gjitha rastet, më të mëdha se sipërfaqet në banesat ekzistuese, duke u dhënë FPP-ve përfitimet më të mëdha të

mundshme. Modelet/projektet aktualisht po përgatiten dhe do t'u paraqiten specialistëve të qeverisë shqiptare për miratim përpara konsultimeve me FPP-të.

### 3.7 Zhvillimi dhe mbështetja e mjeteve të jetesës (ZHMJ)

Përmbytja që do të shkaktohet nga rezervuarët e Banjës dhe Moglicës do të rezultojë në humbjen e një pjese të konsiderueshme të tokës që aktualisht përdoret nga fshatarët aty afër për bujqësi, kullotje bagëtiesh, si dhe për mbledhjen e materialeve pyjore dhe si zonë gjuetie. Si tregues i kësaj, vetëm në zonën e Banjës preken mbi 700 parcela toke në pronësi ose në përdorim, me ~400 FPP. Megjithatë, pritet që rezervuari të ofrojë një burim uji për vaditje në bujqësi, duke çuar kështu në rritjen e kapacitetit prodhues të tokës që mbetet. Aktualisht, rendimenti bujqësor është i kufizuar nga furnizimi i papërshtatshëm me ujë, fertiliteti i ulët i dheut dhe topografia, si dhe nga mungesa e kapitalit dhe kapaciteteve teknologjike. Banorët e fshatrave përreth tradicionalisht nuk janë varur nga një burim i vetëm të ardhurash për jetesën e tyre, duke kombinuar një bazë të përzier mjetesh jetese, përfshirë bujqësinë, blegtorinë, dërgesat nga emigrantët dhe në një shkallë më të ulët punësimin e paguar, ku një mesatare prej 30% vjen nga prodhimi bujqësor. Kështu, opsionet për rikuperimin e mjeteve të jetesës nuk do të kufizohen me zhvillimin bujqësor; do të merren në konsideratë edhe burime/aktivitete të tjera për krijimin e të ardhurave, me premisën që këto mund të jenë më të qëndrueshme.

Objekti i këtij planifikimi dhe i aktiviteteve të përfshira në program është sigurimi që FPP-të të jenë në gjendje ta ringrenë jetesën e tyre, të paktën në nivelet që kishin përpara projektit. Konsiderimi parësor është rikuperimi i të ardhurave/konsumit që zvogëlohet për shkak të humbjes së produktivitetit të aseteve që preken, gjë që mund të arrihet nëpërmjet prodhimit të të gjitha ose një pjese të humbjeve të tyre në tokat që mbeten duke rritur potencialin e tyre prodhues. Veprimtaritë për rikuperimin e mjeteve të jetesës synojnë kryesisht t'i ndihmojnë FPP-të që të rikuperojnë kushte të sigurta jetese që krahasohen ose janë më të mira se kushtet përpara projektit. Pagesat e kompensimit në natyrë për asetet e humbura dhe prodhimin mund të balancojnë humbjet, por veprimtaritë për rikuperimin e mjeteve të jetesës ofrojnë mundësi të reja duke i mundësuar FPP-ve të rrisin të ardhurat dhe standardet e jetesës.

Gjatë identifikimit të zgjidhjeve ZHMJ (për të ndihmuar FPP-të të zgjedhin mundësitë), do të konsiderohen edhe faktorët e mëposhtëm:

- a) Niveli arsimor dhe i kualifikimit të FPP-ve;
- b) Veprimtaritë e mundshme ekonomike në periudhën pas projektit;
- c) Sipërfaqja e tokës që mbetet;
- d) Përshtatshmëria e aktivitetit ekonomik për të plotësuar të ardhurat;
- e) Potenciali i tregut dhe mjediset për tregtim.

Programi ZHMJ shikohet si partneritet. Ofrimi i mallrave/shërbimeve nga DHP-ja do të lidhet me veprimtaritë/kontributet homologe specifike nga FPP-të. Kjo do të ndihmojë në dhënien e pronësisë së vërtetë dhe përfshirjen e FPP-ve, si dhe në minimizimin e varësisë nga projekti. Në propozimin e strategjive të mjeteve të jetesës, është e rëndësishme të vihet në dukje se përvojat e mëparshme dhe faktorë të tjerë socialë dhe kulturorë mund të ndikojnë në mënyrën sesi një FPP do të përfitojë nga mundësitë që i ofrohen; këto shkojnë përtej fushës së përgjegjësisë së DHP-së. Opsionet e mjeteve të jetesës që do të rekomandohen do të bazohen në ato që janë praktikuar në kushte të ngjashme në Shqipëri, dhe brenda kompetencës së FPP-ve për të siguruar që në fund ato të dalin sa më të fituara. Risitë dhe teknologjitë e reja që janë prezantuar do të vlerësohen nga eksperti i bujqësisë dhe zbatimi

do të mbikëqyret nga afër nga njësia e mbështetjes bujqësore.

### **3.7.1 Zhvillimi dhe nxitja e bujqësisë**

Humbja e aseteve të tokës bujqësore dhe aftësia për të zhvilluar sisteme prodhimi alternative të qëndrueshme për të zëvendësuar humbjet është sfida parësore me të cilën përballlet programi. Ndërkohë që deri më tani janë marrë në konsideratë disa opsione për paketat bujqësore të jetesës, këto duhet të përpunohen më tej për të trajtuar situatën reale (cilësinë e dheut, disponueshmërinë e ujit, tregjet aktuale, etj.). Përveç kësaj, duhet të ngrihen shërbimet mbështetëse, si marketingu, financimi, impiantet përpunuese që të kuptohen më mirë mundësitë potenciale të tregut për produkte të suksesshme (nga lugina e Devollit), si dhe të lidhen prodhuesit me tregjet.

Ndërkohë që partneri kryesor në zhvillimin e bujqësisë (opsionet) do të ishin vetë FPP-të, agjencitë e linjës së drejtorisë së bujqësisë në komuna do të ishin homologët idealë, si për të ofruar mbështetje shtesë dhe asistencë teknike, ashtu edhe për të përfituar nga projekti për ngritjen e kapaciteteve shtesë. Në këtë mënyrë, veprimtaritë në terren do të përkonin me strategjinë kombëtare për zhvillimin e bujqësisë dhe do të siguronin miratimin në të ardhmen të programeve të nisura nga DHP-ja.

#### **3.7.1.1 Planet e përdorimit të tokës dhe siguria e pronësisë mbi tokën**

Me qëllim njohjen më të mirë të përdorimit aktual dhe të ardhshëm të sipërfaqeve të tokës brenda zonës së projektit hapi i parë është zhvillimi i një plani për përdorimin e tokës me qëllim identifikimin e sipërfaqeve të tokës bujqësore dhe rezidenciale që mund të ruhen dhe të zhvillohen për projektin. Ky informacion, ndërkohë që është përgjegjësi e qeverisë shqiptare nëpërmjet agjencive të linjës, do të ndihmojë në ngritjen e iniciativave për mbështetjen e mjeteve të jetesës në sipërfaqet e tokës që janë garantuar për përdorimin nga FPP-të dhe në këtë mënyrë do të ndihmojë në qëndrueshmërinë e kësaj përpjekjeje.

Një nga detyrat kryesore të kryera gjatë konsultimeve me familjet individuale do të ishte identifikimi i sigurisë së tokës/shfrytëzimit për FPP-të dhe i opsionit që ata kanë zgjedhur për të mbështetur jetesën. Kjo do të kryhet në bashkëpunim me FPP-të dhe me qeverinë shqiptare për të ndihmuar në identifikimin dhe sigurimin e tokës së përshtatshme bujqësore që është e disponueshme brenda kufijve të fshatit.

Më poshtë paraqitet një hartë treguese e përdorimit të tokës e përgatitur për të ndihmuar në kuptimin e përdorimit aktual të tokës në zonat e projektit.




Figura 5: Harta e përdorimit të tokës në HEC-in e Banjës

Më poshtë paraqitet një hartë treguese e përdorimit aktual dhe e përdorimit të mundshëm të saj në të ardhmen për fshatin Drizë, e cila është përgatitur nga informacionet e marra nga zyrat e kadastrës. Kërkimi dhe zhvillimi i mëtejshëm mund të kryhen bazuar në hapat e ardhshëm të parashikuar për fshatin Drizë, në koordinim me qeverinë shqiptare. Siç u përmend më lart, fshatarët nuk kanë bashkëpunuar me DHP-në, kështu që është e paqartë nëse mund të kryhet ndonjë konsultim me familjet për të paraqitur opsionet për mbështetjen e mjeteve të jetesës nga DHP-ja ose për të kuptuar nëse banorët do t'i refuzojnë veprimet e DHP-së në mënyrë të njëanshme, rast në të cilin ata do të mbeten vetëm me vlerat e ofruara nga qeveria shqiptare për shpronësimin.




Figura 6: Harta e fshatit Drizë




Figura 7: Harta e përdorimit të tokës në zonën e HEC-it Kokëli




Figura 8: Harta e përdorimit të tokës në zonën e HEC-it Moglicë



### 3.7.1.2 Demonstrimet

Si pjesë e hapit të parë në prezantimin e alternativave bujqësore të realizueshme mund të kërkohej që të kryhen disa demonstrime dhe prova në terren me qëllim (1) që të kryhen veprimtaritë për mjetet e jetesës që u janë propozuar FPP-ve dhe sigurimin e realizueshmërisë së tyre, (2) që t'u tregohen FPP-ve teknologjitë dhe teknikat që DHP do të ofrojë si pjesë e paketës për mbështetjen e mjeteve të tyre të jetesës, (3) që të zhvillohen teknikat më të përshtatshme dhe një terren trajnimi për veprimtari të mjeteve të jetesës në të ardhmen. Besohet se ngritja e parcelave/bahçeve/fermave/zonave të demonstrimit do të jetë një motivues i fortë dhe do të nxisë interesin e FPP-ve për angazhimin e DHP-së për të siguruar ndihmesën më të përshtatshme për nevojat e tyre individuale. Informacionet paraprake kanë lejuar studime më të thella të fshatrave që ndikohen nga hidrocentrali i Banjës dhe më poshtë paraqiten veprimtaritë e propozuara të demonstrimit që mund të kryhen nëse FPP-të tregojnë interes për këtë veprimtari.

Nr.	Fshati	Demonstrimet
1	Çekin	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i perimeve në një tunel të vogël</li> <li>• Testime në terren për kultivarët e misrit</li> </ul>
2	Cërujë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kultivimi i sherebelës</li> <li>• Prodhimi i pjeprit dhe shalqirit në një tunel të vogël</li> <li>• Prodhimi në serrë i perimeve</li> <li>• Prodhimi i rrushit të tavolinës</li> </ul>
3	Drizë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi në serrë i perimeve</li> <li>• Prodhimi i pjeprit dhe shalqirit në një tunel të vogël</li> <li>• Kultivimi i shegës</li> <li>• Kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike</li> <li>• Prodhimi i rrushit të tavolinës</li> <li>• Kultivimi i luleshtrydheve</li> </ul>
4	Gjergjovinë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemet e vaditjes me pika</li> </ul>
5	Qerret	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i pjeprit dhe shalqirit në një tunel të vogël</li> <li>• Prodhimi i rrushit të tavolinës</li> </ul>
6	Cingar	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemet e vaditjes me pika</li> <li>• Kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike</li> </ul>
7	Trashovicë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi në serrë i perimeve</li> <li>• Prodhimi i pjeprit dhe shalqirit në një tunel të vogël</li> <li>• Pemishte me drufrutorë me densitet të lartë</li> </ul>
8	Dushk	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Testime në fushë të kultivarit të misrit</li> <li>• Makineri precize për mbjelljen e misrit</li> <li>• Sisteme vaditjeje me spërkatje</li> </ul>
9	Zgjupë Kodër	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemet e vaditjes me pika</li> </ul>
10	Mazrek	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemet e vaditjes me pika dhe pajisjet për fertilizim nëpërmjet ujit</li> </ul>
11	Zgjupë Fushë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Testime në fushë të kultivarit të misrit</li> </ul>

Nr.	Fshati	Demonstrimet
12	Blerimas	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sistemet e vaditjes me pika dhe pajisjet për fertilizim nëpërmjet ujit</li> </ul>
13	Kaçivel	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prodhimi i perimeve në tunele të vegjël</li> </ul>
14	Shinavlash	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sistemet e vaditjes me pika dhe pajisjet për fertilizim nëpërmjet ujit</li> </ul>

Tabela 11: Veprimtaritë e propozuara demonstruese për fshatrat që preken nga HEC-i i Banjës

Propozimet do t'i paraqiten FPP-ve që kanë dhënë informacione për inventarizimin për të përcaktuar interesin e tyre në ngritjen e zonave të demonstrimit në tokën e tyre aktuale për të nisur prezencën e DHP-së në fshat dhe për të treguar interesin e madh të kompanisë për të ndihmuar FPP-të të rikuperojnë mjetet e tyre të jetesës të paktën në nivelet që ishin përpara projektit.

### 3.7.1.3 Zhvillimi i vaditjes

#### 3.7.1.3.1 Baza

Zonat e prekura nga projekti shtrihen në një sipërfaqe kodrinore/malore, e karakterizuar nga një tokë e punueshme e cilësisë së ulët. Historikisht, vaditja është bërë kryesisht nëpërmjet sistemeve të pompimit të ujit nga lumi i Devollit, por pas rënies së komunizmit këto sisteme janë lënë të shkatërrohen prej mungesës së mirëmbajtjes dhe paaftësisë së familjeve për të mbuluar kostot operative. Kostoja e lartë e vaditjes dhe mungesa e investimeve së fundmi në këtë sektor nga qeveria shqiptare (pronarja e ligjshme e këtyre sistemeve) kanë çuar në degradimin e të gjitha skemave të vaditjes në zonë përgjatë dekadës së fundit. Që atëherë, fermerët kanë provuar zgjidhje shumë të kushtueshme për të vazhduar veprimtarinë e tyre bujqësore - kryesisht për prodhimin e foragjereve, por këto kanë treguar sukses të kufizuar.

Sfida kryesore me të cilën përballët zhvillimi i sistemeve të suksesshme të vaditjes është funksionimi i tyre afatgjatë dhe kërkesat për mirëmbajtje. Bazuar në ligjet lokale, funksionimi i skemave të vaditjes duhet bërë mbi bazë vullnetare nga përdoruesit realë të ujit. Përvoja e përgjithshme në vend, edhe në rastin e skemave me gravitet të plotë, ka treguar se kjo praktikë nuk ka sukses. Një çështje tjetër që mund të ndikojë në ngritjen e sistemeve të qëndrueshme është se në vitin 2012 Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, vendosi që disa nga skemat e vogla të vaditjes t'ia transferojë qeverisjes vendore. Pavarësisht konceptit për ta sjellë menaxhimin e këtyre sistemeve te përdoruesit e vërtetë, kjo nuk zgjidhi çështjet operative, sepse qeverisja vendore nuk ka as mjetet financiare, as njohuritë teknike për të menaxhuar qoftë edhe këto sisteme të vogla.

#### 3.7.1.3.2 Qëllimi dhe veprimtaritë

Qëllimi kryesor është rritja e efikasitetit të përdorimit të tokës së punueshme duke mbështetur zhvillimin ekonomik të fermerëve nëpërmjet:

- Rritjes së produktivitetit të tokës si mënyrë për zbutjen e humbjes së tokës për FPP.
- Rritjes së sipërfaqes që mund të vaditet (krahasuar me gjendjen aktuale)
- Uljes së kostove të vaditjes krahasuar me kostot aktuale
- Përmirësimin të sistemit të vaditjes nëpërmjet ndërhyrjes fizike

- Ngritjes së organizimit dhe procedurave të qëndrueshme operative dhe të mirëmbajtjes
- Ndihmës për zbatimin e procedurave të përmirësuara të vaditjes për përdorimin dhe mirëmbajtjen

Të gjitha veprimtaritë do të ndahen në paketa pune vjetore të detajuara. Qëllimi është t'u jepet ndihmë FPP-ve për të përdorur praktikatat e përmirësuara dhe të qëndrueshme të vaditjes. Për të siguruar sukses, bashkëpunimi ndërmjet FPP-ve, fshatit dhe qeverisjes vendore do të jetë pjesë integrale dhe e nevojshme për të konfirmuar angazhimin dhe interesin e tyre në zhvillimin e bujqësisë nëpërmjet bimëve me vlerë të lartë dhe, nëse është nevoja, duke kontribuar në ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e vetë skemave. Megjithatë, ky zhvillim potencial i vaditjes duhet të balancohet në lidhje me angazhimet e DHP-së në marrëveshjen e koncesionit për prodhimin e energjisë. Veprimtaritë kryesore do të përfshijnë:

- Përmirësimin e infrastrukturës vaditëse
- Ndihmën në zgjidhje individuale të vaditjes për personat e prekur, kur zgjidhjet komunitare nuk janë të realizueshme
- Propozimin dhe zbatimin e standardeve të përmirësuara të shërbimit të vaditjes në zonën e projektit
- Ngritjen dhe ndjekjen e një programi afatgjatë për ta bërë procesin të qëndrueshëm
- Ngritjen dhe trajnimin e organizatave të përdoruesve të vaditjes
- Monitorimin e funksionimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të vaditjes
- Mbështetjen për organizatat e vaditjes me asistencë teknike
- Rritjen e numrit të hektarëve shtesë që mund të vaditen

Përveç zbatimit potencial të sipërpërmendur të sistemeve të vaditjes, do të lindë nevoja për të promovuar praktika bujqësore më efikase për ruajtjen dhe rehabilitimin e tokës, si dhe teknika vaditjeje që ruajnë ujë në të gjithë fshatrat e prekur.

#### 3.7.1.4 Mbështetje paraprake për mjetet e jetesës dhe ndërhyrjet për zhvillimin (HEC-i Banjë)

Në përgjithësi, strategjia do të varej nga intensifikimi i prodhimit të kulturave në tokën bujqësore që mbetet në dispozicion të FPP-ve.

Bazuar në studime dhe diskutime paraprake me komunitetet e prekura në zonën e HEC-it Banjë, më poshtë paraqiten ndërhyrjet e rekomanduara ZHMJ që do t'i propozohen më tej FPP-ve.

Nr.	Fshati	Alternativat e mundshme (të përgjithshme)	Ndërhyrjet e mundshme ZHMJ	
			Mbështetja e mundshme për fshatin	Mbështetja për familjet individuale
1	Shushicë e Vogël	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i perimeve</li> <li>• Prodhimi i pemëve frutore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rehabilitimi i një segmenti të caktuar të kanalit të vaditjes</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Blegtori</li> <li>• Sistemet vaditëse</li> <li>• Fidanë të pemëve frutore</li> </ul>
2	Çekin	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i misrit</li> <li>• Menaxhimi i blegtorisë (bagëtime)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhje e mundshme për vaditjen</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Makineritë mbjellëse</li> <li>• Sisteme vaditjeje me spërkatje</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i perimeve</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Menaxhimi i blegtorisë (bagëtime)</li> </ul>

Nr.	Fshati	Alternativat e mundshme (të përgjithshme)	Ndërhyrjet e mundshme ZHMJ	
			Mbështetja e mundshme për fshatin	Mbështetja për familjet individuale
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i pemëve frutore</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fidanë të pemëve frutore</li> </ul>
3	Cërujë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i perimeve</li> <li>• Kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhje e mundshme për vaditjen</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fidanë të pemëve frutore</li> <li>• Sistemet e vaditjes me pika dhe pajisjet për fertilizim nëpërmjet ujit</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kultivarët e rrushit për verë dhe për tavolinë</li> <li>• Prodhimi i pemëve frutore dhe rrushit</li> </ul>		
4	Drizë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhje e mundshme për vaditjen</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Makineri të vogla bujqësore</li> <li>• Sistemet e vaditjes me pika dhe pajisjet për fertilizim nëpërmjet ujit</li> <li>• Sistemet e vaditjes me spërkatje / mini spërkatje</li> <li>• Fidanë të pemëve frutore</li> <li>• MAP (Bimë Medicinale Aromatike) - fidanët</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i perimeve</li> <li>• Prodhimi i pemëve frutore</li> </ul>		
5	Gjergjovinë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i pemëve frutore</li> <li>• Prodhimi i rrushit për verë dhe për tavolinë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhje e mundshme për vaditjen</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fidanë të pemëve frutore</li> <li>• Dhi dhe dele</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtimi i prodhimit blegtoral (bagëtitë e imëta)</li> </ul>		
6	Pishaj	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i foragjereve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhje e mundshme për vaditjen</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemet e vaditjes me pika dhe pajisjet për fertilizim nëpërmjet ujit</li> <li>• Sisteme vaditjeje me spërkatje</li> </ul>
7	Qerret	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i perimeve</li> <li>• Kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike</li> <li>• Kultivarët e rrushit për verë dhe për tavolinë</li> <li>• Prodhimi i pemëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhje e mundshme për vaditjen</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fidanë të pemëve frutore</li> <li>• Sistemet e vaditjes me pika dhe pajisjet për fertilizim nëpërmjet ujit</li> </ul>

Nr.	Fshati	Alternativat e mundshme (të përgjithshme)	Ndërhyrjet e mundshme ZHMJ	
			Mbështetja e mundshme për fshatin	Mbështetja për familjet individuale
		frutore dhe i rrushit		
8	Cingar	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i pemëve frutore</li> <li>• Shtimi i prodhimit blegtoral (bagëtitë e imëta)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i rezervuarëve të vegjël të ujit</li> <li>• Menaxhimi i blegtorisë (përmirësimi i racës: dhitë dhe delet)</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kultivimi i bimëve mjekësore dhe aromatike</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fidanë të pemëve frutore</li> </ul>
9	Trashovicë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i perimeve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhje e mundshme për vaditjen</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pajisjet e vaditjes me pika dhe të fertilizimit nëpërmjet ujit</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i foragjereve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i rrugës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sisteme vaditjeje me spërkatje</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i frutave</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fidanë të pemëve frutore</li> </ul>
10	Dushk (Silare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i foragjereve</li> <li>• Menaxhimi i blegtorisë (mbarështimi i kafshëve)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhje e mundshme për vaditjen</li> <li>• Ndërtimi i rezervuarit të ujit</li> </ul>	
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Menaxhimi i blegtorisë (prodhimi i mishit)</li> </ul>		
11	Zgjupe Kodër	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i pemëve frutore</li> <li>• Shtimi i prodhimit blegtoral (bagëtitë e imëta)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i rezervuarëve të vegjël të ujit</li> <li>• Menaxhimi i blegtorisë (përmirësimi i racës: dhitë dhe delet)</li> <li>• Fidanë të pemëve frutore</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i pemëve frutore</li> <li>• Shtimi i prodhimit blegtoral (bagëtitë e imëta)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Asistencë për përmirësimin e rrugës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i rezervuarëve të vegjël të ujit</li> <li>• Menaxhimi i blegtorisë (përmirësimi i racës: dhitë dhe delet)</li> <li>• Fidanë të pemëve frutore</li> </ul>
12	Mazrek	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i pemëve frutore</li> <li>• Shtimi i prodhimit blegtoral (bagëtitë e imëta)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i rezervuarëve të vegjël të ujit</li> <li>• Menaxhimi i blegtorisë (përmirësimi i racës: dhitë dhe delet)</li> <li>• Fidanë të pemëve frutore</li> </ul>
		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i pemëve frutore</li> <li>• Shtimi i prodhimit blegtoral (bagëtitë e imëta)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhje e mundshme për vaditjen</li> <li>• Ndërtimi i rrugës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemet e vaditjes me pika dhe spërkatje</li> <li>• Viçat</li> </ul>
13	Zgjupe Fushë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i foragjereve</li> <li>• Menaxhimi i blegtorisë (prodhimi i mishit)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjidhje e mundshme për vaditjen</li> <li>• Ndërtimi i rrugës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sistemet e vaditjes me pika dhe spërkatje</li> <li>• Viçat</li> </ul>
14	Blerimas	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhimi i pemëve frutore</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i rezervuarëve të vegjël të ujit</li> </ul>

Nr.	Fshati	Alternativat e mundshme (të përgjithshme)	Ndërhyrjet e mundshme ZHMJ	
			Mbështetja e mundshme për fshatin	Mbështetja për familjet individuale
		<ul style="list-style-type: none"> <li>Shtimi i prodhimit blegtoral (bagëtitë e imëta)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>Menaxhimi i blegtorisë (përmirësimi i racës: dhitë dhe delet)</li> <li>Fidanë të pemëve frutore</li> </ul>
15	Kaçivel	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prodhimi i pemëve frutore</li> <li>Prodhimi i perimeve</li> <li>Prodhimi i foragjereve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zgjidhje e mundshme për vaditjen</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërtimi i rezervuarëve të vegjël për mbledhjen e ujit</li> <li>Sistemet e vaditjes me pika dhe pajisjet për fertilizim nëpërmjet ujit</li> <li>Fidanë të pemëve frutore</li> </ul>
16	Shinavlash	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prodhimi i pemëve frutore</li> <li>Shtimi i prodhimit blegtoral (bagëtitë e imëta)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndërtimi i rezervuarëve të vegjël të ujit</li> <li>Menaxhimi i blegtorisë (përmirësimi i racës: dhitë dhe delet)</li> <li>Fidanë të pemëve frutore</li> </ul>

**Tabela 12: ZHMJ-të e mundshme për fshatrat e prekur nga HEC-i Banjë**

(mund të konsiderohen edhe opsione të tjera bazuar në interesat e FPP-së)

Ndërkohë që studimet fillestare bujqësore kanë zhvilluar alternativa të mundshme bazuar në informacionet e marra nga grupi kampion, vendimi përfundimtar për ndërhyrjet ZHMJ do të bazohet në rezultatet e konsultimeve individuale në familje (KIF) me FPP-të.

### 3.7.1.5 Mikrokreditë dhe zhvillimi i biznesit të vogël

Në shumë raste për FPP-të disponohen shumë pak shërbime financiare formale si kursimet dhe kreditë. Përvoja ndërkombëtare ka treguar se këto shërbime janë vërtetuar si një instrument i mirë për t'u mundësuar individëve ndërtimin e asetëve dhe rritjen e të ardhurave, duke u siguruar kështu një potencial për gjenerimin e të ardhurave. Në koordinim me një institucion me përvojë mikrofinancimi (OJQ, organizatë ndërkombëtare, kompani private ose organizatë qeveritare) ose të zhvillimit të kapaciteteve lokale, qëllimi i DHP-së është rritja e aksesit për FPP-të në këto shërbime financiare me kontributin fillestar të kapitalit bazuar në të drejtat për asetet dhe prodhimet e prekura. Në parim, çdo aktivitet që gjeneron të ardhura dhe që ka një plan biznesi të besueshëm mund të merret në konsideratë për financim (pagesa bazuar në etapat e planit të biznesit). Për këtë sistem duhen kryer ende studime të mëtejshme bazuar në interesat e FPP-ve dhe realizueshmërinë e tij.

### 3.7.1.6 Programet e tjera

Opsionet alternative mund të konsiderohen si zëvendësuese për kompensimet e drejtpërdrejta e të plota me para në dorë për FPP-të që përmbushin kritere të caktuara, dhe ku rikuperimi i produktivitetit është paracaktuar më parë për alternativa të tjera të përshtatshme dhe të realizueshme të mjeteve të jetesës, si psh. si depozita me afat, arsimit dhe pensionet. Llogaritë me dorëzani me norma interesi depozite me afat të përcaktuar mund të përdoren për rastet kur arsimit

universitar i një anëtari të familjes përzgjidhet si zgjidhje kompensimi. Në parim, skemat e pensioneve mund të ofrojnë gjithashtu opsione të përshtatshme për të zhvendosurit në disa profile të caktuara familjare. Një element i rëndësishëm është të shikohen programet ekzistuese të qeverisë për pensionet (dhe të zhvillohet një i ngjashëm) për të siguruar që njerëzve të aftë t'u jepet mundësia të vazhdojnë të jenë produktivë, nëse e dëshirojnë. Një institucion privat (me garanci sigurimi të mbështetura nga qeveria) do të ishte ofruesi më i përshtatshëm i këtij shërbimi, por duhen kryer studime të mëtejshme. Bazuar në çmimet e disponueshme në treg, për shembull, kompensimi për asetet bashkë me pensionin mund të rikuperojnë të ardhurat e mëparshme dhe standardet e jetës.

### 3.8 Treguesit specifike të programit të risistemimit

Suksesi i përgjithshëm i këtyre aktiviteteve do të jenë masat në monitorimin e të ardhurave të familjeve, siç përmendet më lart. Megjithatë, do të ketë edhe tregues specifike të programit për mjetet e jetesës, ku përfshihen:

- Numri i takimeve të konsultimit dhe progresi për arritjen e marrëveshjeve me komunitetet dhe familjet.
- Lloji i mbështetjes për mjetet e jetesës ose lloji i kompensimit për FPP-të
- Numri i aseteve të kompensuara, të cilat humbasin si rezultat i ndikimeve nga projekti. Duhet të përputhet me humbjen.
- Numri i zonave të demonstrimit dhe provave.
- Rezultatet nga shtimi i punës së fermerit (inputet, prodhimi, rezultatet, etj.)
- Numri dhe progresi i skemave të investimit në biznes (nga programi i mikrokredive i mbështetur nga DHP-ja)
- Llogaritë e mikrokredisë dhe statusi (norma e shlyerjes, kreditë, etj.)
- Numri i programeve të pensionit/bursave dhe programeve të tjera
- Monitorimi i familjeve vulnerabël
- Përqindja e familjeve që mbeten në zonat e risistemimit pas 3 vjetësh.
- Shtimi i prodhimit blegtoral (bagëtitë e imëta)

#### 4. PROGRAMI I ZHVILLIMIT SOCIAL (PZHS)

Programi i Zhvillimit Social i DHP-së përbëhet nga veprimtari të zbutjes së ndikimeve si dhe nga ndërhyrje të tjera plotësuese në mbështetje të zbatimit të programeve sociale dhe mjedisore të shoqërisë. Synimi i tij është të minimizojë ndikimet e projektit në risistemim si dhe ato mjedisore, përmes një sërë veprimtarish me fushë të gjerë veprimi që synojnë institucionet publike dhe komunitetet e prekura nga projekti në tërësi.

Është një nismë e projektuar për të rritur përfitimet e përgjithshme të komunitetit të Devollit me qëllim zbutjen e efekteve negative (të drejtpërdrejta dhe të tërthorta) të projektit dhe për të shtuar rezultatet pozitive. PZHR është një sipërmarrje që do të zhvillohet nga DHP, pjesë e të cilës do të jenë planifikimi dhe zhvillimi për rehabilitimin dhe përmirësimin e infrastrukturës fizike, si dhe i shërbimeve të tjera sociale brenda zonës së projektit. Në bazë të informacionit të VNMS, plani i zhvillimit social do të marrë parasysh nënsektorë të tillë si rrugët; ujin dhe kanalizimet, elektricitetin dhe ushqyerjen si dhe shëndetësinë e arsimin. Me këta faktorë të rëndësishëm në mendje, programi u projektua fillimisht për të pasur si objektiv katër fusha kryesore ndërhyrjeje:

- **Plani i zhvillimit infrastrukturor**  
PZHI trajton rikuperimin, rehabilitimin dhe përmirësimin e infrastrukturës publike/të komunitetit në zonën e projektit, përmes zëvendësimit si dhe përmirësimit të infrastrukturës fizike publike dhe ndërhyrjet në atë që ka humbur për shkak të projektit ose që është bërë e nevojshme për shkak të zhvendosjes ose risistemimit të FPP-ve. Për qëllime sqaruese, ky plan do të mbulojë ndikimet në rrugët hyrëse, në sistemet e furnizimit me ujë dhe në burime, në lidhjet e energjisë elektrike si dhe në burimet e trashëgimisë kulturore e fizike (BTFK-të).
- **Plani për shëndetësinë**  
Ofron përmirësime të infrastrukturës shëndetësore në zonën e projektit, ofron asistencë në formën e trajnimit dhe pajisjeve, njërive vendore të shërbimit shëndetësor për kujdesin shëndetësor parësor. Nuk ka asnjë ndikim në ambientet ose shërbimet shëndetësore në zonat e HEC-eve Banjë dhe Kokël dhe prandaj ndërhyrjet do të kryhen rast pas rasti siç është rënë dakord me autoritetet vendase të shëndetësisë. Ndihma në zonën e HEC-it Moglicë do të garantojë përfitimin e kujdesit shëndetësor, minimalisht sipas standardeve ekzistuese përpara projektit.
- **Plani për arsimin**  
Do të ofrojë mbështetje për ambientet e mësimdhënies dhe promovimin e zhvillimit arsimor në zonën e projektit përmes trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve si dhe furnizimin me pajisje të shkollave vendase. Disa ndikime në infrastrukturën dhe frekuentimin e shkollës do të shikohen si pjesë e ndërtimit të 3 HEC-eve.
- **Plani për menaxhimin e fluksit**  
Është monitorimi i migrimit në Luginën e Devollit i cili do të jetë plotësues i iniciativave të sigurisë shëndetësore dhe mjedisit në sheshet e ndërtimit dhe në kampe. Ai ofron fushata sensibilizuese për trafikun, sigurinë shëndetësore e mjedisore për shkollat dhe komunitetet që gjenden afër shesheve të ndërtimit dhe kampeve.



## 4.1 Plani i Zhvillimit Infrastruktural

### 4.1.1 Baza e PZHI

Rezervuarët e krijuar nga ndërtimi i tre digave do të përmbysin rrugët kryesore, dytësore, urat dhe shtigjet të cilat janë jetësore për të lidhur fshatrat me zonat urbane në varësit të të cilave janë komunitetet, të tilla si; shkollat, shërbimet shëndetësore, punësimi, veprimtaritë tregtare, lidhjet shoqërore (sidomos me familjen) punën në fushat e tyre, mbledhjen e druve të zjarrit, dhe furnizimin me ujë në disa raste. Një pjesë e infrastrukturës së përmbysur janë linjat e energjisë elektrike, furnizimi me ujë dhe sistemet e vaditjes, të cilat aktualisht funksionojnë pjesërisht por në kushte të këqija. Infrastruktura e përmbysur, e identifikuar, i është dorëzuar GIP-it nga komunat përkatëse të prekura. Në zonën e Devollit të poshtëm janë zhvilluar konsultime me komunitetin dhe reagimet me rekomandimet e komunitetit do të trajtohen për zgjidhje alternative të infrastrukturës. Vendimet dhe marrëveshjet do të merren me autoritetet përkatëse mbi opsionet e mbështetura nga qeveria shqiptare.

### 4.1.2 Qëllimi dhe veprimtaritë

Programet e mbështetjes infrastrukturore janë plotësuese të veprimtarive të risistemimit dhe kompensimit dhe do të ndihmojnë në përmirësimin e shërbimit në Luginën e Devollit si dhe do të rehabilitojnë infrastrukturën hyrëse që ka humbur për shkak të projektit, me synim minimizimin e ndikimit në lëvizjet e banorëve vendas.

Më poshtë paraqiten veprimtaritë kryesore që do të ndërmerren dhe zonat ku do të ndërmerren:

- Rrugët dhe shtigjet
  - Vlerësimi i rezultateve të konsultimeve me komunitetet vendore të ndikuara dhe kërkesave të tyre për përmirësime të infrastrukturës, si pjesë e paketave të kompensimit
  - Rehabilitim i rrugëve të ndikuara. Natyra e saktë e rikuperimit do të jetë në varësi të asaj që është përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit, si dhe në marrëveshjet e tjera midis të gjithë aktorëve, duke qenë se çdo ndërhyrje do të duhet të mbulojë të gjitha kërkesat e komunitetit vendas si dhe të QeSH-së.

Lista e infrastrukturës potencialisht të ndikuar dhe ndërhyrjet e propozuara

Infrastruktura që mund të preket		Ndikimi i mundshëm	Zgjidhjet e mundshme	Pala përgjegjëse	Komente
Lloji	Vendndodhja				
<b>HEC-i Banjë</b>					
Rrugë e asfaltuar	Banjë - Gramsh	Humbje e rrugës kryesore lidhëse Gramsh - Elbasan	Zëvendësimi i rrugës Gramsh-Banjë	Qeveria shqiptare	DHP do t'i paguajë qeverisë shqiptare koston e infrastrukturës së përmbysur. Qeveria shqiptare do të ndërtojë rrugën e re Banjë -Gramsh
Rruga e hyrëse e fshatit	Bregu i majtë i Banjës	Humbja e rrugës lidhëse të banorëve në bregun e majtë me rrugën kryesore Gramsh/Elbasan në bregun e djathtë	Ndërtimi i rrugës në bregun jugor (B07) + ura e Trashovicës (B07-01) do të	QeSH (ndërton urën) dhe DHP	Për të rikthyer rrugën e kalimit të bregut të majtë DHP ka vendosur të ndërtojë rrugën e bregut jugor.

Infrastruktura që mund të preket		Ndikimi i mundshëm	Zgjidhjet e mundshme	Pala përgjegjëse	Komente
Lloji	Vendndodhja				
Urat	Silare / Zgjupe urë këmbësorësh	Banorët në bregun e majtë të rrjedhës së sipërme (Silare, Zgjupe) humbasin rrugën lidhëse me rrugën kryesore Gramsh / Elbasan në bregun e djathtë Rrugën që i lidh me: Tregjet, kullotjen e bagëtive, shërbimet sociale (Shkolla e Drizës) dhe rrjetet sociale.	ndërtohet rruga lidhëse e bregut të majtë (Silare, Zgjupe) e poshtme dhe e sipërme, Trashovicë) me Gramshin	(ndërton B07)	Për rindërtimin e urës së Trashovicës përgjigjet qeveria shqiptare.
	Ura për këmbësorë e Trashovicës	Banorët e bregut të majtë të Devollit të poshtëm (Trashovicë, Silare dhe Zgjupe) humbasin rrugën lidhëse me Gramshin. Rrugën që i lidh me: Tregjet, kullotjen e bagëtive, shërbimet sociale dhe rrjetet sociale.			
<b>HEC-i Moglicë</b>					
Rruga e hyrëse e fshatit	Moglicë	Fshatrat e Malësisë dhe Nikollara e Gjinikasi humbasin rrugën lidhëse me rrugën kryesore Gramsh/Korçë dhe fshatrat përreth			Çështja e rrugëve lidhëse, në kuptim të MK-së, duhet gjykuar në dy dimensione. E para, rrugët kryesore që do të përmythen nga rezervuarët dhe që duhen zëvendësuar.
Urat	Ura për këmbësorë në Lumaj në përroin e Malësisë,	Fshatrat e Malësisë (Lumaj, Peshtan, Kodras, Karbanjos, dhe Denasi) humbasin lidhjen me rrugën kryesore Gramsh/Korçë.	1) Ndërtim i rrugës M06, maja e digës Moglicë deri në Kodras, që lidh fshatrat e Malsisë me rrugën kryesore Gramsh/Korçë. 2) Ndërtimi i rrugës M12 që do të jetë rrugë lidhëse me fshatrat Gjinikas, Osoja dhe Lekas	Mbetet për t'u përcaktuar	MK përcakton se "zhvilluesi do t'i paguajë Qeverisë vlerat e aseteve që kanë humbur nga përmytja dhe qeveria shqiptare do të marrë më pas vendime për rikonstruktimin e rrugës". Deri më sot nuk është marrë asnjë vendim përfundimtar mbi këto opsione.
	Ura e rrugës pranë Nikollarës në lumin e Devollit	Fshatrat e Malësisë (Lumaj, Peshtan, Kodras, Karbanjos, Denasi dhe Osoja) humbasin lidhjen me rrugën kryesore Gramsh/Korçë.			
	Ura e këmbësorëve "Peshtan" përmes lumit të Devollit,	Fshatrat e Malësisë (Lumaj, Peshtan, Kodras, Karbanjos, dhe Denasi) humbasin lidhjen me rrugën kryesore Gramsh/Korçë.			

Infrastruktura që mund të preket		Ndikimi i mundshëm	Zgjidhjet e mundshme	Pala përgjegjëse	Komente
Lloji	Vendndodhja				
	Ura e rrugës në Gjnikas përmes lumit të Devollit	Fshatrat në bregun e majtë të lumit të Devollit (Osoja, Gjnikas) humbasin rrugën lidhëse me rrugën kryesore Gramsh/Korçë.			
	Rruga e këmbësorëve në Osojë mbi përroin e Osojës	Fshatrat e Malësisë dhe Nikollara e Gjnikasi humbasin rrugën lidhëse me rrugën kryesore Gramsh/Korçë dhe fshatrat përreth.			

Tabela 13: Ndërhyrjet e propozuara

Hartat e ndërhyrjeve të propozuara për rehabilitimin e rrugëve lidhëse për Banjën dhe Moglicën




Figura 9: Rrugët rurale të propozuara për zëvendësim në Banjë

(nuk përfshin rrugën Banjë – Gramsh që nuk është bërë publike nga qeveria shqiptare)




Figura 10: Rrugët rurale të propozuara për zëvendësim në Moglicë

- Furnizimi me ujë
  - Hartim i planeve të hollësishme që do të përfshihen në PVZ-të për çdo vit, në bazë të konsultimeve dhe vlerësimeve teknike me qeverinë shqiptare
  - Mbikëqyrje e ndërtimit dhe vlerësimi i punës, si dhe koordinimi me grupet e përdoruesve të ujit, nëse nevojitet menaxhim komunal

Në tabelën e mëposhtme paraqitet një listë e burimeve ujore potencialisht të ndikuara (të identifikuara deri më tani) si dhe hapat e radhës, të propozuar:

Burimet ujore		Ndikimi i mundshëm	Masat e propozuara për rehabilitimin
Lloji	Vendndodhja		
Stacioni i pompimit të ujrave	Shtëpanj	Humbjet e mundshme për shkak të ndërtimit të HEC-it Banjë dhe shkarkimit të ujit në rrjedhën e poshtme; humbja e mundshme e furnizimit me ujë për 3 fshatra (Qafe, Shtëpanj dhe Gostimë), potencialisht 480 familje do të humbasin furnizimin me ujë të pijshëm.	1) Konsultim me autoritetet përkatëse për dhënien e zgjidhjes teknike për rehabilitimin e furnizimit me ujë 2) Përcaktimi i roleve të DHP-së dhe qeverisë shqiptare në këtë proces
Furnizimi me ujë	Drizë	Përmbytje e 3 burimeve të ujit dhe e 1 stacioni pompimi uji I gjithë fshati, 120 familje, mbetet pa furnizim me ujë të pijshëm.	1) Konsultim me autoritetet përkatëse mbi zgjidhjet e mundshme për ofrimin e ujit të pijshëm komuniteteve të ndikuara. 2) Përcaktim i roleve të DHP-së dhe qeverisë shqiptare në këtë proces 3) Të garantohet furnizimi me ujë të pijshëm i komuniteteve.
Stacione të pompimit të ujit dhe tubacione uji	Cërujë	Cëruja e sipërme humbet furnizimin me ujë të pijshëm për shkak të tubacioneve të prekura në urën e këmbësorëve Gjergjovinë. Cëruja e poshtme humbet furnizimin me ujë të pijshëm për shkak të përmbytjes së burimit ujqor.	
Burim uji publik	Qerret	3 familje humbasin furnizimin me ujë të pijshëm	
Tubacion me ujë të pijshëm	Trashovicë	I gjithë fshati do të humbasë furnizimin me ujë të pijshëm për shkak se tubacionet e ujit (rrjeti i ujësjellësit i Kerpicës) kalon përmes urës së këmbësorëve në Trashovicë	
Furnizimi me ujë	Silare	2 burime uji mund të përmbysten dhe për pasojë i gjithë fshati mund të humbasë furnizimin me ujë të pijshëm.	
Furnizimi me ujë	Lumaj*	Depozitë me ujë të pijshëm që shpërndan ujin nga maja e fshatit Karbanjos Lavdari nëpër tuba 7 km të gjatë dhe që më pas ndahet nëpër tuba nëpër 12 familje në	

Burimet ujore		Ndikimi i mundshëm	Masat e propozuara për rehabilitimin
Lloji	Vendndodhja		
		fshatin Lumaj.	risistemuarit të kenë furnizim me ujë
Furnizimi me ujë	*Nikollarë	Furnizimi me ujë do të përmytet	

Tabela 14: Ndërhryjet e propozuara (për ujin)

- Energjia elektrike
  - Mbikëqyrje e ndërtimit dhe vlerësim i punës, si dhe koordinim me autoritetet përkatëse të furnizimit me energji elektrike.

Hartat e rrjeteve ekzistuese të shpërndarjes së energjisë elektrike që kanë mundësi të preken



Figura 11: Linjat e shpërndarjes së energjisë në rrjedhën e poshtme të Banjës




Figura 12: Linjat e shpërndarjes së energjisë në rrjedhën e sipërme të Banjës






Figura 13: Linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike në Moglicë

Vendndodhja	Nr. i kabinave elektrike	Nr. i shtyllave elektrike	Kabllojt elektrike (m)
Rrjedha e poshtme e Banjës	0	30	1,714
Rrjedha e sipërme e Banjës	0	113	6,923
Zona e Moglicës	3	100	6,265
<b>Totali</b>	<b>3</b>	<b>243</b>	<b>14,902</b>

Tabela 15: Linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike të tensionit të ulët që mund të preken

#### 4.1.3 Treguesit specifikë të performacës së programit

- Kilometrat e rrugëve dhe shtigjeve të përmirësuara
- Numri i familjeve të cilave u janë rregulluar rrugët lidhëse me rrugën kryesore

## 4.2 Burimet e trashëgimisë kulturore e fizike

### 4.2.1 Gjendja aktuale

Studimet paraprake të përcaktimit të qëllimit, tregojnë se ka varre dhe lapidarë në të dyja anët e luginës së Devollit. Varreve u është dhënë gjithmonë rëndësi e madhe kulturore duke qenë një çështje mjaft delikate. Sheshet kulturore/lapidarët gjenden në të gjithë zonën e projektit brenda nivelit maksimal të ujit dhe potencialisht do të përmythen nga krijimi i rezervuarëve. Janë vizituar sheshet e mundshme të varreve dhe lapidarëve përgjatë rrugës nacionale Gramsh – Elbasan, Gramsh-Lozhan me qëllim që të mblidhet informacion kontekstual në zonë dhe të shihet se si mund të preken ato. Këta lapidarë janë ngritur pas aksidenteve rrugore dhe sipas ligjeve shqiptare janë vendosur aty në mënyrë të paligjshme.

Lapidarët historik, gjithsesi, lidhen me heronj të Luftës së Parë e të Dytë Botërore dhe kanë rëndësi të madhe për komunitetin e përfaqësuar nga këta heronj.

### 4.2.2 Qëllimi dhe veprimtaritë

Të lehtësohet zhvendosja dhe nëse nuk shmanget, të gjenden zgjidhje për zhvendosjen në bazë të marrëveshjeve me familjarët ose institucionet përgjegjëse

- Identifikimi/vlerësimi përfshirë konsultimin me familjet e ndikuara (kur është e mundur).
- Zëvendësimi i objekteve të kultit dhe i strukturave fetare, me të tjera të paktën me të njëjtën vlerë dhe të pranueshme për komunitetin.
- Mbështetje për ceremonitë dhe përgatitjet e pranueshme për zhvendosjen e sendeve të lëvizshme dhe rivendosjen në vendin e ri të rënë dakord.
- Mbështetje në zhvendosjen e lapidarëve të aksidenteve (sipas kërkesës).
- Bashkëpunim me agjenci të specializuara dhe marrja e lejeve për zhvarrosjet dhe familjet e ndikuara.

### 4.2.3 Procedura e zbulimeve arkeologjike të rastësishme

Është e pranuar se gjatë ndërtimit mund të gjenden zbulime ose zbulime arkeologjike të rastësishme të objekteve ose vendeve. Sipas ligjit dhe vendimit të këshillit arkeologjik, mbrojtja e trashëgimisë kulturore është përgjegjësi e kontraktorit civil. Në rastin e zbulimeve arkeologjike të rastësishme kontraktorët e DHP-së janë të detyruar të njoftojnë DHP-në në mënyrë që të bëhet koordinimi i duhur me autoritetet e QSH.

### 4.2.4 Treguesit specifikë të performancës së programit:

- Numri i BFPK të zhvendosura (varret, lapidarët historik, ndërtesat fetare)
- Numri i lapidarëve të aksidenteve të hequra dhe të kompensuara.

## 4.3 Plani për shëndetësinë

### 4.3.1 Baza e shëndetësisë

Nevojat e shëndetit publik në zonat rurale janë sfiduese. Godinat shëndetësore në këtë zonë janë në kushte shumë të këqija dhe nuk mund të mbulojnë nevojat e zbatojnë standardin e nevojshëm lidhur me veprimet administrative, klinike dhe të burimeve njerëzore. Në bazë të verifikimeve në vend, është konstatuar se Qendrat Shëndetësore (QSH) janë godina të vjetra e të rrënuara, kryesisht me dritare të thyera dhe me ambiente mjaft të kufizuara. Mungon ngrohja gjatë periudhës

së dimrit. Sa i përket higjienës, mungon furnizimi me ujë, përdoren gropa septike dhe mbetjet e ngurta mjekësore digjen ose groposen çdo muaj afër qendrës shëndetësore. Pajisjet dhe medikamentet e nevojshme janë mjaftë të limituara. Pajisjet ekzistuese nuk plotësojnë nevojat mjekësore të pacientëve. Pamja e përgjithshme tregon se godinat shëndetësore operojnë me pajisje të vjetra dhe nevojiten pajisje të reja dhe medikamente të mjaftueshme. Qendrat shëndetësore të synuara ofrojnë shërbime për fëmijët, gratë shtatzëna, kujdes shëndetësor për të moshuarit, të tillë si: Injeksione, matje tensioni, vaksinim, mjekim plagësh dhe kujdesi në rastin e personave me ethe, injeksione kundër alergjive. Burimet njerëzore janë po ashtu një shqetësim tjetër për këto zona. Kryesisht ka vetëm një infermiere në QSH dhe një doktor që punon 2 ose 3 herë në javë për QSH. Specialist të posaçëm nuk ka fare.

Bazuar në inventarizimin socio ekonomik në zonën e projektit në Banjë mosha mesatare e sëmurë nga patologji është 52 vjeç. 56% e tyre janë femra dhe 44% janë meshkuj. Vetëm 8% e të intervistuarve pohojnë se nuk vuajnë nga asnjë sëmundje dhe se nuk kanë vuajtur nga asnjë sëmundje vitin e fundit. Sëmundjet më të përhapura janë: sëmundjet kardiake; 21% e FPP-ve deklarojnë se vuajnë nga tensioni i lartë ose sëmundje të tjera të lidhura me zemrën; 13% vuajnë nga problemet me kockat dhe muskujt; 11% vuajnë nga çrregullime neurologjike; 6% kanë probleme pulmonare dhe pjesa tjetër ka pasur probleme shëndetësore të lidhura me gastroenterologjinë, veshkat, endokrinologjinë, malinjitetin dhe probleme obstetrike.





Figura 14: Struktura shëndetësore në Zonën e Projektit Devoll

**Hartat e qendrave shëndetësore dhe spitaleve në zonën e projektit**



**Figura 15: Infrastruktura shëndetësore ekzistuese në zonën e HEC-it Banjë**




Figura 16: Infrastruktura shëndetësore ekzistuese në zonën e HEC-it Kokël




Figura 17: Infrastruktura shëndetësore ekzistuese në zonën e HEC-it Moglicë

Përbërësit kryesorë të planit për shëndetësinë, janë:

1. Promovimi i shëndetit/fushata për kujdesin shëndetësor parësor:
2. Ngritje kapacitetesh për kujdesin shëndetësor parësor

#### 4.3.2 Qëllimi dhe veprimtaritë

- Zbutje e ndikimeve të humbjes së godinave dhe shërbimeve shëndetësore (HEC Moglicë)
  - Dy qendra shëndetësore do të përmyben, qendra shëndetësore Nikollarë dhe Lumaj. DHP do të sigurojë që FPP-të të përfitojnë kujdes shëndetësor në vendet e reja.
- Përmirësim i shërbimit shëndetësor në zonën e projektit Devoll
  - Promovim i edukimit shëndetësor përmes fushatave të shëndetit për kujdesin shëndetësor parësor në zonat e projektit.
  - Trajnime për personelin shëndetësor me fokus në shërbimin e infermiere në fshat
  - Ofrim i pajisjeve shëndetësore.
- Ndhimesë dhe mbështetje në përmirësimin e pajisjeve shëndetësore në zonat e ndikuara nga HEC-et Banjë, Kokël/Moglicë
  - Furnizim me energji elektrike dhe ujë, sipas nevojës

#### 4.3.3 Treguesit specifikë të performancës së programit:

- Numri i fushatave shëndetësore në zonat e ndikuara nga projekti
- Numri i paketave të shpërndara të pajisjeve shëndetësore
- Numri i godinave shëndetësore të ndihmuara
- Numri i sesioneve të trajnimit të specializuar për personelin shëndetësor
- Numri i infrastrukturave shëndetësore të ndikuara që janë zëvendësuar
- Numri i FPP-ve që përfitojnë shërbim shëndetësor në vendet e risistemimit

### 4.4 Plani për arsimin

#### 4.4.1 Baza e arsimit

Deri më tani, dihet se të paktën tre godina arsimore ndikohen plotësisht nga projekti. Këto ndodhen në Drizë, Nikollarë dhe Lumaj.

Në zonën e HEC Banjë, nxënësit e bregut të majtë që shkojnë në shkollat në Gjerovinë dhe Drizë nuk do të mund të frekuentojnë këto shkolla.

Përveç këtyre ndikimeve kryesore, baza tregon se godinat arsimore në luginën e Devollit gjenden në kushte të mjerueshme. Shumica e shkollave në fshatrat e prekur direkt nga projekti janë thuajse të shkatërruara e pjesërisht pikojnë. Ka raste kur përdoren vetëm pak klasa. Standardet e mësimdhënies janë nën nivelin mesatar për shkak se; orët e kombinuara të mësimin, arrijtjet mesatare, faktori distancë ndikon në lodhjen e mësuesve dhe rendimentin e mësimdhënies, siguria dhe shëndeti i fëmijëve nuk është i sigurt (mungesa e ngrohjes dhe rreziku i shembjes së ndërtesës).

Gjendja aktuale e arsimit dhe godinave në zonën e projektit Banjë, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Arsimi bazë (I-IX)	Nr. i nxënësve *	Nr. i mësuesve *	Çështjet specifike	Kushtet e infrastrukturës*	Objektet e nevojshme
1	Drizë	92	10		Të mira. Do të përmytet	Nuk disponohet
2	Çekin	76	10		të mira	Pajisje për laboratorët
3	Shushicë e Vogël	127	11		të këqija	Pajisje
4	Mazrek	18	3	proces i mësimeve i organizuar në klasa të bashkuara	në ndërtim	Nuk disponohet
5	Zgjuhë e poshtme	21	3	proces i mësimeve i organizuar në klasa të bashkuara	shumë të këqija	Instalime elektrike, banja, pajisje
<b>Cikli i ulët (I-V)</b>						
1	Trashovicë	29	1	Mësimeve është e organizuar në një klasë ku janë bashkuar të gjithë nxënësit	të këqija	Banja
2	Zgjuhë e sipërme	8	1	mësimeve e organizuar në klasa të bashkuara	të këqija	Banja, pajisje
<b>Arsimi i mesëm</b>						
1	Gjergjovinë	122	14		të mira	Instalime elektrike, pajisje
2	Gostimë	310	19		të mira	Banja, laboratorë, pajisje

**Tabela 16: Informacioni bazë për infrastrukturën arsimore në zonën e HEC-it Banjë**

\* Të dhëna zyrtare të marra nga zyra e arsimit Gramsh

\*\*Të mira: laborator funksional, banja, klasa në kushte të mira, godinë në kushte të mira, hapësirë për mësuesit/drejtimit.

Të këqija: mungesë/mosfunksionim i banjave, mungesë e sallës së mësuesve, e pajisjeve dhe laboratorëve.

Shumë të këqija: mungesë e pajisjeve bazë, godinë e rrënuar, dritare të thyera, çati që pikon, mungesë banjash.

Në bazë të këtij informacioni, në tabelën më poshtë identifikohen ndikimet e mundshme dhe disa masa/ndërrime të propozuara fillimisht, për zbatimin e tyre:

Nr.	Komuna	Fshati	Informacione bazë	Ndikimet e parashikuara	Masa zbutëse e propozuar:
1	Gostimë	Shtepanj	Arsimi bazë (I - IX). Ka një shkollë ku	Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë.	



Nr.	Komuna	Fshati	Informacione bazë	Ndikimet e parashikuara	Masa zbutëse e propozuar:
			shkojnë fëmijët e fshatit Shtepanj.		
2		Shushicë e Vogël	Arsimi bazë (I - IX). Ka një shkollë ku shkojnë fëmijët e fshatit Shushicë e Vogël.	Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë. Fëmijët mund të përballen me vështirësi gjatë periudhës së ndërtimit për shkak të pluhurit, trafikut të shtuar dhe zhurmave.	Nevojitet përmirësim i godinës së shkollës.
3		Çekin	Arsimi bazë (I – IX). Kushte të mira.	Asnjë ndikim	
4		Cërujë	Nuk ka shkollë në Cërujë, fëmijët shkojnë në shkollën e Drizës	Humbja e rrugës lidhëse me shkollën e Drizës	Rruga lidhëse me godinat arsimore, sikurse do të vendoset nga QeSH
5		Drizë	Arsimi bazë (I – IX). Godina e shkollës është në kushte të mira	Do të përmbytet	Rruga lidhëse me godinat arsimore, sikurse do të vendoset nga QeSH
6	Pishaj	Gjergjovinë	Arsimi bazë dhe i mesëm. Nxënësit e shkollës vijnë nga: Bardhan, Liras, Kotorr, Tërvol, Galigat, Bizhdan, Cingar i Sipërm dhe i poshtëm, Drizë, Cërujë, Gramsh.	Asnjë ndikim i drejtpërdrejtë.	Furnizim i shkollës me pajisje sipas nevojës.
7		Pishaj	Nuk ka shkollë në Pishaj. Fëmijët shkojnë në shkollat e Gramshit.	Asnjë ndikim	
8		Qerret	Nuk ka shkollë në Qerret. Fëmijët shkojnë në shkollat e Çekinit dhe Gramshit.	Asnjë ndikim	
9		Cingar i Poshtëm	Nuk ka shkollë në Cingar i Poshtëm. Fëmijët shkojnë në shkollën e Drizës.	Humbja e rrugës lidhëse me shkollën e Drizës	Rruga lidhëse me godinat arsimore, sikurse do të vendoset nga QeSH
10		Trashovicë	Cikli i ulët (I – V). Fëmijët shkojnë në shkollat e Gramshit për arsimin nëntëvjeçar (V – IX) dhe të mesëm.	Humbja e rrugës lidhëse me shkollat e Gramshit	Rruga lidhëse me godinat arsimore, sikurse do të vendoset nga QeSH

Nr.	Komuna	Fshati	Informacione bazë	Ndikimet e parashikuara	Masa zbutëse e propozuar:
11	Sult	Dushk (Silare)	Nuk ka shkollë në Dushk. Fëmijët shkojnë në Drizë, Gjergjovinë ose Gramsh.	Humbja e rrugës lidhëse me shkollën (ura për këmbësorë e Silarës do të përmbytet)	Rruga lidhëse me godinat arsimore, sikurse është vendosur nga qeveria shqiptare.
12		Zgjuhë Kodër	Cikli i ulët (I - V). Shkolla është në kushte të këqija.	Asnjë ndikim	
13		Mazrek	Arsimi bazë (I - IX). Shkolla është riparuar së fundmi.	Asnjë ndikim	
14		Zgjuhë Fushë	Arsimi bazë (I-IX). Shkolla është në kushte shumë të këqija.	Asnjë ndikim i drejtpërdrejtë.	
15	Moglicë	Lumaj	Arsimi bazë (I-IX). Të rinjtë shkojnë në shkollat e mesme në Lozhan and Korçë	Do të përmbytet	Rruga lidhëse me godinat arsimore, sikurse vendoset nga QeSH.
16		Nikollarë	Arsimi bazë (I-IX). Ka fëmijë që vijnë nga Nikollara, Popçishti dhe Kucaka	Do të përmbytet	

Tabela 17: Masat zbutëse të propozuara për ndikimet në arsim

#### 4.4.2 Formimi profesional: Gjendja aktuale

Kërkesa në rritje për punë të kualifikuar do të vihet në dukje gjatë fazës së ndërtimit të projektit. Është e rëndësishme që PPP-ve t'u jepet mundësia që të shfrytëzojnë kërkesat e këtyre kontraktorëve si pjesë e kontributit të projektit për të rritur punësimin në rajon. Duke pasur parasysh këtë gjë, është vënë re se Gramshi është një qyteti i vogël ku formimi profesional dhe mundësitë për trajnim janë shumë të kufizuara. Në fakt nuk asnjë qendër profesionale që të ofrojë shërbime në luginën e Devollit dhe individët e interesuar në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive të tyre janë të detyruar të shkojnë diku tjetër, gjë e cila bën që shumë veta të tërhiqen nga ky aktivitet.

#### 4.4.3 Qëllimi dhe veprimtaritë

- Zbutja e ndikimit të humbjes së godinave shkollore në zonat e prekura nga projekti duke garantuar që infrastruktura shkollore e përmbytur të zëvendësohet nëpërmjet ofrimit të mundësisë për godina arsimore alternative. Janë tre shkolla që do të përmbyten në zonën e projektit të Devollit që ndodhen në fshatrat Drizë, Nikollarë dhe Lumaj. Masat e propozuara për këto ndikime janë si më poshtë:
  - Konsultim me autoritetet arsimore dhe komunitetet e prekura për alternativat e mundshme për godina shkollore.
  - Planifikim i detajuar për zhvendosjen e shkollës
  - Përcaktimi i roleve të qeverisë shqiptare dhe DHP-së në proces
  - Garantimi që vendet e reja kanë akses në arsim nëpërmjet shkollave ekzistuese ose ndërtimit të të reja

- Ofrimi i ndihmës në rritjen e kapaciteteve të personelit të arsimit për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve arsimore të ofruara nga personeli i qeverisë shqiptare nëpërmjet ofrimit të trajnimit ose kualifikimeve në mësimdhënie.
- Ofrimi i pajisjeve shkollore (materiale, orendi) me qëllim që të garantohet një mjedis arsimor i duhur.
- Aktivitete mësimore jashtëshkollore për fëmijët e komuniteteve për të promovuar nxënien dhe përfshirjen sociale.
- Synimi i FPP-ve për trajnime kualifikuese të kërkuara nga projekti për të përmirësuar mundësitë e punësimit ose mundësitë për mjete jetese të qëndrueshme.

#### 4.4.4 Treguesit specifikë të performancës së programit

- Numri i shkollave të përmirësuara/zëvendësuara
- Shpërndarja e paketave të pajisjeve shkollore
- Numri i trajnimeve të kryera për personelin arsimor
- Numri i aktiviteteve jashtëshkollore të kryera dhe pjesëmarrësit në to
- Numri i personave të regjistruar në kurset profesionale (numërim specifik për PPP-të)
- Numri i FPP-ve që marrin një certifikatë të gjuhës angleze
- Numri dhe lloji i kurseve të ofruara

### 4.5 Plani për menaxhimin e fluksit

#### 4.5.1 Situata bazë

Kushtet infrastrukturore në luginën e Devollit janë relativisht të këqija. Nuk ka asnjë shenjë sigurie dhe disa prej fshatrave ndodhen në rrugët kryesore ose në afërsi të tyre. Zakonisht njerëzit duhet të kalojnë rrugën kryesore për të shkuar në institucionet lokale si, shkollat, qendrat shëndetësore dhe qendrat e komunës. Ekziston rreziku i rritjes së aksidenteve duke qenë se trafiku do të rritet në këto rrugë si pasojë e projektit.

Fluksi i punëtorëve dhe njerëzve të tjerë që përfitojnë nga mundësitë ekonomike mund të ketë ndikime negative në komunitetet lokale. Mund të ketë rritje të presionit në bazën e shërbimeve dhe burimeve për komunitetet e Devollit dhe të konkurrencës me personat e jashtëm. Kjo mund të krijojë tensione si dhe kriminalitet. Kërkesa ka të ngjarë të tejkalojë mallrat lokale dhe nevojat bazë të prodhuara ose të shitura në zonën e projektit. Kjo mund të shkaktojë inflacion dhe vështirësi ekonomike. Gjithashtu ka një problem të mundshëm me kriminalitetin, higjienën dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme (SST).

Do të ketë konkurrencë të fortë për vende pune në projekt. Problemi i vendeve të punës është ngritur vazhdimisht gjatë konsultimeve dhe DHP ka qenë aktiv me kurset e gjuhës dhe po punon me autoritetet dhe kontraktorët për të garantuar mundësi punësimi për vendasit. Sidoqoftë, do të jetë e nevojshme të garantohet punësim dhe të punohet për të siguruar vende pune dhe forcë punëtore me agjencitë e rekrutimit dhe kontraktorët.

Programi është hartuar për të shmangur ose minimizuar ndikimet potenciale që lidhen me fluksin e popullsisë rajonale dhe lokale në zonën e projektit, që mund të ndodhë si rezultat i ndërtimit të Projektit Hidroenergjetik të Devollit. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik rajonal dhe lokal është i rëndësishëm për

DHP-në dhe si rezultat Kompania po zhvillon masa specifike për të:

- Minimizuar dhe menaxhuar fluksin;
- Shmangur, minimizuar ose zbutur ndikimet e mundshme negative ekonomike ose sociale që mund të rezultojnë nga fluksi i popullsisë i nxitur nga projekti; dhe
- Optimizuar mundësitë për zhvillim ekonomik në të ardhmen. Lehtësuar rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve të prekura direkt dhe zgjerimin e zonës së influencës së projektit.

Projekti Hidroenergjetik i Devollit do të çojë në fluks të popullsisë për shkak të mbërritjes jo vetëm të forcës së konsiderueshme punëtore, por edhe të një numri të madh të mundshëm të punëkërkesve dhe të ofruesve të mallrave dhe shërbimeve. Afërsia e projektit me Elbasanin dhe Tiranën dhe rrjeti rrugor i përmirësuar, si edhe kultura e migrimit mund të çojë në rastin ku migrimi i brendshëm të rritet me 3 ose 4 herë (për çdo punëtor, 3 ose 4 persona të tjerë emigrojnë në zonë). Sidoqoftë, duke qenë se forca punëtore është vendosur brenda zonës së Devollit dhe përfitimet ekonomike bëhen të dukshme në komunat dhe fshatrat përreth, fluksi i popullsisë ka të ngjarë të ndodhë në të paktën zonat përreth zonës së ndërtimit.

DHP-ja e pranon se do të jetë e nevojshme të bashkëpunojë ngushtë me qeverinë qendrore dhe komunitetet rajonale dhe lokale, dhe të mbështesë autoritetet e komunave për të kuptuar përgjegjësitë e tyre dhe sfidat e lidhura me fluksin e popullsisë. Projekti do të ndryshojë strukturën mjedisore, ekonomike dhe sociale të asaj që sot është një zonë kryesisht rurale. Projekti është i angazhuar të përcaktojë dhe zhvillojë masat për të menaxhuar fluksin duke:

- Ndhimuar me rritjen e kapaciteteve për komunitetet lokale dhe organizmat qeveritarë për të zhvilluar aftësitë, produktet dhe shërbimet e tjera që mund të gjenden në vend;
- Maksimizuar elementin lokal në praktikën e prokurimit dhe punësimit, dhe duke mbështetur zhvillimin ekonomik rajonal;
- Ndhimuar në monitorimin e emigrimit të brendshëm të lidhur me projektin;

Qëllimi i masave të propozuara për të trajtuar ndikimet e mundshme të fluksit nga aktivitetet e lidhura me projektin. Plani zbatohet në zonën e influencës së projektit që përfshin komunat fqinje dhe merr në konsideratë ndikimet e mundshme pozitive dhe negative që lidhen me emigrimin e brendshëm të nxitur nga projekti, duke përfshirë:

- Ndikimin në vlerat kulturore lokale, qeverisjen dhe stilin tradicional të jetesës;
- Ndikimet e inflacionit në ekonominë familjare dhe lokale;
- Konfliktet për punësimin e lidhur me projektin;
- Mundësitë për furnizuesit;
- Rreziqet e rritura për shëndetin dhe sigurinë publike (duke përfshirë kriminalitetin e rritur ndaj njerëzve dhe pronës);
- Presionin e rritur mbi godinat sociale lokale, infrastrukturën dhe shërbimet qeveritare;
- Presionin e rritur mbi burimet ekzistuese të komunës (si, burimet ujore dhe kullotat);
- Emigrimin e mundshëm nga zonat e tjera duke menduar për mundësi më të mira;
- Rrezikun e rritur të konfliktit ndërmjet migruesëve dhe vendasve;
- Një pikëpamje të zgjeruar ndaj botës ndërmjet banorëve të zonës së projektit. Fluksi i “të ardhurve” do të ofrojë shumëllojshmëri në atë që sot është një zonë rurale e qetë dhe do të zgjerojë perspektivën dhe horizontet e vendasve;

- Rritjen ekonomike. Duke përmbushur nevojën e tyre për strehim, ushqim dhe nevoja të tjera, punëtorët dhe të ardhurit e tjerë të rinj do të kontribuojnë në nxitjen e një bume të zhvillimit ekonomik në zonë.

#### 4.5.2 Strategjitë për menaxhimin e fluksit

Strategjitë kyçe që do të adoptohen nga DHP në lidhje me kontraktorët e tyre për të reduktuar rrezikun e mundshëm të fluksit në shkallë të madhe përfshijnë, por nuk kufizohen me masat e mëposhtme:

##### 4.5.2.1 Rekrutimin lokal dhe menaxhimin e forcës punëtore

DHP po përpiqet që kontraktorët e saj të zbatojnë një sërë politikash dhe procedurash të burimeve njerëzore për të garantuar që elementi lokal të maksimizohet dhe që të përmbushen kërkesat e kontratës. Punësimi njerëzve vendas ose nga rajoni dhe zhvillimi i burimeve lokale të punës për të shmangur nevojën e importimit të një numri të madh të punëtorëve të jashtëm. Kjo ekuilibrohet nga rekrutimi lokal vetëm nga zyrat përkatëse të rekrutimit pa punësime të rastësishme dhe politika për minimizimin e punësimit shtesë nga personat e jashtëm për të shmangur migrimin spekulativ. Shoqëria është e angazhuar të investojë në trajnime afatgjata, bursa dhe programe stazhi për të garantuar që punëtorët kanë njohuritë dhe aftësitë që kërkon HEC-i i Banjës për shfrytëzimin e tij. Trajnimi do të fokusohet në fusha të tilla si, profesionet në ndërtim, profesionet në mekanikë, roje, gatim, aftësi sekretariale dhe të ngjashme me to. I gjithë rekrutimi dhe punësimi kryhet në përputhje me kushtet e ligjit në fuqi të punësimit në Shqipëri.

Synimet e mëdha të programit të rekrutimit dhe punësimit deri më tani duke qenë se lidhen me fluksin, janë:

- Maksimizimi i punësimit në nivel lokal dhe rajonal;
- Menaxhimi i ndërveprimit të punëtorëve të kampit me komunitetet; dhe
- Garantimi i përfaqësimit të barabartë të komuniteteve lokale dhe rajonale në rekrutimin për DHP-në

Aktualisht janë planifikuar për t'u vendosur masat e mëposhtme për të maksimizuar punësimin lokal dhe për të përhapur pikat e punësimit për të bërë përpjekje për minimizimin e punëkërkuesve spekulativ në zonën e ndërtimit të HEC-it të Banjës dhe në vendet e punës të lidhura me të nën përgjegjësinë direkte të kontraktorëve të ndryshëm të DHP-së në bashkëpunim të ngushtë me DHP-në:

1. **Punësimi i decentralizuar:** politikë për të mos punësuar në vendet e punës. Zyrat që merren me regjistrimin e vendeve të punës duhet të jenë funksionale përpara mobilizimit. Kontraktorëve dhe nënkontraktorëve gjithashtu u kërkohet ta ndjekin këtë politikë.
2. **Punësimi lokal si prioritet:** DHP-ja ka si qëllim t'i japë prioritet trajnimit, rekrutimit dhe punësimit të banorëve të komuniteteve lokale në zonën e prekur direkt nga zona e ndërtimit dhe rezervuari. DHP-ja është e përgatitur të ndihmojë komunat dhe autoritetet lokale për të përditësuar bazën e të dhënave lokale të aftësive (ka përfunduar sondazhi i përgjithshëm i aftësive si pjesë e sondazhit socio-ekonomik). Kjo listë i shpërndahet të gjithë kontraktorëve të përfshirë në ndërtim. DHP-ja ka për qëllim të monitorojë punësimin e banorëve lokalë dhe rajonalë.
3. **Identifikimi i vendasve:** Projekti po përpiqet të kufizojë migrimin e brendshëm spekulativ duke përjashtuar hapur nga punësimi në projekt njerëzit që lëvizin në zonën e projektit pa marrë oferta punësimi. DHP-ja ka një listë të banorëve vendas dhe të FPP-ve për t'i njohur të gjithë banorët në

atë pikë si njerëz vendas. DHP-ja është e angazhuar të punojë me qeverinë për të identifikuar çdo banor vendas shtesë nga migruesit të cilët kanë ardhur nga qytete tjera nëse lind nevoja.

4. **Publikimi i politikës së punësimit lokal:** DHP-ja do t'u kërkojë kontraktorëve të zbatojnë një strategji komunikimi si pjesë e procesit të tyre të angazhimit të komunitetit për të informuar gjerësisht për rregullat dhe procedurat e rekrutimit dhe punësimit në projekt, duke përfshirë punësimin preferencial për PPP-të. Këto fushatat ndërgjegjësimi duhet të vazhdojnë përgjatë ndërtimit të projektit dhe shfrytëzimit për të informuar vazhdimisht publikun mbi procedurat e rekrutimit të projektit përpara se punëkërkuarit spekulativ të vendosin të lëvizin drejt zonës.
5. **Transparencë në punësim:** Mundësitë për punësim reklamohen brenda komuniteteve lokale dhe procedurat e rekrutimit janë të ndershme dhe transparente. Autoritetet e komunave si edhe zyra e punësimit duhet të informohen për procesin e punësimit.
6. **Trajnimi i vendasve:** DHP-ja është e angazhuar të ndihmojë vendasit që të aplikojnë për vende pune, duke përfshirë ofrimin e trajnimit për vendasit për të kuptuar më mirë dhe për përballuar jetesën me anë të punësimit me bazë page, punësim i cili kërkohet për aktivitetet e ndërtimit. DHP-ja ka për qëllim t'i caktojë një pjesë të mundësive për trajnim direkt për PPP-të, si edhe për banorët nga secila prej 7 komunave të prekura direkt nga HEC-i i Banjës. Shoqëria ka për qëllim t'i ndihmojë vendasit në sigurimin e mundësive për trajnim për t'i pajisur ata me njohuri për të fituar vend pune në DHP dhe tek kontraktorët.
7. **Përhapja dhe ekuilibrimi i mundësive të punësimit:** Aty ku është e mundur DHP-ja do të ekuilibrojë punësimin me përzgjedhje nëpër fshatra me qëllim përhapjen dhe ekuilibrimin e ndikimeve pozitive në ekonomitë lokale dhe për t'u dhënë njerëzve shtysën që të qëndrojnë në fshatin e tyre të origjinës dhe për të shmangur kthimin e zonës së ndërtimit të Banjës në një magnet që "shpopullon" zonat përreth. DHP-ja do të monitorojë punësimin nga secili prej fshatrave.
8. **Angazhimi i komunitetit:** Kontraktorët do të kenë një punonjës të emëruar për marrëdhëniet me komunitetin për vendin e ndërtimit, i cili do të punojë në bashkëpunim me DHP-në dhe komunitetet lokale për çështje që lidhen me fluksin dhe të tjera që mund të lindin. Planet për angazhimin e komunitetit duhet të jenë të matshme dhe duhet të ketë një program të rregullt angazhimi me të gjitha fshatrat e zonës së projektit.

Në bashkëpunim me kontraktorin e saj kryesor DHP-ja është e angazhuar të zbatojë masat e mëposhtme për të minimizuar ndikimet e mundshme negative të kampeve të punëtorëve dhe punëtorëve në komunitetet lokale:

1. **Mekanizmi i Shqyrtimit të Ankesave:** Do të zbatohet një procedurë formale e mekanizmit të shqyrtimit të ankesave për të garantuar përgjigjen në kohë dhe transparente të ankesave nga komunitetet lokale;
2. **Arsimimi i punëtorëve:** Forca punëtore do të sensibilizohet për praktikatat kulturore dhe sociale lokale nëpërmjet ofrimit të një kursi prezantues për të gjithë punonjësit, kurs i cili përcakton mënyrën se si duhet të sillen punonjësit;
3. **Sjellja e punëtorëve në kamp:** Këto kërkesa do t'u ofrohen të gjithë punonjësve të projektit përpara fillimit të punës;
4. **Kodi i sjelljes së punëtorëve në komunitet:** Kompania do të përcaktojë disa udhëzime ndërmjet punëtorëve në kamp dhe komunitetit. Kodi i sjelljes në komunitet do të zhvillohet dhe zbatohet për të gjithë punëtorët. Në rastet kur këto rregulla nuk do të përmbushen do të merren masa disiplinore (ose do t'i kalohen policisë për ndjekje penale);
5. **Kushtet e punës:** Përcaktimi i kohëzgjatjes së kontratës, turneve dhe dhënies së lejeve të rregullta për personelin për të minimizuar mundësitë që punonjësit të përfshihen në sjellje të

papërshtatshme. Kontraktorët priten që të kenë përcaktuar rregulla ekuivalente dhe DHP-ja do të inspektojë kontraktorët; dhe

Pavarësisht nga sa u përmend më sipër, bashkëpunimi i përditshëm ndërmjet punëtorëve në kamp dhe komuniteteve lokale do të jetë i konsiderueshëm në periudha afatshkurtra deri në periudha afatgjata dhe do të kërkojë hartimin e politikave nga autoritetet e duhura. DHP-ja është e angazhuar të bashkëpunojë me policinë lokale për të arritur bashkërendimin për sigurinë dhe filozofinë e hartimit të politikave si dhe për praktikatat dhe procedurat.

#### 4.5.3 Qëllimi dhe veprimtaritë

- Fushata ndërgjegjësuere me shkollat dhe komunitetet për shëndetin dhe mjedisin si edhe për probleme dhe shqetësime që mund të lindin gjatë aktiviteteve të ndërtimit që përqendrohen në zona në afërsi me tokat e ndërtimit të projektit.
- Programi për sigurinë e transportit dhe të rrugëve do të hartohet në bashkëpunim me njësinë e shëndetit, sigurisë dhe të mjedisit (për t'u zbatuar nga ShSM-ja) për të sensibilizuar komunitetet përreth dhe drejtuesit e automjeteve të projektit mbi sigurinë e rrugëve. Ky do të monitorohet nga ShSM-ja dhe do të fokusohet në:
  - Rrugët me volum të madh trafiku gjatë fazës së ndërtimit
  - Shkollat dhe komunitetet në afërsi të rrugëve kryesore
- Ofrimi i paketave të sigurisë për shkollat dhe komunitetet Materiale fluoeshente, p.sh., byzylykë, jelekë, çanta shkolle me shirita fluoeshentë, do t'u shpërndahen fëmijëve të shkollave dhe anëtarëve të komunitetit.
- Ofrimi i ngadalësuesve të shpejtësisë dhe i pikave të kontrollit të trafikut afër fshatrave dhe shkollave duhet të koordinohet me inxhinierët e shoqërisë koncesionare dhe drejtuesit e DHP-së në bashkëpunim me kontraktorët dhe komunitetet lokale për të garantuar sigurinë në trafik.
- Ofrimi i ndihmës për agjencitë lokale të zbatimit të ligjit përgjegjëse për parandalimin e krimit dhe zbatimin e ligjit, duke përfshirë takime për shkëmbime informacioni dhe mbështetje të mundshme për kryerjen e patrullimit më të madh në zona specifike afër vendeve të ndërtimit të projektit dhe kampeve.
- Ofrimi i ndihmës për autoritetet lokale dhe komunitetet në hartimin e listave të punëtorëve të kualifikuar dhe të listave të aftësive për kontraktorët me synimin për të garantuar sa më shumë punësim lokal të jetë e mundur gjatë fazës së ndërtimit.
- Bashkëpunimi i ngushtë me kontraktorët për furnizimin e ushqimeve, materialeve dhe artikujve bazë që disponohen në vend në luginën e Devollit.
- Programe ndërgjegjësimi për Sëmundjet Seksualisht të Transmetueshme (SST-të), higjienën dhe probleme të tjera individuale që lidhen me shëndetin për kampet e ndërtimit, punëtorët dhe PPP-të që banojnë afër zonave të kampeve.

#### 4.5.4 Treguesit specifikë të performancës së programit

- Numri i studentëve dhe i banorëve të fshatit që kanë ndjekur fushatat e ndërgjegjësimit për shëndetin dhe sigurinë mjedisore
- Numri i paketave të sigurisë që i janë shpërndarë shkollave dhe komuniteteve
- Monitorimi i numri të krimeve të raportuara

- Monitorimi i shkallës së punësimit në nivel rajonal
- Numri i bizneseve të ngritura
- Vendosija e çmimeve në treg
- Nivelet e SST-së



## 5. PROGRAMET E MENAXHIMIT MJEDISOR

### 5.1 Situata aktuale dhe pamja e përgjithshme

Programi i menaxhimit mjedisor është procesi brenda njësisë së menaxhimit mjedisor dhe social të DHP-së, i cili ka detyrën e zhvillimit të masave zbutëse për të minimizuar ndikimet negative mjedisore nga zhvillimi i Projektit Hidroenergetik të Devollit. Menaxhimi mjedisor brenda kuadrit të DHP-së gjithashtu përfshin rekomandimet e caktuara në VNMS, duke ndjekur standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Siç është treguar edhe më parë, dokumenti i VNMS-së përmban një grup gjithëpërfshirës ndikimesh treguese dhe masash zbutëse që harmonizojnë standardet e performancës së IFC-së me legjislacionin aktual shqiptar, duke marrë parasysh dëshirën për hyrjen në Bashkimin Evropian dhe qeverinë shqiptare aktualisht në procesin e përmirësimit të standardeve të saj kombëtare për ta përbushur atë.

Në mënyrë më specifike, leja mjedisore (1107/1, datë 27 shkurt 2012) e lëshuar për DHP-në nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ( ) dhe ligji për “Heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes në ngastrat e ekonomive pyjore që pritet të përbyten nga rezervuarët e Banjës, Koklit dhe Moglicës” (4/2013, datë 31 janar 2013) ka vendosur kushtet që shoqëria është e detyruar të ndjekë.

Në këtë kontekst, menaxhimi mjedisor brenda kuadrit të DHP-së përfshin si aktivitete të tij kryesore:

- Monitorimin e hidrologjisë, sedimentologjisë dhe meteorologjisë
- Menaxhimin e rezervuarëve dhe cilësisë së ujit;
- Programin e pyllëzimit;
- Çështjet e përdorimit të ujit, me theks në kërkesat për ujitje;
- Kushtet mjedisore për aktivitete të përgjithshme ndërtimi (të mbuluara nga njësia HSE e DHP-së);

Konkluzioni përfundimtar i raportit të draft fizibilitetit të VNMS-së (Norconsult, mars 2010) u artikulua si vijon: “Që nga formulimi i raporteve të ekzaminimit të VNMS-së dhe raporteve të qëllimit të VNMS-së, skema e zhvillimit të Projektit Hidroenergetik të Devollit ka hartuar zgjidhje teknike që kanë reduktuar shumë ndikimet mjedisore dhe sociale”.

### 5.2 Baza

Të dhënat bazë të grumbulluara (dhe që do të grumbullohen) janë grupuar në bazë të llojit të aktiviteteve dhe ndikimeve që i shoqërojnë. Fazat e ndryshme varen nga programet e zbatimit, operimit dhe restaurimit që do të zbatohen.

1. Për momentin, nuk ka regjistrim historik të të dhënave të cilësisë së ujit të lumit Devoll. Për t’iu adresuar çështjeve në lidhje me sedimentet dhe cilësinë e ujit, DHP ka ngritur një laborator për matjen e parametrave fizike, ndërkohë që analizat (periodike) e parametrave kimike dhe biologjike do të kryhen jashtë këtij laborator. Për të plotësuar informacionin e monitorimit, duke përdorur burime të jashtme dhe të brendshme, të dhënat do të merren nga:
  - a. Testet laboratorike të kampionëve të ujit të marrë nga zonat e paracaktuara për marrjen e kampionëve, me qëllim monitorimin e parametrave fizike dhe biologjike të vendosura si tregues të ndikimeve.
  - b. Testet laboratorike në laboratorë të certifikuar (lokalë ose ndërkombëtarë), të cilat nuk mund të kryhen nga laboratorit brendshëm të DHP-së.

- c. Përfitimi i të dhënave nga institucione të tjera rajonale ose kombëtare, të cilat janë përgjegjëse për monitorimin e cilësisë së ujit, siç është Instituti Rajonal i Shëndetit, Agjencia Rajonale e Mjedisit etj.
  2. Të dhënat hidrologjike, sedimentologjike dhe meteorologjike. DHP ka marrë informacione historike nga qeveria shqiptare, por këto kanë nevojë për përditësim të vazhdueshëm në mënyrë që të sigurohet informacion i saktë, me të cilin mund të vazhdohet për të menaxhuar ndonjë përmbytje të mundshme gjatë ndërtimit, si edhe për të krijuar bazën dhe për të ndihmuar në fazën e operimit.
    - a. Do të ketë dy lloje të dhënash që do të grumbullohen në lidhje me hidrologjinë, sedimentologjinë dhe meteorologjinë: të dhëna periodike dhe sezonale.
      - i. Të dhënat periodike do të grumbullohen nga stacionet fikse të matjeve në terrenet përfaqësuese. Stacionet ekzistuese dhe të reja të matjeve do t'i transmetojnë të dhënat në një server, i cili do të mbushë automatikisht bazën përkatëse të të dhënave. Procedurat e kontrollit të cilësisë së të dhënave do të përcaktohen përpara përdorimit të të dhënave të grumbulluara për ndonjë llogaritje.
      - ii. Të dhënat sezonale do të grumbullohen në zonat e caktuara. Këto të dhëna do të përfshijnë më së shumti rezultatet që dalin nga testet laboratorike. Laboratori është një ofrues thelbësor të dhënash, veçanërisht në lidhje me sedimentologjinë, e cila në vijim është e rëndësishme për faunën ujore, pritshmërinë e jetëgjatësisë së rezervuarëve dhe operimin dhe mirëmbajtjen.
    - b. Rastet e përmbytjeve në rrjedhën e sipërme dhe rrjedhën e poshtme do të monitorohen në detaje të mëtejshme për t'u analizuar dhe do të propozohen procedura/masa zbutëse.
    - c. Të dhëna të tjera kombëtare do të mblidhen nga institucionet përkatëse kombëtare ose ndërkombëtare.
  3. Të dhënat e pyjeve janë mbledhur dhe detyrimi i DHP-së për të shpyllëzuar dhe ripyllëzuar janë përcaktuar në ligjin nr. 4/2013, datë 31.01.2013.
  4. Procedurat operacionale dhe kushtet teknike të aktiviteteve që mund të ndikojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, në kushtet mjedisore të zonës së pellgut ujëmbledhës. Bazuar në studime të mëtejshme ose në informacionet e mbledhura, vendimet do të merren në bazë të metodës dhe masave zbutëse më të përshtatshme. Aktivitete të tilla mund të përfshijnë:
    - a. Pylltarinë
    - b. Erozionin
    - c. Trajtimet e ujërave të ndotura
    - d. Sistemet e kanalizimit të ujërave të zeza
    - e. Sistemet vaditëse
    - f. Menaxhimin e mbetjeve urbane
  5. Rast pas rasti, do të mblidhen të dhëna dhe mund të kryhen studime të mëtejshme në lidhje me ndikime të tjera të mundshme në mjedis dhe në zonat e mbrojtura brenda zonës së pellgut ujëmbledhës. Ndikimet e mundshme do të monitorohen dhe të dhënat do të analizohen/krahasohen periodikisht (nga burimet e brendshëm ose nëpërmjet ekspertizave jashtë kompanisë) në lidhje me zonat e mundshme të ndikimit nga:
    - a. Ushtria
    - b. Industria
    - c. Bujqësia

- d. Urbanizimi
  - e. Të tjera.
6. Nëpërmjet procesit të GIS-it, do të përgatiten hartat tematike për t'i ardhur në ndihmë të gjitha nevojave të MMS-së. Përgatitja e hartave do të mbështetet edhe nga një bazë të dhënash me strukturë të plotë me referencë gjeografike dhe do të hartohen tabela dhe raporte specifike në ndihmë të përdorimit dhe monitorimit të të dhënave.

Nr	Treguesit / Ofruesi	Laboratori DHP	Laboratori i Specializuar	Geveria Shqiptare (Ministria)	Pushteti Vendor	Institucione / Agjenci Rajonale	Institucione / Agjenci Kombëtare	Institucione Ndërkombëtare	Stacionet fikse të DHP -se	Matjet në terren në pika të përcaktuara	Matjet në terren në pika ras	Vëzhgime në Terren	Raporte / Studime nga eksperte	OJF	GIS	Supervisorët	Kontraktoret
1	Cilësia e ujit	X	X			X	X			X						X	X
2	Hidrologjia						X		X	X							
3	Meteorologjia						X		X								
4	Sedimentologjia	X	X				X			X						X	X
5	Përmbytjet						X		X	X	X					X	X
6	Pyjet					X	X					X					
7	Erozioni						X					X	X			X	X
8	Ujërat e Zeza	X	X		X	X					X	X	X			X	X
9	Kanalizimet	X	X		X	X					X	X	X			X	X
10	Ujitja		X		X	X					X	X	X				
11	Mbetjet Urbane		X		X	X						X	X			X	X
12	Ndotja nga Ushtria			X								X	X	X			
13	Ndotja nga Industria			X								X	X	X			
14	Ndotja nga Bujqësia			X								X	X	X			
15	Urbanizimi			X								X	X	X			
16	Hartezimi			X	X	X	X	X							X		

Tabela 18: Pamje e përgjithshme e burimeve të të dhënave bazë

### 5.3 Profil i përgjithshëm mjedisor i projektit

Projekti është grupuar në bazë të HEC-eve (Banjë, Kokël dhe Moglicë). Një përshkrim i shkurtër i secilit pellg ujëmbledhës të HEC-eve do të japë një tregues të shtrirjes së problemeve mjedisore. Studime të detajuara do të kryhen për problemet mjedisore në mënyrë që të zëvendësohen përshkrimet e përgjithshme dhe rekomandimet e përfshira në VNMS dhe vlerësimet e përgjithshme të ndikimeve të kryera gjatë fazës së planifikimit.

Ndryshimet në mjedisin ujqor si pasojë e devijimit të ujit dhe regjimit të modifikuar hidrologjik në disa pjesë të lumit Devoll. Cilësia e ujit në basen është në përgjithësi e mirë dhe në përputhje me rekomandimet e BE-së për sa i përket cilësisë së ujit të pijshëm dhe shkarkimit të ujërave të ndotura. Hedhje të pakontrolluara të mbetjeve të ngurta dhe të mbetjeve të tjera të grumbulluara gjenden gjithandej në pellgun ujëmbledhës. Është e pritshme që mbetjet të hyjnë në përrenj dhe

lumenj, gjë e cila do të shkaktojë përkeqësimin e panoramës së rrymave ujore. Për më tepër, kjo mund të krijojë edhe probleme për funksionimin e HEC-eve.

Është identifikuar një total prej 10 speciejsh peshqish, asnjëra prej të cilave nuk konsiderohet e rrallë. VNMS gjithashtu thekson raportime të pakonfirmuara troftash në pjesët e lundrueshme të rrjedhës së sipërme dhe ngjala në zonën e rrjedhës së poshtme të digës së Banjës.

Për detaje të mëtejshme, është hartuar një bazë e gjerë të dhënash biologjike të zonës së pellgut ujëmbledhës të Devollit dhe një klasifikim i ndikimeve, të cilat janë raportuar në raportin përfundimtar të VNMS-së.

### 5.3.1 HEC-i Banjë

Meqë HEC-i i Banjës është ndikimi fillestar i projektit, mbledhja e të dhënave vazhdon më tej për ndikimet e mundshme në zonën e pellgut të tij ujëmbledhës. Ka një përkeqësim të treguesve (nivel ndikimi) e cila bazohet kryesisht në urbanizim dhe industri. Zona e pellgut ujëmbledhës ndahet ndërmjet qytetit të Gramshit, si zona më e urbanizuar, dhe njësisive të tjera vendore me popullsi më pak të dendura.

Qyteti i Gramshit, si zona kryesore e urbanizuar, konsiderohet faktori kryesor ndikues, veçanërisht në cilësinë e ujit në lumin e Devollit dhe në rezervuarin e Banjës. Problemet kryesore mjedisore të qytetit të Gramshit janë: 1) mungesa e menaxhimit të mbetjeve; 2) mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura; 3) sistemi i amortizuar i kanalizimeve të ujërave të zeza; 4) mungesa e infrastrukturës së duhur në zonën e sapo urbanizuar aty pranë; 5) menaxhimi i mbetjeve mjekësore; 6) ndotja (e mundshme) industriale;

Problemet e mbetura mjedisore në zonën e pellgut ujëmbledhës: 1) Pyllëzimi (ripyllëzimi/shpyllëzimi i paplanifikuar); 2) Erozioni, për shkak të braktisjes së tokës ose të shpyllëzimit; 3) Ujitja (ndotja e mundshme, mungesa e menaxhimit të duhur të burimeve); 4) Menaxhimi i mbetjeve (urbane dhe nga ndërtimi); 5) Ndotja (e mundshme) bujqësore; 6) Përmirësimi i ujërave të ndotura (rikonstruksioni i gropave septike ose rrjeteve të vogla);

Në zonën e pellgut ujqor ndërmjet Banjës dhe Koklit gjenden disa uzina ushtarake dhe objekte të tjera ushtarake të cilat mund të konsiderohen si rrezik i mundshëm për mjedisin. Fillimi i ndërtimeve mund t'i shtyjë investuesit të rihapin disa prej uzinave me teknologji të vjetër/fermave në pellgun ujëmbledhës, gjë e cila mund të jetë rrezik i mundshëm për mjedisin.

### 5.3.2 HEC-i Kokël

HEC-i i Koklit ka një zonë shumë të vogël të pellgut ujëmbledhës midis digës së tij dhe digës së Moglicës. Zona e pellgut ujëmbledhës është në përgjithësi me popullsi të ulët. Gjithsesi, mund të ketë disa ndikime në mjedis, të tilla si: 1) Pyllëzimi (ripyllëzimi/shpyllëzimi i paplanifikuar); 2) Erozioni, për shkak të braktisjes së tokës ose të shpyllëzimit; 3) Menaxhimi i mbetjeve urbane; 4) Përmirësimi i ujërave të ndotura (rikonstruksioni i gropave septike ose rrjeteve të vogla).

Ekzistojnë disa objekte ushtarake dhe disa uzina/ferma të braktisura, edhe pse për momentin nuk duken të kenë ndikim në mjedis.

### 5.3.3 HEC-i Moglicë

HEC-i Moglicë zë pothuajse gjysmën e pellgut ujëmbledhës të projektit. Edhe pse pranë rezervuarit zona e pellgut ujëmbledhës nuk është shumë e urbanizuar, në rrjedhën e sipërme gjenden disa qendra të mëdha urbane si qyteti i Korçës, Maliqit dhe Bilishtit dhe gjithashtu konsiderohet si një nga zonat më prodhimtare të Shqipërisë me më shumë se 40 000 ha tokë bujqësore (duke përfshirë kënetën e Maliqit). Diga e Moglicës në rrjedhën e sipërme të lumit Devoll përdoret si

grumbulluesi kryesor për kullimin e të gjitha tokave të punueshme dhe si i ujërave urbane. Gjithashtu, Korça është një ekonomi në zhvillim të shpejtë me potencial të madh industrial që do të zhvillohet më tej në të ardhmen.

Këtu, problemet mjedisore përfshijnë: 1) Pyllëzimin (ripyllëzimi/shpyllëzimi i paplanifikuar); 2) Erozionin, për shkak të braktisjes së tokës ose të shpyllëzimit; 3) Ujitjen (ndotja e mundshme, mungesa e menaxhimit të duhur të burimeve); 4) Menaxhimin e mbetjeve (urbane, nga ndërtimi dhe industria); 5) Ndotjen bujqësore; 6) Ujërat e ndotura (duke marrë parasysh ndarjen në zona rurale dhe urbane); 7) Mungesën e infrastrukturës në zonat e afërta të sapo zhvilluara urbane; 8) Ndotjen industriale (duke përfshirë minierat); 9) Shkatërrimin e mbetjeve mjekësore; etj.

#### 5.4 Arsyetimi dhe qasja

Është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet aktiviteteve të ndryshme që duhet të kryhen sipas Programit të menaxhimit mjedisor të DHP-së, duke përfshirë zbatimin e masave të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta zbutëse. Qëllimi është të minimizohen ndikimet e projektit si në mjedis ashtu edhe në komunitet dhe të merren masat zbutëse më të përshtatshme për kushtet e pellgut ujëmbledhës së Devollit.

Ndërhyrjet indirekte kryesisht kanë për qëllim të krijojnë një qasje të qëndrueshme në bashkëpunim me grupe të tjera interesi, për të siguruar përgjegjësinë e të gjitha palëve për programet që janë caktuar. Kjo do të bëhet jo vetëm nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit, por edhe nëpërmjet ndihmës që do t'u jepej grupeve të interesit për të përgatitur dhe zbatuar plane specifike menaxhimi në lidhje me çështje të tilla si pyllëzimi, mbetje, kanalizimi i ujërave të zeza, menaxhimi i ujërave, qasja Eco-profit etj.

Përparësi do t'i jepet trajtimit të ujërave të ndotura dhe kanalizimit të ujërave të zeza, menaxhimit të mbetjeve (urbane, nga ndërtimi dhe bujqësia, etj.), ujitjes në rrjedhën e poshtme etj. DHP nuk do të kërkojë marrjen e pronësisë, por do të bashkëpunojë me pronarin e infrastrukturës (institucionet e shtetit Shqiptar) për të arritur zgjidhjet më të përshtatshme.

Qasjet do të marrin në konsideratë nxitjen dhe pjesëmarrjen aktive të të gjithë banorëve përkatës të zonës së projektit. Kjo përfshin jo vetëm takime dhe konsultime, por edhe rritjen e kapaciteteve dhe trajnime. Synimi është të ndërgjegjësohet popullsia në lidhje me mjedisin, në mënyrë që ata të bëhen vëzhguesit kryesorë të kërcënimeve ndaj mjedisit dhe aktorë në aktivitetet lidhur me mjedisin.

Do të caktohet një program monitorimi për këtë çështje dhe do të merren parasysh masat zbutëse sipas nevojave dhe rezultateve. DHP do të lejojë shkarkimin e rrjedhës në mjedis (rrjedha minimale) që do të luhatet në kufirin 1-2 m<sup>3</sup> dhe që përputhet me praktikën më të mira inxhinierike për të zbutur ndikimet e mundshme.

Programi i higjienës, mbetjeve dhe kanalizimit të ujërave të zeza është në zhvillim në bashkëpunim me qeverinë shqiptare (në nivel NJQV-je dhe kombëtar).

#### 5.5 Kuadri organizativ me grupe të ndryshme interesi

Siç u përmend edhe më sipër, programi i menaxhimit mjedisor është i lidhur ngushtë me grupet e tjera të interesit. Ai nuk mund të mendohet si një projekt i drejtuar vetëm nga DHP, duke përjashtuar pjesëmarrjen aktive të grupeve të interesit. Sistemi i hartuar ka përgjegjësi dhe angazhime të qarta për secilin grup interesi, duke përfshirë DHP-në. Kjo përfshin në veçanti institucionet rajonale që duhet të zbatojnë dhe të menaxhojnë më tej programin e investimeve direkte të DHP-së. Grupi institucional i punës (GIP), i cili është caktuar tashmë me anëtarë nga sektorë të ndryshme të qeverisë dhe të DHP-së, do të përdoret si koordinatori kryesor i aktiviteteve

të grupeve të interesit. Rekomandohet që të merret parasysh krijimi i një grupi cilësor institucional pune i caktuar për ndërhyrjet e DHP-së.

Ekipi i menaxhimit mjedisor do të punojë së bashku me pronarët e infrastrukturës dhe me komunitetin për të diskutuar dhe për të rënë dakord rreth të gjitha hapave përpara ndërhyrjeve direkte në infrastrukturë. Hapat më të rëndësishëm të programit duhet të paraqesin: 1) interes të vërtetë në ndërhyrje; 2) angazhim për të bashkëpunuar me DHP-në; 3) interes në zhvillimin dhe ndjekjen e planeve afatmesme dhe afatgjate në lidhje me ndërhyrjen specifike me kontributet e përshtatshme homologe. Meqë DHP nuk do të kërkojë pronësinë e infrastrukturës, pronarët duhet të angazhohen se do të marrin pjesë në projektim, mbikëqyrje dhe dorëzimin e investimit direkt.

Angazhimi i qeverisë vendore do të shprehet nëpërmjet planifikimit dhe miratimit të buxhetit për programet që përfshijnë investime direkte nga DHP. Programi ka për qëllim të rrisë në maksimum burimet e tij të kufizuara financiare nëpërmjet zgjidhjes së përshtatshme efikase që përfshin pjesëmarrjen vullnetare dhe financiare të grupeve të interesit si institucione ose si individë. Programi i menaxhimit mjedisor ka për qëllim të garantojë këtë lloj përfshirjeje përpara dhe gjatë investimeve direkte në infrastrukturën përkatëse.

## **5.6 Menaxhimi i rezervuarëve, cilësia e ujit dhe ekologjia ujore**

### **5.6.1 Hidrologjia, meteorologjia dhe sedimentologjia**

#### **5.6.1.1 Baza**

Pellgu ujëmbledhës i Devollit gjendet në një zonë të shumëllojshme për sa i përket urbanizimit, klimës, lartësisë, të cilat përbëjnë sfidë për çdo program monitorimi. Hidrologjia, meteorologjia dhe sedimentologjia do të menaxhohen së bashku. Për monitorimin e cilësisë së ujit do të përdoret edhe laboratorit i ngritur i hidrologjisë.

Pavarësisht se DHP ka matje historike hidrologjike dhe tre stacione të automatizuara matjesh, këto të dhëna duhet të përditësohen vazhdimisht dhe ndryshimet dhe parashikimet hidrologjike duhet të rregullohen përkatësisht. Për të ngritur një sistem hidrologjik (rrjedhjes së ujit), duhet të mblidhen edhe të dhënat nga stacionet meteorologjike. Kjo do të bëjë të mundur që grupi i hidrologjisë të bëjë matje më të sakta për pellgun ujëmbledhës të Devollit. Lumi i Devollit ka ngarkesë të madh sedimentesh, gjë e cila do të kërkojë monitorim të kujdesshëm për të përcaktuar më vonë masat e nevojshme zbutëse.

Këto procese duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të jenë të qëndrueshme për kohëzgjatjen e projektit (ndërtimi dhe operimi).

#### **5.6.1.2 Qëllimi dhe veprimtaritë**

Qëllimi është të krijohet dhe të vlerësohet sistemi i parashikimit të rrjedhjes së ujit; Të ndihmohet grupi i ndihmës së shpejtë dhe i sigurisë me të dhëna dhe parashikime në kohë reale. Të përgatitet parashikimi më i mirë i mundshëm hidrologjik për t'u përdorur nga grupi i prodhimit. Të sigurohen të dhënat e mbledhura gjatë monitorimit të sedimenteve, të sugjerohen masa zbutëse në lidhje me sedimentet dhe të analizohet përbërja mineralogjike në ujë, e cila mund të shkaktojë dëmtim të pajisjeve në hidrocentral.

Kjo do të arrihet nëpërmjet përmirësimit nga:

- Sigurimi i paralajmërimeve të hershme për ngjarjet ekstreme.
- Ngritja e stacioneve të përhershme të matjeve dhe të monitorimit meteorologjik në zonën e pellgut ujëmbledhës të Devollit dhe vlerësimi i mbledhjes së të dhënave në kohë reale.

- Hartimi i protokolleve laboratorike dhe të testimeve për të marrë të dhëna të besueshme që të përmbushen standardet ndërkombëtare dhe pritshmëritë nga operatorët e DHP-së. Kjo përfshin analizën e parametrave kimike dhe fizike.
- Krijimi i një programi monitorimi afatgjatë që përfshin monitorimin dhe parashikimin e motit, ujit dhe sedimenteve.
- Ngritja e një baze të dhënash për modelin e hidrologjisë me informacione nga GIS-i dhe parashikimet e motit.
- Ngritja e një baze të dhënash rreth topografisë/batimetrisë së rezervuarëve në lidhje me vlerësimin e sedimenteve
- Vënia në dispozicion e të dhënave për agjencitë lokale për monitorimin dhe bashkëpunimin me institucionet lokale dhe ndërkombëtare (siç kërkohet).
- Fuqizimi i bashkëpunimit me organizatat e interesuara shkencore, lokale ose ndërkombëtare
- Plotësimi i kërkesave ligjore të rregullores për sigurinë e digave
- Sugjerimi (nëse ka) i masave teknike për të zbutur rreziqet e mundshme.

Të gjitha këto aktivitete do të ndahen në njësi të detajuara vjetore pune (në formën e planit vjetor të zbatimit ose të dokumenteve të tjera specifike të aktiviteteve) për të paraqitur një ndarje të qartë të aktiviteteve, buxhetit dhe programit.

#### 5.6.1.3 Mbledhja e të dhënave hidrologjike, meteorologjike dhe sedimentologjike

Të dhënat do të mblihen në zonat e caktuara përfaqësuese. Siç mund të dallohet në hartë, do të mblihen dy lloje të dhënash në lidhje me hidrologjinë, sedimentologjinë dhe meteorologjinë: të dhëna periodike dhe të dhëna sezonale.

Të dhënat sezonale do të mblihen në zonat e caktuara përfaqësuese. Këto të dhëna do të përfshijnë më së shumti rezultatet që dalin nga testet laboratorike.

	Hidrologjia	Sedimentologjia	Meteorologjia
	Rrjedha	Turbullira	Shiu
Periodike në stacionet fikse të matjeve	Temperatura e ujit		Dëborë
	Temperatura e ajrit		Temperatura
	Thellësia e ujit		Lagështira
Sezonale në zonat e caktuara	Rrjedha	Turbullira	
	Temperatura e ujit	Sediment lundruar	
	Temperatura e ajrit	Sediment i dekantuar	
	Thellësia e ujit	Studime topografike	
Të nxjerra nga laboratorit		Madhësia e grimcës	
		Turbullira	
		Sediment i mbetur pezull	
		Sedimentet në total	

Tabela 19: Testimet laboratorike

Pajisjet kryesore në lidhje me marrjen e kampionëve hidrologjikë, meteorologjikë dhe sedimentologjikë.

	Hidrologjia	Sedimentologjia	Meteorologjia
Stacionet e matjeve	Termometër ajri	Matës i turbullirës	Matës shiu
	Termometër uji		Matës dëbore
	Presioni i ujit (thellësia)		Termometër ajri
			Matës lagështie
Sezonale në zonat e caktuara	Matës i rrymës	Matës i turbullirës	
	Termometër ajri		
	Termometër uji		
	Aparat matës		
Të nxjerra nga laboratorit		Filtër (mikro/makro)	
		Matës i turbullirës	
		Peshore elektronike	
		Peshore	

Tabela 20: Pajisjet laboratorike

Siç duket, laboratorit është një ofruer thelbësor të dhënash, veçanërisht në lidhje me sedimentologjinë, e cila në vijim është shumë e rëndësishme për faunën ujore, pritishtërinë e jetëgjatësisë së rezervuarëve dhe operimin dhe mirëmbajtjen.

#### 5.6.1.4 Rezultatet specifike të programit

- Raport mujor, gjashtëmujor dhe vjetor i hidrologjisë, meteorologjisë dhe sedimenteve, duke përfshirë të dhëna sasiore dhe cilësore
- Raport vjetor i vlerësimit të rrezikut, duke përfshirë rreziqet dhe zgjidhjet e mundshme
- Zbutja e përmbytjeve me anë të paralajmërimeve të hershme
- Përdorimi operacional i ujit / Parashikimet për prodhimin e energjisë

### 5.7 Menaxhimi i rezervuarëve: cilësia e ujit dhe biodiversitetit

#### 5.7.1 Cilësia e ujit

Qëllimi i monitorimit të cilësisë së ujit është të jepen informacione treguese për të garantuar që nuk ka ndikime të rënda si edhe për të mundësuar cilësinë e mjaftueshme për qëllime ujitjeje nga krijimi i 3 rezervuarëve. Kjo gjithashtu do të sigurojë të dhëna për të konfirmuar që nuk ekzistojnë rreziqe shëndetësore për popullsinë, biodiversitetin dhe bagëtitë.

Cilësia e ujit do të matet periodikisht dhe në përputhje me standardet evropiane kuadër për ujin si edhe me standardet e vendosura kombëtare shqiptare. Këto parametra janë si vijon:

Parametri	Simboli	Njësia	Metoda	Vendndodhja	Shpeshtësia
Temperatura e ajrit	T <sub>air</sub>	°C	SM 2550 B	Në terren	Mujore
Temperatura e ujit	T <sub>water</sub>	°C	SM 2550 B	Në terren	Mujore
pH	pH		SM 4500 –H B	Në terren	Mujore



Parametri	Simboli	Njësia	Metoda	Vendndodhja	Shpeshtësia
Oksigjeni i tretur	DO	mg/l	SM 4500-O G (Sondë)	Në terren	Mujore
Oksigjeni i ngopjes	Sat O <sub>2</sub>	%	Sondë YSI	Në terren	Mujore
Përqendrimi i nitritit + nitratit	NO <sub>2</sub> + NO <sub>3</sub>	mg/l	SM 4500-NO3 E	Në laborator	Tremujore
Përqendrimi total i azotit	Tot – N	mg/l	SM 4500-Norg (Macro-Kjeldahl)	Në laborator	Mujore
Përqendrimi i ortofosfatit	PO <sub>4</sub> – P	mg/l	SM 4500 – P E	Në laborator	Tremujore
Përqendrimi total i fosforit	Tot – P	mg/l	SM 4500 – P B+E	Në laborator	Mujore
Përbërjet totale organike	Tot – C	mg/l	SM 4500 – P B+E	Në laborator	Mujore
Nevoja kimike për oksigjen	COD	mg/l	Metoda permanganatit e	Në laborator	Mujore
Nevoja biologjike për oksigjen	BOD	mg/l	Metoda permanganatit e	Në laborator	Mujore
Baktere koliforme nxehtësi-duruese	TCB	nr/100 ml	SM 9222 B (Filtër me cipë)	Brenda 24 orëve	Mujore
Alkaliniteti (si CaCO <sub>3</sub> )	Alk	mmol/L	SM 2320 B	Në laborator	Mujore
Përqendrimi i kalciumit	Ca	mg/l	SM 3500 – Ca-B	Në laborator	Tremujore
Përqendrimi i magnezit	Mg	mg/l	SM 3500 – Mg-B	Në laborator	Tremujore
Përqendrimi i natriumit	Na	mg/l	SM 3.111 B	Në laborator	Tremujore
Përqendrimi i kaliumit	K	mg/l	SM 3.111 B	Në laborator	Tremujore
Përqendrimi i klorit	Cl	mg/l	SM 4500 – Cl C	Në laborator	Tremujore
Përcjellshmëria elektrike	EC	Ms/m	SM 2519	Në terren	Mujore
Totali i lëndëve të ngurta pezull	TSS	mg/l	SM 2540 D	Në laborator	Mujore
Klorofil a	Ch-a	Ms/m	Nxjerrje acetoni/ spektrofometër	Në laborator	Mujore (verë)
Alumin	Al	µ/L	TBD	Në laborator	Tremujore
Plumb	Pb	µ/L	TBD	Në laborator	Tremujore
Kadmium	Cd	µ/L	TBD	Në laborator	Tremujore
Magnez	Mg	µ/L	TBD	Në laborator	Tremujore
Arsenik	Ar	µ/L	TBD	Në laborator	Tremujore
Krom	Cr	µ/L	TBD	Në laborator	Tremujore
Merkur	Hg	µ/L	TBD	Në laborator	Tremujore
Nikel	Ni	µ/L	TBD	Në laborator	Tremujore
Zink	Zn	µ/L	TBD	Në laborator	Tremujore
Bakër	Cu	µ/L	TBD	Në laborator	Tremujore

Tabela 21: Parametrat e monitorimit

Sasia e kampionëve do të rregullohen në bazë të shpeshtësisë së nevojshme. Në rastin pas përmytjes (mbushjes së rezervuarëve), matjet e cilësisë së ujit do të ripërcaktohen që të përfshijnë thellësitë. Marrja e kampionëve do të kryhet nga DHP për parametrat fizike në terren dhe për parametrat kimike në laboratorin që do të përcaktohet. Do të kryhen teste të njëpasnjëshme për të siguruar cilësinë.





Figura 18: Vendet e marrjes së kampionëve dhe stacionet e matjeve në Banjë



Figura 19: Vendet e marrjes së kampionëve dhe stacionet e matjeve në Kokël



**Figura 21: Vendet e marrjes së kampionëve dhe stacionet e matjeve në Moglicë**

### 5.7.1.1 Monitorimi i ekologjisë ujore

Do të vendoset një program monitorimi duke u përpjekur të identifikohen tendencat ekzistuese dhe vijuese në mjedisin ekologjik ujor në pjesët përkatëse (përfshirë rrjedhën e poshtme) të zonës së pellgut ujëmbledhës gjatë fazës së ndërtimit dhe të operimit. Është vendosur një bazë si pjesë e VNMS-së. Do të vendoset marrja mujore dhe tremujore e kampionëve me metoda cilësore dhe sasiore (aty ku është e aplikueshme) për fitoplanktonet, zooplanktonet, bentosin dhe peshqit – në mënyrë që të përftohen të dhëna kohore të besueshme që shërbejnë edhe për ndryshimet natyrore stinore. Do të përdoren të njëjtat pika si për cilësinë e ujit dhe pas grumbullimit të ujit në rezervuar do të merren kampionë në thellësi të ndryshme uji në rezervuar. Më tej, do të përcaktohen pika për marrjen e kampionëve në rrjedhën e poshtme të digës së Banjës drejt rezervuarit të Thanës.

Programi i monitorimit ka për qëllim të vlerësojë situatat aktuale dhe tendencat e reja në përbërjen e specieve dhe speciet invazive (nëse ka). Do të hartohet një raport vjetor i ekologjisë ujore nga pala e tretë, i cili vlerëson ndikimet e mundshme që kanë HEC-et e ndryshme në ekosisteme dhe do të sugjerojë zbutjen, nëse është e mundur.

Parametri	Metoda e marrjes së kampionëve	Njësia	Metoda laboratorike	Vendndodhja	Shpeshtësia
Fitoplankton	Rrjetë planktonesh	Vetëm cilësore	Numërim me mikroskop	Në laborator	Mujore (verë)
Zooplankton	Rrjetë zooplanktonesh	Vetëm cilësore	Numërim me mikroskop	Në laborator	Mujore (verë)
Fauna bentike	Rrjetë statike dhe dore	Gjysmësasiore	Kapje për njësi	Në terren dhe laborator	Tremujore
Peshqit	Rrjetë vertikale, grackë, peshkim me korrent	Cilësore dhe sasiore	Kapje për njësi	Në terren	Tremujore
Makrofitet	Mbledhje me dorë	Vetëm cilësore	-	Në terren	Vjetore

#### 5.7.1.1.1 Vëzhgimi i florës dhe faunës tokësore

Do të kryhen ekzaminime dhe vëzhgime vjetore të florës dhe faunës tokësore. Kjo nuk do të bëhet me anë të një programi të marrjes së shpeshtë të kampionëve, por do të bazohet në vizita sezonale në terren dhe më pas do të bazohet në informacionet ekzistuese dhe në vëzhgimet e kryera nga autoritetet mjedisore dhe njerëzit nga zonat përkatëse, të cilët kanë njohuri të gjera për vendin. Një

vlërësim vjetor do të përgatitet nga një subjekt i kualifikuar. Tendencat dhe ndikimet nga projekti do të raportohen dhe do të sugjerohen masa të realizueshme zbutëse.

## **5.7.2 Menaxhimi i ujërave të ndotura dhe kanalizimit të ujëra të zeza**

### **5.7.2.1 Baza**

Zhvillimi urban i zonës pranë projektit të ardhshëm ka sjellë zënien e një sipërfaqeje më të madhe me ndërtime dhe në rritje të shkarkimeve të ujërave të ndotura dhe të zeza si rezultat i rritjes së popullsisë dhe të ndërmarrjeve tregtare. Si pasojë, sistemi aktuale i kanalizimit të ujërave të zeza nuk është gjendje të menaxhojnë rrjedhjen aktuale në mënyrë efikase. VNMS tregonë se cilësia e ujit në basen është në përgjithësi e mirë dhe në përputhje me rekomandimet e BE-së për sa i përket cilësisë së ujit të pijshëm dhe shkarkimit të ujërave të ndotura. VNMS thekson se nuk nevojitet të merren masa për të reduktuar ndikimin e ngarkesave të ndotësve nga ujërat e ndotura dhe/ose rrjedhjet e likiteve nga zonat industriale të tilla si minierat e braktisura dhe mbetjet e groposura. Në të njëjtën kohë, ekzistojnë ndikime të mundshme negative për shkak të kapacitetit të dobësimit në masat ujore grumbulluese. Këto deklarime duhet ende të konfirmohen me studime shtesë për të plotësuar me një bazë më të plotë dhe me një studim fizibiliteti përpara ndonjë ndikimi.

Një sistem kanalizimi i ujërave të zeza është ndërtuar përpara viteve '90 dhe sot sistemi nuk është plotësisht i mjaftueshëm dhe nuk mirëmbahet siç duhet në Gramsh. Po ashtu, në shumë zona rurale grumbullimi i ujërave të zeza nuk ekziston dhe gropat septike nuk janë të ndërtuara siç duhet në shumicën e rasteve. Në Gramsh ujërat e ndotura të qytetit mblidhen nga rrjedhja e lirë në pjesën veriperëndimore të qytetit, ku më pas shkarkimi bëhet nga rrjedhja e lirë në lumin e Devollit, pa asnjë trajtim.

Moglica në rrjedhën e sipërme të lumit Devoll është një zonë shumë e urbanizuar me shërbime ekzistuese të trajtimit të ujërave të zeza dhe të ujërave të ndotura. Deri më tani nuk pritet të ketë tregues të ndotjes së ujit nga këto vende. Në veçanti, rajoni i Korçës është një ekonomi në zhvillim të shpejtë me potencial të madh industrial që do të zhvillohet më tej në të ardhmen. Kjo zonë përdoret gjithashtu si grumbulluesi kryesor për të kulluar tokat e punueshme dhe për të mbledhur ujërat urbane.

Për sa i përket komuniteteve të fshatrave përreth rezervuarëve të ardhshëm, asnjëra nuk është e lidhur me rrjet të kanalizimit të ujërave të zeza, kështu që ujërat e ndotura shkarkohen drejtpërdrejt në kanalet e rrugëve ose në përrenjtë e afërt, ose në disa raste në gropa septike private. Vetëm fshatrat Cërujë dhe Pishaj janë të lidhur me rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza, por edhe kanali kryesor i shkarkimit të ujërave të ndotura i derdh ujërat e patrajuara në përrenjtë aty pranë.

### **5.7.2.2 Qëllimi dhe veprimtaritë**

Qëllimi i përgjithshëm i programeve të trajtimit të ujërave të zeza dhe ujërave të ndotura është të pakësohen ndikimet në cilësinë e ujit në rezervuarët e planifikuar me anë të ndërhyrjeve që sigurojnë shmangien e problemeve me cilësinë e ujit dhe zbutjen e tyre në mënyrë efikase, që rezervuari të ruajë cilësinë e pranueshme të ujit në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë. Në përpjekjen e saj për t'u pajtuar me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, DHP është angazhuar të kontribuojë në përmirësimin në këtë fushë në rast ndikimesh negative të projektit. Në rast ndikimesh negative, kjo do të bazohet në angazhimin serioz të autoriteteve lokale dhe kombëtare për të ndihmuar në gjetjen e zgjidhjeve më të

përshtatshme, si edhe për të kontribuar dhe për të marrë përsipër përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë për vazhdimin (pra, financimin, punimet dhe mirëmbajtjen në të ardhmen) e masave që duhet marrë për të siguruar qëndrueshmërinë. Kjo do të kryhet nëpërmjet veprimeve të mëposhtme, si:

- Kryerja e një vlerësimi të plotë të sistemit aktual brenda zonës së pellgut ujëmbledhës të Devollit
- Në rast ndikimesh negative, vlerësimi i teknologjive të propozuara për trajtimin e ujërave të ndotura dhe bërja e rekomandimeve për zgjidhje optimale (duke marrë parasysh treguesit e shëndetit);
- Ndihmë në identifikimin e partnerëve për rehabilitimin e sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe në bashkëpunimin me fermerët për të përmirësuar gropat ekzistuese septike ose për të ngritur rrjete të vogla.
- Zbatimi i programeve të ndërgjegjësimit për fshatarët, autoritetet dhe industrinë dhe ndërgjegjësimi për shëndetin e komunitetit;
- Monitorimi dhe vlerësimi.

#### 5.7.2.3 Treguesit specifikë të performacës së programit

- Reduktimi i sasisë së fosforit total dhe azotit total, përveç një uljeje në nevojën për oksigjen biologjik dhe në lëndët e ngurta pezull në marrës.
- Sasia e bakteve koliforme termotolerante (TBC) dhe e përbërjeve totale organike, e cila përmbush standardet e pranuar ndërkombëtare
- Përqindja (%) e komuniteteve me shkarkim të reduktuar të ujërave të zeza në komunitetet e tyre
- Përqindja (%) e sistemeve të kanalizimit të ujërave të zeza që përdoren dhe mirëmbahen siç duhet
- Rritja e numrit të familjeve me trajtim të ujërave të zeza




Figura 20: Zonat e derdhjes së ujërave të zeza dhe të mbetjeve (Banjë)

## 5.8 Menaxhimi i mbetjeve

### 5.8.1 Baza

Në luginën e Devollit, nuk ka sisteme të përshtatshme të menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Mbetjet grumbullohen në zona të caktuara depozitimit, të cilat janë vende të thjeshta hedhjeje mbeturinash. Në zonën e projektit (duke përfshirë Korçën, e cila ka një pikë të organizuar grumbullimi), pjesa tjetër bashkë me mbetjet e qytetit dhe fshatrave të Gramshit, hidhen zakonisht pa dallim në vendin më të afërt të disponueshëm, duke përfshirë përgjatë rrugëve, në brigjet e lumit dhe në vende të hapura në zonat me ndërtime, pavarësisht llojit.

Në Gramsh, mbetjet e grumbulluara hidhen pranë bregut të lumit në rrjedhën e poshtme të Gramshit (në veriperëndim të qytetit). Me sa raportohet, fshatrat nuk janë të mbuluara nga ndonjë shërbim komunal i menaxhimit të mbetjeve dhe si pasojë mbetjet hidhen në çdo vend të disponueshëm në fshatrat ose lokalitetet aty pranë. Gjithashtu, hedhja e paligjshme e mbetjeve nga ndërtimet ka krijuar ndikim shtesë mbi mjedisin. Nuk është e pazakontë hedhja e mbetjeve përgjatë shtratit të lumit dhe, meqë ato nuk hiqen, duhet një kohë e gjatë që të shpërbëhen dhe shtrati i lumit është i bllokuar për periudha të gjata kohore. Një pjesë e mbetjeve largohet gjatë prurjeve të mëdha të lumit Devoll.

Qeveria shqiptare është shumë e angazhuar për të vënë në zbatim të gjitha bazat ligjore sipas rekomandimeve të Komisionit Evropian. Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 është në përputhje me direktivën e Komisionit Evropian 2008/98/KE dhe për këtë arsye rekomandimet e Komisionit Evropian do të merren si baza për qasjen afatgjate në këtë proces.

### 5.8.2 Qëllimi dhe veprimtaritë

DHP e kupton nevojën për ta adresuar situatën e mbetjeve, të mungesës së planeve dhe të aktiviteteve të menaxhimit të mbetjeve, në bashkëpunim të ngushtë me komunitetet dhe autoritetet qeveritare. Kjo do të sigurojë mbrojtjen e aseteve të DHP-së dhe në të njëjtën kohë do të ruajë cilësinë e tokës dhe të ujit (të lumit, ujit nëntokësor dhe të rezervuarëve).

Ndërhyrjet për heqjen e mbetjeve janë planifikuar për zonat kryesore urbane dhe për zonat rurale përreth për të minimizuar ndikimin në cilësinë e ujit dhe në mjedis. Ekziston një nevojë e përcaktuar qartë për pastrimin e mbetjeve dhe të mbeturinave si një aktivitet i veçantë përpara mbushjes së rezervuarëve. Ndërkohë që kjo do të kryhet nga DHP, qëllimi është të ketë pjesëmarrje intensive të komunitetit dhe të grupeve të interesit.

Ndihmë e mëtejshme mund të jepet në bazë të angazhimit serioz të autoriteteve lokale dhe kombëtare për të ndihmuar në gjetjen e zgjidhjeve më të përshtatshme, si edhe për të kontribuar dhe për të marrë përsipër përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë për vazhdimin (pra, financimin, punimet dhe mirëmbajtjen në të ardhmen) e masave që duhet marrë për të siguruar qëndrueshmërinë. Duhet të vendoset një bashkëpunim i fortë me qeverinë qendrore/lokale dhe me agjencitë përkatëse dhe praktikant më të mira duhet t'u tregohen industrive lokale.

Studimi i terreneve me rreziqe të mundshme do të kryhet në bashkëpunim me të gjitha autoritetet dhe terrenet e dyshimta do të studiohen më tej për të vendosur mbi masat zbutëse. Një studim nga një palë e tretë duhet të kryhet sipas rastit.

Aktivitetet e tjera përfshijnë:

- Kryerjen e një vlerësimi të plotë të situatës aktuale të menaxhimit të mbetjeve dhe propozimin e alternativave dhe rekomandimeve që duhet të zbatohen për programet aktuale dhe afatgjata.
- Ndihmën në identifikimin e partnerëve për implementimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve.
- Mbështetjen dhe punën me qeverinë vendore dhe përfitues të tjerë lokalë për përgatitjen e planeve strategjike të pjesëmarrjes urbane (të fshatrave) për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë caktimin e një landfilli dhe/ose të një stacioni transferimi. Kjo do të përfshijë pikat e grumbullimit dhe heqjen në nivel fshati për asgjësimin e mbetjeve.
- Fuqizimin e kapacitetit të autoriteteve mjedisore në lidhje me menaxhimin e mbetjeve lokale dhe rajonale; kjo do të përfshijë programe ndërgjegjësimi për fshatarët, autoritetet dhe industrinë.
- Mbështetjen dhe lehtësimin e masave afatshkurtra me nismë lokale për reduktimin e rreziqeve në terrene;
- Monitorimin dhe vlerësimin.



### 5.8.3 Treguesit specifikë të performacës së programit

- Numri i familjeve që marrin pjesë në një sistem të organizuar të mbledhjes së mbetjeve.
- Numri i pikave të caktuara për mbledhjen e mbetjeve;
- Numri i koshave të mbeturinave sipas numrit të popullsisë;
- Zona e vendeve të paligjshme të pastruara të hedhjes së mbetjeve;
- Sasia në m<sup>3</sup> ose tonë e mbetjeve të ngurta të grumbulluara dhe të depozituara në landfillin lokal ose në stacionin e kalimit;
- Rregulloret lokale/planet/udhëzuesit/ligjet e botuara në tremujorin e 3-të të vitit 2013 e më pas.

## 5.9 Programi i pyllëzimit

### 5.9.1 Baza

Degradimi dhe erozioni i tokës janë identifikuar si probleme kryesore për luginën e Devollit. Toka që i është nënshtruar prerjes së pakontrolluar e të paligjshme të pyjeve dhe kullotjes është arsyeja kryesore për degradimin e zonave përreth, gjë e cila ka çuar në shpyllëzim. Kullotja e pa menaxhuar zhvesh tokën nga vegjetacioni kryesor që ka funksionin e mbajtjes së tokës të padëmtuar dhe redukton erozionin.

Projekti i pyllëzimit do të zbatohet bazuar në ligjin Shqiptar për pyjet nr. 4/2013, datë 31.01.2013, mbi tokat pyjore dhe kullotat komunale në pronësi të qeverisë shqiptare, por që jepen për përdorim komunal nëpërmjet të drejtave të uzufuktit për secilën komunë. Kështu, momentalisht shumë nga kullotat dhe pyjet komunale menaxhohen në bashkëpunim me komunat. Fermerët shpesh i kullojnë bagëtitë bashkërisht, sidomos në kullotat e larta dhe kjo organizohet në mënyrë joformale në nivele fshatrash.

Ligji kërkon që DHP të shpyllëzojë një zonë totale prej 1421,39 ha. që i përket ekonomisë së pyjeve dhe kullotave të Gostimës - Koprrik, Mollas, Galigat - Storrë, Gramsh - Vinë, Vidhan - Skënderbegas, Darëzezë - Sult dhe Dushk i Bulçarit i rrethit të Elbasanit, gjithashtu Lavdar - Opar, Voskopojë, Lozhan dhe Moglicë të rrethit të Korçës, të hiqen nga regjistri kombëtar i pyjeve dhe kullotave dhe nga kadastra kombëtare e pyjeve. Gjithashtu, kërkohet që brenda 3 viteve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, ajo duhet të ripyllëzojë një zonë prej 1347,80 ha pyjesh dhe të përmirësojë një zonë prej 73,6 ha kullotash.

Sipas këtij ligji, DHP nuk ka rol aktiv në përcaktimin e parcelave dhe të zonave që do të ripyllëzohen. Janë duke u bërë diskutimet me ministrinë përgjegjëse për të detajuar hapat dhe procedurat për vënien në zbatim. DHP është në procesin e përgatitjes së një studimi me fusha prioriteti për mbështetjen sociale dhe kontrollin e erozionit, përpara vendimeve përfundimtare që do të merren për parcelat, llojet e pemëve dhe planin e zbatimit. Ky studim do të përfshijë plane të detajuara për menaxhimin e pyllëzimit dhe pylltarisë, duke përfshirë masat për të ndihmuar lehtësimin e të dyja problemeve mjedisore si edhe marrjen parasysh të aspekteve sociale për të kontribuar në rritjen e të ardhurave lokale nëpërmjet mbjelljes së pemëve me prodhimtari brenda zonës së projektit.

### 5.9.2 Qëllimi dhe veprimtaritë

Në linjë me kërkesat mjedisore të qeverisë shqiptare, kjo është mbështetje për zhvillimin e një plani të detajuar për menaxhimin e pyjeve dhe për zbatimin, i cili do të hartohet nga DHP në bashkëpunim me autoritetet qeveritare. Për të siguruar përqindjen e jetëgjatësisë së pemëve dhe dorëzimin te qeveria

shqiptare, kjo veprimtari është planifikuar të zgjasë të paktën 3 vjet nga përfundimi i pyllëzimit.

Programi i pyllëzimit ka qëllimet e mëposhtme:

- Pastrimin e rezervuarit, i cili do të kryhet përpara mbushjes së rezervuarit në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- Kryerjen e një vlerësimi të plotë të situatës aktuale të pyjeve dhe propozimin e alternativave dhe rekomandimeve që duhet të zbatohen.
- Kryerjen e pyllëzimit në zonat e zgjedhura, i cili kërkohet për të kthyer në vend ndikimet në pyje të shkaktuara nga Projekti Hidroenergjetik i Devollit (kjo mund të përfshijë shqyrtimin e partnerëve të mundshëm për zbatimin e programit të pyllëzimit).
- Mbështetjen dhe punën me qeveritë vendore dhe përfitues të tjerë lokalë për përgatitjen e planeve strategjike.
- Fuqizimin e kapacitetit të autoriteteve mjedisore në lidhje me menaxhimin e pyjeve; kjo do të përfshijë programe ndërgjegjësimi për fshatarët, autoritetet dhe industrinë;
- Zhvillimin e ndërveprimeve me njësitë e tjera të MSM-së, të tilla si zhvillimi i pemëtarisë në zonat pyjore.
- Përmirësimin e qëndrueshmërisë së shpateve dhe reduktim të erozionit dhe tokës përreth zonës rezervë të rezervuarit dhe zonave të prekshme me mundësinë e përmirësimit të peizazheve piktoreske në shpatet e lumit.
- Sigurimin se do të ketë një rritje në mbulimin me pyje, duke gjelbëruar zonën e projektit dhe duke lehtësuar vazhdimësinë e favorshme ekologjike.
- Mbikëqyrjen, monitorimin dhe vlerësimin.

### 5.9.3 Treguesit specifikë të performacës së programit

- Sipërfaqja totale e tokës (ha) dhe biomasa e shpyllëzuar/pyllëzuar
- Llojet dhe numri i pemëve të mbjella;
- Përqindja e jetëgjatësisë përpara dorëzimit përfundimtar (1,3 dhe 5 vjet)
- Numri i banorëve vendas të punësuar;
- Potenciali/viti i përlogaritur i prodhimit të pyllit të sapombjellë
- Pakësimi i përlogaritur i karbonit në pyllin e ri.

## 5.10 Programi për rrjedhën e poshtme

### 5.10.1 Baza

Për rreth 25 vitet e fundit, përmbytjet në rrjedhën e poshtme të Banjës janë rregulluar nga prita 50 m e lartë, e cila u ndërtua për ti shërbyer ndërtimi të digës kryesore të Banjës. Pjesa e sipërme e pritës është në nivel rreth 158 m m.n.d., duke i dhënë rezervuarit një kapacitet prej rreth 200 milion m<sup>3</sup> përpara tejmbushjes. Shkarkimi i ujit në rrjedhën e poshtme të Banjës përcaktohet nga kapaciteti i daljes së poshtme dhe nga kanali i devijimit. Në periudha përmbytjesh, rezervuari është ndërtuar në rrjedhën e sipërme të digës dhe shkarkimi nuk ka qenë mbi 250-300 m<sup>3</sup>/s.

Deri tani, regjimi i punës nuk është përcaktuar ende përfundimisht. Ekzistojnë disa metoda të njohura për vlerësimin e regjimeve të rrjedhës në mjedis dhe ekziston një mirëkuptim në rritje që rrjedhje të tilla duhet të lëshohen për të përmbushur objektivat e synuara për përfitime ekologjike dhe sociale. Kjo mund të ndryshojë gjatë jetëgjatësisë së projektit.

Ndërtimi i digës së Banjës dhe digës së Moglicës do të ndryshojë regjimin e rrjedhjes në lumin Devoll. Shumica e përmbytjeve do të grumbullohen në rezervuare dhe rrjedha e lumit do të përcaktohet nga

përdorimi i hidrocentraleve. Plani i shkarkimeve është bazuar në parimin që niveli më i lartë i rregulluar i ujit (NLRRU) nuk do të tejkalohet as gjatë një përmbytjeje që ndodh një herë në 1000 vjet.

Plani paraprak i DHP-së paraqiste një rrezik më të madh përmbytjesh në rrjedhën e poshtme të Banjës, gjë e cila do të kishte shkaktuar ndikime sociale dhe mjedisore, nëse nuk do të merreshin masa zbutëse siç duhet. Aktualisht është planifikuar të merren masa zbutëse për këtë nëpërmjet planifikimit të veprimeve për përdorim më të mirë të zonës së rezervuar buferike në rezervuare gjatë periudhave të përmbytjeve. Duhet të kryhen marrëveshje të mëtijshme me autoritetet përkatëse të qeverisë shqiptare. Ndërkohë që një kufizim i tillë do të reduktonte prodhimin e energjisë, kjo gjë është e pranueshme krahasuar me pasojat mjedisore dhe sociale.

Nuk është caktuar një bazë social-ekonomike për identifikimin e ndikimeve të mundshme të niveleve të rritura të ujit në kapacitetet e prodhimit lokal për të gjitha HEC-et. Kjo do të përfshihet në proceset e ardhshme të planifikimit.

#### **5.10.2 Seksioni Moglicë deri në Kokël (rrjedha e poshtme e Moglicës):**

Propozimi është që shkarkimi minimal i rrjedhës të caktohet në  $1,0 \text{ m}^3/\text{s}$ , me mundësinë që më vonë të krahasohen ndryshimet stinore me këtë shifër shkarkimi. Kjo do të thotë që pjesa e lundrueshme poshtë digës së Moglicës do të ketë gjithmonë një shkarkim prej të paktën  $1 \text{ m}^3/\text{s}$ , që shtohet deri në rreth  $1,5 \text{ m}^3/\text{s}$  në momentin që hyn në rezervuarin e Koklit. Këto rrjedhje janë të ngjashme me rrjedhjet minimale të vëzhguara 1-ditore dhe 7-ditore.

#### **5.10.3 Seksioni Kokël deri në rezervuarin e Banjës (rrjedha e poshtme e Koklit):**

Propozimi është që shkarkimi minimal i rrjedhës të caktohet në  $1,0 \text{ m}^3/\text{s}$ , me mundësinë që më vonë të krahasohen ndryshimet stinore me këtë shifër shkarkimi. Kjo do të thotë që pjesa e lundrueshme e lumit poshtë digës së Koklit, gjatë periudhave jashtë pikut/të mbylljes, do të ketë gjithmonë një shkarkim prej të paktën  $1 \text{ m}^3/\text{s}$  që rritet deri në  $1,5 \text{ m}^3/\text{s}$  në rrjedhën e përbashkët të Vërçës dhe kur arrin në lumin e Tomoricës do të ketë një rrjedhje minimale prej rreth  $2-3 \text{ m}^3/\text{s}$ . Këto rrjedhje janë rreth dyfishi i rrjedhjeve minimale të vëzhguara 1-ditore dhe 7-ditore.

#### **5.10.4 Rrjedha e poshtme e Banjës**

Lumi i Devollit nuk do të zbrazet në rrjedhën e poshtme të digës së Banjës, por gjatë pikut të operimit dhe gjatë mirëmbajtjes së hidrocentralit, do të shkarkohet një vëllim minimal uji nga rezervuari në shtratin e lumit dhe në kanalet në rrjedhën e poshtme. Marrëveshja e koncesionit kërkon që të ruhet një shkarkim minimal prej  $2,0 \text{ m}^3/\text{s}$  kur turbinat kryesore janë jashtë pune. Ky shkarkim është më i madh sesa rrjedhjet minimale të vëzhguara 1-ditore dhe 7-ditore dhe sa rreth 50% e rrjedhjeve mesatare 1-ditore dhe 7-ditore. Planet paraprake u hartuan për të plotësuar kërkesën minimale të marrëveshjes së koncesionit, e megjithatë tani është planifikuar instalimi i një turbine të vogël për të shfrytëzuar centralin që do të disponohet me shkarkimet që janë planifikuar të jenë të paktën sa dyfishi i kërkesës minimale të marrëveshjes së koncesionit. Kjo është bërë për të plotësuar kërkesat sociale (bujqësi/ujitje) në shtrirjet e rrjedhës së poshtme dhe në të njëjtën kohë për të kontribuar në përfitime më të favorshme mjedisore (ujore).

Disponueshmëria e ujit për ujitje në rrjedhën e poshtme të Banjës deri në rezervuarin e Thanës do të përmirësohet nga përdorimi i hidrocentralit, krahasuar me situatën aktuale. Nevojitet një protokoll

operimi ndërmjet Projektit Hidroenergjetik të Devollit, Bordeve Rajonale të Kullimit dhe Ministrisë së Bujqësisë për të shmangur problemet e devijimit të ujit drejt rezervuarit të Thanës (shkarkimi i sedimenteve, ndërprerje të paplanifikuara të punimeve etj.) dhe është planifikuar përpara grumbullimit të ujit në rezervuar.

#### 5.10.5 Qëllimi dhe veprimtaritë

Për të monitoruar më tej ndikimet e mundshme në rrjedhën e poshtme dhe për të sugjeruar përditësime të masave zbutëse sipas shqyrtimeve/studimeve më të fundit.

- Përgatitja e hartave të zonave të përmbytjeve në rrjedhën e poshtme të digës së Banjës që i përkasin niveleve të ndryshme të shfrytëzimit  $Q_5$ ,  $Q_{10}$ ,  $Q_{50}$ ,  $Q_{100}$ ,  $Q_{200}$ ,  $Q_{500}$  dhe  $Q_{1000}$ .
- Parashikimet e ndikimeve për nivelet e sipërpërmendura të përmbytjeve.
- Vlerësimi i ndikimeve në popullsinë vendase, kryerja e konsultimeve dhe marrja e masave zbutëse për komunitetet/familjet e prekura, nëse ka.
- Kjo mund të përfshijë masa kompensuese për marrjen e tokës, duke ndjekur parime të ngjashme sipas programit të risistemimit më sipër. Monitorimi që shkarkimet e përshtatshme të ujit dhe të sedimenteve të kryhen sipas sasive të rëna dakord.
- Sigurimi i ujit të nevojshëm për ujitje, sipas kërkesave të marrëveshjes së koncesionit dhe marrëveshjeve të tjera të DHP-së me qeverinë shqiptare.
- Monitorimi i ekologjisë ujore në rrjedhën e poshtme të secilit HEC dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme të projektit.
- Sisteme njoftimesh publike dhe fushata ndërgjegjësimi për shkarkimet e mëdha të ujit në harmoni me programin e zhvillimit social si më sipër.

#### 5.11 Kushtet mjedisore për aktivitete të përgjithshme ndërtimi

Plani i veprimit dhe menaxhimit mjedisor (PVMM) i projektit për veprimtaritë e njësisë HSE është bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe kërkon pajtim me standardet e performacës së IFC-së, të zbatuara nga DHP. Organizimi, vlerësimi i rreziqeve dhe ndikimeve, monitorimi, raportimi dhe menaxhimi përshtatës janë të gjithë elementët të rëndësishëm të programeve të njësisë HSE të DHP-së, duke përfshirë ato që i dorëzohen të tjerëve për zbatim (pra, inxhinierët e shoqërisë koncesionare dhe kontraktuesit). Kërkesat për disa nga këto zona, për shembull për trajnimin, janë specifikuar në nënplanet e dhëna në formën e shtojcave për secilin dokument kontrate.

Një total prej 10 nënplanesh kuadër është përgatitur për kontratën kryesore të punimeve civile, të cilat do të zbatohen gjatë fazës së ndërtimit. Për më tepër, është kërkesë kryesore që PVMM i hartuar duhet të përmbushë kërkesat në Vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM). Nënplanet e menaxhimit mjedisor dhe kërkesat në VNM do të përfshihen në programin për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin (HSE) të kontraktuesit.

Nënplanet janë:

- Kontrolli i erozionit
- Hedhja e mbeturinave inerte
- Guroret dhe skema e ndërtimit
- Menaxhimi i elementeve kimike
- Reagimi ndaj emergjencave dhe materialeve të rrezikshme
- Kontrolli i emetimeve dhe i shkarkimit të pluhurave
- Kontrolli i zhurmës
- Heqja e bimësisë

- Menaxhimi i mbetjeve
- Kampi i ndërtimit

Aktivitetet e ndërtimit lidhur me mjedisin janë nën përgjegjësinë e njësisë HSE të DHP-së në bashkëpunim me inxhinierin e shoqërisë koncesionare. Çështjet e përgjithshme do të trajtohen rast pas rasti, siç kërkohet.

#### **5.11.1 Treguesit specifikë të performancës së programit:**

Për të garantuar që kontraktorët kanë dhe ndjekin vlerësim të përshtatshëm, të saktë dhe objektiv, prezantojnë dhe paraqesin masat e duhura të realizueshme për të zbutur problemet. Siç përmendet më sipër, kjo do të monitorohet nga njësi HSE e DHP-së.

## 6. MEKANIZMI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

DHP-ja ka ngritur një mekanizëm të shqyrtimit të ankesave (MSHA). Kjo bëhet për të garantuar që kushdo që ka ankesa ose shqetësime për veprimtaritë e projektit DHP mund të na i thotë ne dhe do të marrë përgjigje për mënyrën sesi kompania do ta trajtojë këtë çështje ose shqetësim. Procedura zbatohet për veprimtaritë e projektit në të shkuarën dhe në të tashmen. Figura e mëposhtme tregon procesin MSHA të DHP-së.




Figura 21: Mekanizmi i shqyrtimit të ankesave (MSHA) i projektit DHP

Qëllimi i këtij mekanizmi të shqyrtimit të ankesave (MSHA) është të garantojë që familjet e prekura nga projekti (FPP), të cilat kanë një ankesë ose shqetësim për projektin mund t'ia komunikojnë atë lirisht kompanisë Devoll Hydropower SH.A. (DHP) dhe të marrin përgjigje për mënyrën sesi do të trajtohet çështja ose ankesa. Në këtë kontekst është e rëndësishme të vihet në dukje se mekanizmat e ankimit po marrin rëndësi gjithnjë e më të madhe në projektet ku parashikohen rreziqe të vazhdueshme ose ndikime të pafavorshme. Ato shërbejnë si një mënyrë për të plotësuar kërkesat, për të parandaluar dhe për të trajtuar shqetësimet e komunitetit dhe individëve, për të zvogëluar rrezikun dhe për të ndihmuar në procese më të mëdha që krijojnë ndryshime sociale pozitive.

Ky mekanizëm është ngritur duke pranuar rëndësinë e llogaridhënies dhe duke pranuar se shqetësimet dhe ankesat nga familjet e prekura nga projekti dhe grupet e tjera të interesit duhet të trajtohen në mënyrë të drejtë, objektive dhe konstruktive ([www.ifc.org](http://www.ifc.org)) dhe në këtë mënyrë drejtuesit e DHP-së do të jenë gjithmonë të informuar dhe të përfshirë në mënyrë që vendimi të merret kur nevojitet në mënyrë që të shmanget përshkallëzimi i mosmarrëveshjeve. MSHA-ja e DHP-së rishikon dhe jep gjykimin për ankesat e dorëzuara nga një individ ose grup individësh, nëpërmjet një mekanizmi transparent që përfshin të gjithë aktorët e përfshirë. Në këtë kontekst, të gjitha palët mund të përdorin specialistët teknikë ose dëshmitarët gjatë hetimit të ankesave për të mbështetur pretendimet e tyre.

MSHA-ja nuk duhet të mendohet si zëvendësues për proceset e tjera të DHP-së (si risistemimi, aksesit në tokë etj.) ose anasjelltas. Ai është një proces plotësues dhe do të mbështesë procese të tjera të DHP-së.

## SHTOJCA 1

### Parimet Udhëzuese dhe Skema e Përfitimeve për Projektin Hidroenergjetik të Devollit (DHP)

#### Qëllimi

Parimet udhëzuese dhe Skema e Përfitimeve përcaktojnë angazhimet e DHP-së për Personat e Prekur nga Projekti (PPP-ve) në lidhje me zbutjen e ndikimeve të projektit, si dhe promovimin e mundësive të zhvillimit në Luginën e Devollit. Masat e listuara në skemë do të kryen nga stafi i DHP-së dhe autoritetet përkatëse të Qeverisë Shqiptare.

#### Referencat

- Politika e DHP për Qëndrueshmërinë
- Udhëzimet dhe Standardet e Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC – Internacional Finance Corporation)

#### Parimet udhëzuese të Projektit Hidroenergjetik të Devollit

- Ndikimet e projektit do të shmangen ose zvogëlohen ku është e mundur duke gjetur alternativa të realizueshme në projektim dhe vendndodhje.
- Do të kryen vlerësime të plota me qëllim identifikimin dhe zvogëlimin e të gjitha ndikimeve.
- Personat e Prekur nga Projekti (PPP-të) do të kompensohen dhe ri-sistemohen me qëllim ruajtjen dhe/ose përmirësimin e standardit të tyre të jetesës duke përfshirë mundësinë për të përdorur shërbimet dhe burimet e përbashkëta të komunitetit.
- Marrja e pronësisë dhe ri-sistemimi do të planifikohet dhe zbatohet për të shkaktuar sa më pak përçarje sociale, kulturore dhe ekonomike.
- Të gjitha masat duhet të zbatohen aq sa është e mundur me përpjekje dhe kosto të arsyeshme, pa shkaktuar dëme në mjedis.
- Masa të posaçme do të ndërmerren për të mbrojtur grupet më të ndjeshme nga ana ekonomike dhe sociale, p.sh. grupe të cilat për arsye të ndryshme nuk mund të marrin pjesë në programet e ri-sistemimit.
- Të gjithë personat që banojnë në zonat e ndikuara direkt nga projekti do të konsiderohen si PPP dhe do të kenë të drejtën e kompensimit dhe ri-sistemimit në rast se banesat dhe jetesa e tyre ndikohen negativisht.
- Niveli i mëparshëm i shërbimeve dhe burimeve komunitare do të mirëmbahet dhe/ose përmirësohet pas kompensimit dhe ri-sistemimit.
- Programet e ri-sistemimit do të planifikohen dhe zbatohen me pëlqimin dhe marrëveshjen e personave të ndikuar nga projekti nëpërmjet një procesi pjesëmarrje gjithë përfshirës.
- Të gjithë PPP-të do të kenë mundësi të përdorin mekanizma efektive për dëgjimin dhe zgjidhjen e ankesave gjatë zbatimit të programeve për kompensim dhe ri-sistemim.
- DHP do të monitorojë zbatimin e aktiviteteve të projektit në Luginën e Devollit bazuar në objektivat për një zhvillim të qëndrueshëm.



## Skema e Përfitimeve për Ri-sistemimin dhe Kompensimin

Çështja	Kompensimi dhe Masat Zbutëse
A – Humbja e banesës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurimi i fondeve për Qeverinë Shqiptare për pagesat e shpronësimeve për shtëpitë dhe banesat bazuar në vlerat e miratuara nga qeveria.</li> <li>Sigurimi i të njëjtit standard të banesës së mëparshme me anë të ofrimit të materialeve shtesë dhe mbështetjes teknike për banorët që do të zhvendosen në Luginën e Devollit</li> <li>Sigurimi i transportit për tek vendbanimet e reja brenda Luginës së Devollit (orenditë shtëpiake, materialet dhe objektet e lëvizshme).</li> </ul>
B – Humbja e strukturave të tjera	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zëvendësimi i strukturave të palëvizshme me të njëjtën vlerë ose sigurimi i materialeve të reja për ndërtim nëse PPP-të qëndrojnë brenda Luginës së Devollit</li> </ul>
C – Humbja e tokës truall	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurimi i fondeve për Qeverinë Shqiptare për pagesat e shpronësimit për humbjet e trojeve bazuar në normat e qeverisë.</li> <li>Sigurimi i asistencës për PPP-të për të siguruar truall të përshtatshëm duke u konsultuar me Qeverinë</li> </ul>
D – Humbja e tokës bujqësore (pronari i tokës)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurimi i fondeve për Qeverinë Shqiptare për pagesat e shpronësimit për humbjet e tokës bujqësore bazuar në vlerat e miratuara nga Qeveria.</li> <li>Ku është e mundur, në bashkëpunim me komunitetin, familjet dhe autoritetet lokale të identifikohen dhe zhvillohen toka të reja për prodhim bujqësor për t'ua rindarë atyre që preken më shumë nga humbja e tokës (familjet me humbje prodhimi &gt;50% dhe ato që do të shpërngulen)</li> </ul>
E – Humbja e prodhimit bujqësor (përdoruesi i tokës)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Paketat e mëposhtme në mbështetje të jetesës do të ofrohen bazuar në vlerësimin e humbjes së prodhimit: <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Sisteme të prodhimit për serat</li> <li>2) Drurë frutorë</li> <li>3) Zhvillimi i blegtorisë</li> <li>4) Rritja e prodhimeve bujqësore</li> <li>5) Zhvillimi i biznesit</li> <li>6) Alternativa të tjera të pranueshme nga DHP dhe PPP-të</li> </ol> </li> <li>Për familjet e ndjeshme do të jepet mbështetje e veçantë me qëllim që të sigurohet pjesëmarrja e tyre në programet e rivendosjes së mjeteve të jetesës</li> <li>Këshilla nga ana teknike për një minimum kohe prej 3 vjetësh</li> </ul>
F – Humbja e përkohshme e prodhimit	Kompensim në para për humbjen e prodhimit dhe rikthimin të tokave jashtë zonave të shpronësimit të shkaktuar nga aktivitetet e ndërtimit të projektit
G – Humbja e burimeve të pasurisë së përbashkët	<ul style="list-style-type: none"> <li>Ku është e mundur të lehtësojë mundësinë e përdorimit të pyjeve, kullotave, ujit dhe burimeve të tjera natyrore të përshtatshme</li> </ul>

Çështja	Kompensimi dhe Masat Zbutëse
H – Humbja e përhershme e tokës që përdoret për qëllime biznesi	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetje për identifikimin e tokës zëvendësuese në një vendndodhje të pranueshme nga PPP me qëllim vazhdimin e aktiviteteve tregtare të suksesshme</li> </ul>
I – Humbja fizike e pasurisë kulturore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sigurim i mbështetjes për ceremonitë dhe përgatitjen për zhvendosjen e sendeve të lëvizshme dhe rivendosjen në vendin e ri të renë dakort nga PPP-të.</li> <li>Zëvendësimi i objekteve të kultit dhe strukturave të tjera fetare me të paktën të njëjtën vlerë dhe të pranueshme nga komuniteti brenda Luginës së Devollit</li> </ul>
J – Humbja e infrastrukturës së komunitetit/publike	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetje për Qeverinë Shqiptare dhe koordinim me PPP-të në zëvendësimin e të gjithë infrastrukturës publike me të paktën të njëjtën vlerë dhe funksion ose përmirësim të infrastrukturës ekzistuese përfshirë ujësjellësit, rrugët hyrëse-lidhëse dhe linjat elektrike nëse është e nevojshme</li> </ul>
K – Humbja e objekteve arsimore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetje për Qeverinë Shqiptare dhe koordinim me PPP-të në zëvendësimin e shkollave të prekura ose përmirësimin e shërbimeve sociale të fshatit brenda një distance të pranueshme nga familjet</li> <li>Sigurimin e pajisjeve, materialeve dhe aparaturave për shkollat e reja sipas nevojave</li> </ul>
L – Programet rajonale	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përmirësim të shërbimeve shëndetësore përmes qendrave shëndetësore, pajisjeve dhe trajnimit të stafit mjekësor</li> <li>Përmirësim të shërbimeve edukative përmes shkollave, transportit, trajnimeve, zhvillimit të aftësive dhe programeve për bursa</li> <li>Rritje të prodhimit bujqësor përmes programeve për trajnimin e fermerëve dhe gjetja e tregut të prodhimeve të zonës</li> </ul>
M – Zhvillimi i vaditjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>Studimi dhe projektimi i skemave të mundshme të zhvillimit të sistemeve për vaditje në zonën e poshtme të digës së Banjës në bashkëpunim me palë të tjera, përfshirë Qeverinë Shqiptare</li> <li>Mbështetje për zhvillimin e sistemeve të vaditjes apo mundësive të tjera në bashkëpunim me palë të tjera, përfshirë Qeverinë Shqiptare</li> </ul>
N – Procesi i Ankesave	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të gjitha familjet do të kenë të drejtën e ankimit të lirë dhe direkt ndaj shqetësimeve lidhur me projektin me anë të Mekanizmit të Shqyrtimit të Ankesave.</li> </ul>